

# LIGJ PËR NDËRTIM

TEKST I KONSOLIDUAR <sup>1</sup>

**Teksti në  
gjuhën  
Maqedonase**  
 Закон за градење

**Teksti në  
gjuhën Angleze**  
 Law on  
Construction

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen ndërtimi, kërkesat themelore për ndërtimin, dokumentacioni i nevojshëm projektues për marrjen e lejes për ndërtim, të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësve në ndërtim, mënyra e përdorimit dhe mirëmbajtjes së ndërtimit, si dhe çështje tjera të rëndësishme për ndërtimin.

### Neni 2

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin si vijon:

1. Ndërtim, është kryerja e punëve paraprake, përpilimi i dokumentacionit projektues, kryerja e punëve përgatitore, ndërtimi i ndërtesës së re, ndërtimi shtesë dhe mbindërtimi i ndërtesës ekzistuese, rikonstruktimi dhe adaptimi i ndërtesës ekzistuese që i përfshin punët në truall, kryerja e konstruksionit ndërtimor, kryerja e punëve ndërtimore - instaluese dhe punëve ndërtimore përfundimtare, instalimi i impianteve ose pajisjeve dhe punëve tjera me të cilat formohet tërësia e ndërtimit;

2. Ndërtesë, është çdo gjë që ka ndodhur me ndërtimin dhe është e lidhur me truallin, ndërsa paraqet tërësi fizike, teknike - teknologjike dhe ndërtimore, së bashku me instalimet e montuara, përkatësisht pajisjen;

3. Objekt i përkohshëm, është objekti montues-çmontues ose objekti tipik i cili vendoset në truall ndërtimor të pandërtuar, për përdorimin e përkohshëm të hapësirës deri në realizimin e planit urbanistik, për truallin ndërtimor në të cilin është vendosur objekti i përkohshëm. Objekti i përkohshëm vendoset për kryerjen e:

- veprimtarive të komunikacionit (parkingje të përkohshme dhe rrugica hyrëse),
- shitje të ushqimit,
- veprimtarive turistike, kulturore, sportive - rekreative dhe argëtuese (platforma për ngjarje sportive, kulturore, turistike dhe argëtuese, objekte përcjellëse në funksion të ngjarjeve sportive dhe diskoteka verore) dhe
- objekte të cilat janë në funksion të vendkalimeve kufitare;

4. Me pajisje urbane, sipas këtij ligji konsiderohen, pajisja për shitjen e biletave për transport publik, gazetave, suvenireve, luleve, ushqim, akulloreve, kabina telefonike, vendndalime për autobusë, objekte tipike për sigurim të cilat janë në funksion të përfaqësive diplomatike konsullore, të objekteve të organeve të administratës shtetërore dhe objekteve

rezidenciale, pajisje në funksion të ngjarjeve turistike, kulturore dhe sportive, pajisje për aktivitete rekreative sportive, nyje sanitare publike, tarraca me ose pa strehë, platforma për manifestime publike në tokë dhe në sipërfaqe të ujit, banakë të mbuluar dhe të pambuluar, objekte lundruese, parkingje në funksion të objekteve të organeve të administratës shtetërore dhe të organeve të komunës, pano vetëqëndruese për reklamë, fusha për lojëra për fëmijë, fontana, çezma, stola dhe shporta për hedhurina.

5. Rikonstruktim, është kryerja e punëve në suaza të gabaritit ekzistues të objektit me të cilat ndikohet në plotësimin e kërkesave themelore për ndërtimin, dhe me të cilat ndryshohet harmonizimi i ndërtimit me projektin sipas të cilit është ndërtuar, me ndryshimin e fasadës, ndryshimin e procesit teknologjik dhe të instalimit, sanimit dhe zëvendësimit të elementeve të konstruksionit e ngjashëm përkatësisht kryerja të punëve në objekte infrastrukurore me të cilat ndikohet në përmbushjen e kërkesave themelore të ndërtesës dhe me të cilat ndryshohet harmonizimi i ndërtesës me projektin sipas të cilit është ndërtuar;

6. Adaptim është kryerja e punëve të ndërtimit dhe punëve tjera në objekt ekzistues, me të cilat bëhet ndryshimi i organizimit të hapësirës në objekt, bëhet zëvendësimi i aparateve, stabilimenteve, pajisjes dhe instalimit me kapacitet të njëjtë, e me të cilat nuk ndikon në stabilitetin dhe sigurinë e objektit, nuk ndryshohen elementet konstruktive, nuk ndryshohet pamja e jashtme dhe nuk ndikohet në sigurinë e objekteve fqinje, komunikacionin dhe mbrojtjen nga zjarret dhe të mjedisit jetësor;

7. Mbindërtim, është kryerja e punëve në objektin ekzistues me të cilat ndikohet në elementet themelore sipas të cilave është ndërtuar objekti, e veçanërisht të konstruksionit në lartësi me ndërtimin e kateve të reja, deri në lartësinë maksimale të lejuar me planin urbanistik, me ç'rast mund të ndikohet në sistemin e konstruksionit në suaza të gabariteve ekzistuese themelore;

8. Ndërtim - shtesë, është kryerja e punëve në objektin ekzistues me ndërtimin e hapësirës së re jashtë gabaritit të objektit ekzistues, deri në sipërfaqen maksimale të lejuar të paraparë me planin urbanistik, me ç'rast mund të ndikohet në sistemin e konstruksionit të objektit ekzistues;

9. Përdorim i objektit ndërtimor, është kryerja e aktiviteteve në objekt të ndërtuar në pajtim me dedikimin e tij, të përcaktuar me aktvendimin për kushtet e lokacionit dhe projektin themelor;

10. Mirëmbajtje e objektit ndërtimor, është kryerja e punëve për ruajtjen e kërkesave themelore të objektit gjatë përdorimit të tij;

11. Prodhim ndërtimor, është prodhimi i cili është prodhuar për instalimin e përhershëm në ndërtime për të cilat është marrë vlerësim teknik pozitiv, se prodhimi është adekuat për përdorim në dedikimin e paraparë;

12. Impiant, është përmbledhja e pajisjes së lidhur e cila shërben për kryerjen procesit teknologjik ose procesit tjetër, në pajtim me dedikimin e ndërtimit;

13. Pajisje, janë aparatet e veçanta, instalimet e procesit dhe prodhimet tjera nga të cilat përbëhet impianti, ose janë të instaluara në mënyrë të pavarur në ndërtim dhe shërbejnë për procesin teknologjik ose proces tjetër, në pajtim me dedikimin për ndërtimin;

14. Punë paraprake, janë punët të cilat varësisht nga lloji dhe karakteri i ndërtimit, e përfshijnë hulumtimin dhe përpunimin e analizave dhe materialeve tjera profesionale, marrjen e të dhënave me të cilat analizohen kushtet gjeologjike, gjeoteknike, gjeodezike, hidrologjike, meteorologjike, urbanistike, teknike, teknologjike, ekonomike, energjetike, sizmike, të ekonomisë së ujërave dhe të komunikacionit, kushte për mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe kushte tjera të parapara me ligj;

15. Punë përgatitore, janë punët për kryerjen e ndërtimeve të përkohshme dhe aktivitete tjera për organizimin dhe rregullimin e kantierit të ndërtimit, si dhe mundësimin e aplikimit të punëve adekuate ndërtimore dhe teknologjike;

16. Ndërtime infrastrukturore të linjave janë rruga publike, ura, infrastruktura hekurudhore, largpërçuesi, naftësjellësi, produktsjellësi, gazsjellësi, përçuesi i nxemjes, ujësjellësi, kanalizimi, vijat telekomunikuese dhe objekte tjera, që mund të jenë mbitokësore apo nëntokësore dhe ndërtimi i të cilave paraqet interes publik të përcaktuar me ligj;

17. Kantier ndërtimi, është hapësira e rrethuar në të cilën kryhen punët e ndërtimit, ndërtimit - shtesë, mbindërtimit, rikonstruktimit, adaptimit, mirëmbajtjes dhe mënjanimit të ndërtimit, si dhe hapësira e zënë përkohësisht e nevojshme për aplikimin e teknologjive ndërtimore përkatëse dhe

18. Mënjanim, është kryerja e punëve të rrënimit ose çmontimit të ndërtimit, objektit ose të pjesëve të tyre, si dhe mbledhja dhe transportimi i materialit ndërtimor dhe mbeturinave të shkaktuara nga rrënimi, përkatësisht me çmontimin e konstruksionit dhe me rregullimin e truallit.

## **Neni 2-a**

Në procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

## **Neni 2-b**

(1) Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve ushtarake dhe ndërtimeve me rëndësi për mbrojtjen dhe sigurinë.

(2) Ndërtimi i objekteve dhe ndërtimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet në pajtim me rregullat nga sfera e mbrojtjes dhe sigurisë.

## **Neni 2-v**

*I fshirë* 2

# **II. KËRKESAT THEMELORE PËR NDËRTIMIN**

## **Neni 3**

(1) Çdo ndërtim, varësisht nga dedikimi, duhet t'i plotësojë kërkesat themelore për ndërtimin, të parapara me parametrat e planit urbanistik ose dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, përkatësisht lokal ose projektit të infrastrukturës dhe kushtet tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me ligjet e veçanta.

(2) Kërkesat themelore për ndërtimin kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë mekanike, stabilitetin dhe mbrojtjen sizmike, mbrojtjen nga zjarri, mbrojtjen sanitare dhe shëndetësore, mbrojtjen e mjedisit të punës dhe mjedisit jetësor, mbrojtjen nga zhurma, siguria e përdorimit, shfrytëzimi efikas i energjisë dhe mbrojtja e nxehtësisë, qasja dhe të lëvizja e papenguar deri në ndërtim dhe në ndërtim, dhe cilësitë teknike të prodhimeve ndërtimore që shfrytëzohen për ndërtim.

(3) Kërkesat themelore për prodhimet ndërtimore, cilësitë e tyre teknike dhe kërkesat tjera teknike, doemos duhet të jenë në pajtim me ligjin dhe me dispozita tjera, me të cilat rregullohet kualiteti i prodhimeve ndërtimore.

## **1. Qëndrueshmëria mekanike, stabiliteti dhe mbrojtja sizmike**

### **Neni 4**

Ndërtimi duhet të jetë i projektuar dhe i kryer në atë mënyrë që gjatë punëve ndërtimore dhe gjatë përdorimit, nuk do të vijë te çrregullimi i rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike, e veçanërisht te:

- shembja e tërë ose e pjesës së ndërtimit,
- dëmtimi i pjesëve të ndërtimit, bazës së themeleve ose pajisjes, si rezultat i deformimeve të mëdha të konstruksionit mbajtës të ndërtimit, dhe
- deformimet dhe dëmtimet e mëdha joproportionale, në raport lidhur me shkakun nga i cili kanë ndodhur.

### **Neni 4-a**

(1) Për përcaktimin e plotësimit të kushteve nga neni 4 të këtij ligji, nevojitet të sigurohet mendim pozitiv për shkallën e projektuar dhe të realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës, nga subjekti i cili kryen veprimtari shkencore-hulumtuese institut shkencor i specializuar në sferën e mbrojtjes së ndërtesave nga ndikime sizmike. Mendimi për shkallën e projektuar dhe të realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës sigurohet vetëm për ndërtesat për të cilat në pajtim me rregullat për projektim, projekti themelor duhet të përmbajë projekt konstruktiv ndërtimor.

(2) Mendimi për shkallën e projektuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës, ka të bëjë me projektin ndërtimor – konstruktiv, i cili është pjesë përbërëse e projektit themelor dhe dorëzohet nga investuesi me kërkesën për marrjen e lejes për ndërtim.

(3) Subjekti i cili kryen veprimtari hulumtueseshkencore-institut shkencor i specializuar në sferën e mbrojtjes së ndërtesave nga ndikimet sizmike është i obliguar që mendimin për shkallën e projektuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesave me bruto sipërfaqe të zhvilluar deri në 5000 m<sup>2</sup> t'ia lëshojë investuesit në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës, përkatësisht në afat prej 30 ditë për ndërtesa me bruto sipërfaqe të zhvilluar mbi 5000 m<sup>2</sup> dhe për objekte infrastrukturore në linjë, në të kundërtën do të konsiderohet se mendimi është pozitiv, ndërkaq nëse në të ardhmen për shkak të mosveprimit shkaktohen dëme, obligimi për kompensimin e dëmit do të jetë në ngarkim të subjektit i cili kryen veprimtari shkencore-hulumtuese.

(4) Mendimi për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës sigurohet nga realizuesi gjatë ndërtimit dhe pas ndërtimit të tërë sistemit konstruktiv të ndërtimit.

(5) Për ndërtesa të dedikuara për banim individual me bruto sipërfaqe të zhvilluar deri në 300 m<sup>2</sup> nuk është i domosdoshëm mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës.

(6) Lartësia e kompensimit për mendimin për shkallën e projektuar dhe të realizuar të shkallës së rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike përcaktohet në listën e çmimeve të cilën e miraton subjekti i cili kryen veprimtari shkencore-hulumtuese-institut shkencor i specializuar në sferën e mbrojtjes së ndërtesave nga ndikime sizmike, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe i njëjti shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(7) Lartësia e kompensimit nga paragrafi (6) i këtij neni, përcaktohet sipas nivelit të mbrojtjes sizmike, llojit dhe kategorizimit të ndërtesës, zonës sizmike në të cilën gjendet ndërtesa, materialit nga i cili është realizuar sistemi themelor konstruktiv i ndërtesës, ndërlikueshmërisë së sistemit konstruktiv të ndërtesës, sipërfaqes së përlllogaritur, gjatësisë dhe lartësisë së ndërtesës.

(8) Nëse pas përfundimit të ndërtimit dhe vënies në përdorim të ndërtesës ndodh dëmtimi i ndërtesës për shkak të mosplotësimit të kushteve për rezistencë mekanike, stabilitet dhe mbrojtje sizmike të ndërtesës, obligimi për kompensim të dëmit do të jetë në ngarkim të subjektit i cili kryen veprimtari shkencore-hulumtuese.

(9) Subjekti nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk mund të kryejë përpunim të dokumentacionit të projektit, revizion të dokumentacionit të projektit, realizim të ndërtesave dhe mbikëqyrje mbi ndërtimin.

(10) Formën dhe elementet të cilat duhet t'i përmbajë mendimi për shkallën e projektuar dhe të realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

## **2. Mbrojtja nga zjarri**

### **Neni 5**

Ndërtimi duhet të jetë i projektuar dhe kryer në atë mënyrë që në rast të zjarrit, mund të:

- ruhet sistemi mbajtës i konstruksionit, për një afat të caktuar kohor,
- pengohet zgjerimi i zjarrit dhe tymit në ndërtim,
- ndalohet zgjerimi i zjarrit në ndërtimet fqinje,
- mundësohet që personat të palënduar ta lëshojnë ndërtimin, përkatësisht të mundësohet shpëtimi i tyre dhe
- mundësohet mbrojtja e ekipeve të shpëtimit.

## **3. Higjiena, shëndeti dhe mbrojtja e mjedisit punues dhe jetësor**

### **Neni 6**

(1) Ndërtimi duhet të jetë i projektuar dhe i kryer, në mënyrë që të mos e rrezikojë higjienën dhe shëndetin e njerëzve, mjedisin punues dhe jetësor, veçanërisht si rezultat i:

- lëshimit të substancave të rrezikshme,
- prezencës së grimcave helmuese ose gazrave në ajër,
- emisionit të rrezatimit të rrezikshëm,
- ndotjes ose helmimit të ujit dhe truallit,
- mënjanimit jopërkates të ujërave e zeza, tymit, mbeturinave të ngurta ose të lëngëta dhe
- prezencës së lagështisë në pjesë të ndërtimit.

(2) Prodhimet ndërtimore dhe pasja gjatë ndërtimit duhet të kryhen, instalohen, lidhen dhe mirëmbahen ashtu që nën veprimin e ndikimeve kimike, fizike dhe ndikimeve tjera, të mos mund të shkaktohet rrezik, pengesë, dëm ose dëmtime të palejueshme gjatë përdorimit të ndërtimit.

## **4. Siguria gjatë përdorimit**

### **Neni 7**

Ndërtimi duhet të jetë i projektuar dhe i kryer në mënyrë që gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, të evitohen lëndimet e mundshme të personave, që mund të ndodhin nga rrëshqitja, rënia, goditja, djegia, goditja e rrymës dhe shpërthimi, dhe nga raste tjera që mund ta rrezikojnë sigurinë në ndërtim.

## **5. Mbrojtja nga zhurma**

### **Neni 8**

Projektimi, kryerja dhe përdorimi i ndërtimeve, stabilimenteve të instaluar dhe pajisja, duhet të mundësojnë që zhurma në ndërtim dhe jashtë ndërtimit, të jetë në kufijtë e përcaktuar me Ligjin për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësor dhe në rregulloret që dalin prej tij.

## **6. Shfrytëzimi efikas i energjisë dhe mbrojtja e ngrohtësisë**

### **Neni 9**

Ndërtimi dhe impiantet e tij për nxehje, ftohje dhe ventilim, duhet të jenë të projektuara dhe të kryera në mënyrë që varësisht nga kushtet klimatike të lokacionit, do të sigurojnë që shpenzimi i energjisë gjatë përdorimit të saj, të jetë i njëjtë ose më i ulët nga niveli i përcaktuar, si dhe t'i plotësojnë kërkesat për efikasitet energjetic, të përcaktuara me dispozitat që e rregullojnë këtë materie.

## **7. Shmangia nga kërkesat themelore për ndërtimin**

### **Neni 10**

Në rast të rikonstruktimit ose adaptimit të ndërtimit të regjistruar në Regjistrin nacional për trashëgimi kulturore, me të cilin personave me invaliditet u mundësohet qasje, lëvizje, qëndrim dhe punë pa pengesa, mund të shmanget nga disa kërkesa themelore për ndërtimin, për mundësimin e qasjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punës pa pengesa, pas marrjes së mendimit pozitiv nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

dhe pëlqimit të marrë nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerje të punëve nga sfera e kulturës.

## **8. Qasja dhe lëvizja pa pengesa deri te ndërtimi dhe në ndërtim**

### **Neni 11**

(1) Ndërtesë me dedikime publike dhe afariste, ndërtesa me dedikim banimi në ndërtesa banesore si dhe ndërtesa me dedikim banesor afarist, doemos duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar ashtu që personave me invaliditet do t'u mundësohet pa pengesa qasje, qëndrim dhe punë deri në ndërtesë dhe në ndërtesë.

(2) Ndërtesë me dedikim banimi në ndërtesa banimi si dhe ndërtesa me dedikim banesor afarist, me dhjetë dhe më shumë banesa, duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar ashtu që të jetë e rregulluar për qasje, lëvizje, qëndrim dhe punë të personave me invaliditet, në së paku një banesë në çdo dhjetë banesa, por jo më shumë se katër banesa, e së paku 3% nga numri i përgjithshëm i vendeve për parkim në hapësirën e parkimit të këtyre ndërtesave duhet të jenë të dedikuara për persona me invaliditet dhe duhet të jenë të shënuara me sinjalizim përkatës horizontal dhe vertikal.

(3) Gjatë ndërtimit të sipërfaqeve të reja publike - vendkalimeve të këmbësorëve si dhe gjatë rikonstruksionit të sipërfaqeve ekzistuese publike - vendkalimeve të këmbësorëve në qendër të qytetit dhe në parqe, sipërfaqja publike vendkalimi për këmbësorë duhet të projektohet dhe realizohet ashtu që e njëjta do të ketë dhe shteg për lëvizjen e personave me hendikep trupor dhe personave me shikim të dëmtuar.

(4) Karakteristikat teknike dhe dimensionet e shtegut për lëvizjen e personave me hendikep trupor dhe personave me shikim të dëmtuar, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

(5) Mënyrën e sigurimit të qasjes pa pengesa, lëvizjes (horizontale dhe vertikale), qëndrimit dhe punës së personave me invaliditet deri në ndërtesat dhe në ndërtesat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit hapësinor.

## **9. Lidhja për infrastrukturë të gazsjellësit**

### **Neni 11-a**

Ndërtesë e cila gjendet në kufi të përfshirjes së planit të përgjithshëm urbanistik, duhet të projektohet dhe realizohet ashtu që do të ketë lidhje për infrastrukturë të gazsjellësit.

## **10. Hapësira për biçikleta**

### **Neni 11-b**

Ndërtesë me dedikim publik duhet të jetë e projektuar dhe e realizuar ashtu që do të ketë të siguruar hapësirë parkingu për biçikleta në funksion të objektit ”.

## **11. Infrastruktura fizike për sigurimin e rrjeteve të komunikimit elektronik për transmetim me shpejtësi të mëdha**

### **Neni 11-v**

Ndërtesa me dedikim afarist si dhe ndërtesa me dedikim banimi në ndërtesa banesore, doemos duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar ashtu do të përmbajë pikë koncentrimi të vendosur brenda apo jashtë ndërtesës, që do të jetë e kapshme për operatorët me qëllim që e njëjta t'u mundësojë qasje te infrastruktura fizike në ndërtesë për shpejtësi të mëdha.

## **III. PJESËMARRËSIT NË NDËRTIM**

### **Neni 12**

(1) Pjesëmarrësit në ndërtim janë bartësi i së drejtës për ndërtim dhe personat juridikë të cilët i kryejnë punët e projektimit, revizionit, realizimit dhe mbikëqyrjes së ndërtimit.

(2) Personi juridik dhe fizik i huaj, mund të jetë pjesëmarrës në ndërtim në kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Të drejtat dhe obligimet ndërmjet pjesëmarrësve në ndërtim, rregullohen me këtë dhe ligj tjetër.

### **1. Investuesi**

#### **Neni13**

(1) Bartës i së drejtës së ndërtimit është personi juridik ose fizik pronar i truallit në të cilin ndërtohet ndërtimi, personi i cili e ka fituar të drejtën e marrjes me qira afatgjate të truallit ndërtimor, koncesionari, bartësi i së drejtës së servitutit për ndërtim, personi të cilit pronari i truallit ose bartësi i së drejtës për qira afatgjate të truallit ndërtimor, ia ka bartur të drejtën e ndërtimit me vepër juridike, personi i cili e ka marrë të drejtën e ndërtimit me aktvendim të gjykatësit të falimentimit gjatë shitjes të së drejtës së ndërtimit në procedurë të falimentimit dhe personi i cili e ka fituar të drejtën e ndërtimit në pajtim me ligjin (në tekstin në vijim: investuesi).

(2) Investuesi obligohet që projektimin, revizionin e projekteve, ndërtimin dhe mbikëqyrjen mbi ndërtimin e ndërtesave, t'ua japë personave juridikë të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

#### **Neni 13-a**

(1) Organet shtetërore, ndërmarrjet publike dhe subjektet tjera të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ose Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, të cilat e kanë marrë të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të tokës ndërtimore për ndërtim të objektit në pajtim me Ligjin për tokë ndërtimore, mund t'ia bartin të drejtën e ndërtimit personit fizik ose juridik, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.



(2) Organet dhe subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, të drejtën për ndërtim mund t'ia bartin vetëm personit fizik ose juridik të cilët mund të marrin të drejtën e pronësisë në Republikën e Maqedonisë në pajtim me ligjin, të zgjedhur në bazë të thirrjes publike nëpërmjet dorëzimit të ofertave.

### **Neni 13-b**

(1) Thirrjen publike për bartjen e të drejtës për ndërtim, e realizon Komisioni për Zbatimin e Procedurës për Bartjen e së Drejtës për Ndërtim (në tekstin e mëtejme: Komisioni), i formuar nga organi, përkatësisht subjekti nga neni 13-a paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Thirrja publike, shpallet në dy gazeta ditore të cilat botohen në gjuhën maqedonase, ndërkaq dalin së paku tre muaj para ditës së shpalljes së thirrjes dhe në një gazetë ditore, e cila botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase në komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qytetin e Shkupit në rajonin e të së cilës duhet të ndërtohet objekti lëndë e thirrjes publike, ndërkaq botohet së paku tre muaj para ditës së shpalljes së thirrjes, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me ç'rast detyrimisht përmban:

- të dhëna për tokën ndërtimore në të cilën duhet të ndërtohet objekti,
- kushte urbanistike-arkitektonike për ndërtimin e objektit,
- përqindje minimale të bruto sipërfaqes së zhvilluar në pjesën e objektit i cili pas ndërtimit duhet të dorëzohet në pronësi të organit përkatësisht subjektit nga neni 13-a paragrafi (1) të këtij ligji i cili e bartë të drejtën e ndërtimit,
- afatin dhe mënyrën e dërgimit të ofertës,
- dokumentacionin e nevojshëm i cili duhet të dorëzohet,
- datën, kohën dhe vendin e hapjes së ofertave,
- afatin për marrjen e lejes për ndërtim,
- afatin për ndërtimin e objektit,
- obligim për dorëzimin dhe lartësinë e garancisë bankare për seriozitet të ofertës nga ofertuesit dhe
- obligim për dorëzimin dhe lartësinë e garancisë bankare për ndërtimin e objektit nga ofertuesi më i volitshëm.

(3) Afati për dorëzimin e ofertës nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së thirrjes publike.

(4) Kriter i vetëm për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm është lartësia e përqindjes së ofruar nga bruto sipërfaqja e zhvilluar në pjesën e objektit i cili pas ndërtimit do të dorëzohet në pronësi të organit, përkatësisht subjektit nga neni 13-a paragrafi (1) të këtij ligji i cili e bartë të drejtën e ndërtimit.

(5) Procedura për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm zbatohet nëse ka arritur së paku një ofertë.

(6) Ofertat hapen publikisht, në prezencë të ofertuesve ose përfaqësuesve të autorizuar të ofertuesve me ç'rast Komisioni përpilon procesverbal për hapjen publike të ofertave, i cili nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit dhe ofertuesit përkatësisht përfaqësuesit e autorizuar të ofertuesve të cilët janë të pranishëm në hapjen publike.

(7) Komisioni është i obliguar që më së voni në afat prej pesë ditësh pune nga dita e hapjes së ofertës të bëjë evaluimin e tyre dhe përpilon raport në lidhje me evaluimin e ofertave, i cili u dorëzohet të gjithë ofertuesve.

(8) Ofertues më i volitshëm zgjidhet personi i cili do t'i plotësojë kushtet e thirrjes publike dhe do të ofrojë përqindje më të madhe të bruto sipërfaqes së zhvilluar të objektit i cili pas ndërtimit do t'i dorëzohet në pronësi organit përkatësisht subjektit nga neni 13-a paragrafi (1) të këtij ligji, i cili e bartë të drejtën e ndërtimit.

(9) Marrëveshja për bartjen e të drejtës për ndërtim lidhet me ofertuesin më të volitshëm me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(10) Ofertuesit kanë të drejtë të kundërshtimit në afat prej tri ditësh nga pranimi i raportit për evaluim, te Komisioni i cili vendos për kundërshtimin me aktvendim në afat prej pesë ditësh nga pranimi i kundërshtimit.

(11) Kundër aktvendimit nga paragrafi (10) i këtij neni, mund të paraqitet ankesë te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë, në afat prej tetë ditëve nga pranimi i aktvendimit, e cila nuk e prolongon lidhjen e marrëveshjes.

(12) Shpenzimet e noterit për solemnizimin e marrëveshjes janë obligim i ofertuesit më të volitshëm.

## **1.1. Drejtuesi i ndërtimit**

### **Neni 14**

(1) Gjatë ndërtimit të ndërtimeve nga neni 57 i këtij ligji, investuesi mund të përcaktojë drejtues të ndërtimit, i cili në emër të tij i udhëheq të gjitha punët organizative, i përcjell të gjitha fazat e ndërtimit dhe kryen përcjellje financiare dhe materiale të mjeteve në procesin e ndërtimit, deri në marrjen e lejes për përdorim.

(2) Drejtuesi i ndërtimit mund të jetë personi juridik, i cili ka licencë për drejtues të ndërtimit.

(3) Për marrjen e licencës së drejtuesit të ndërtimit, personi juridik duhet të dorëzojë:

- dëshmi që është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe
- dëshmi që ka të punësuar së paku dy persona, prej të cilëve njëri me autorizim A për inxhinier mbikëqyrës, ose autorizim A për inxhinier për realizim dhe një person me autorizim B për inxhinier mbikëqyrës, ose autorizim B për inxhinier për realizim.

## **2. Projektimi**

### **Neni 15**

(1) Projektues është personi fizik i cili përpilon projekte për ndërtimin e ndërtesave nga neni 57 dhe posedon autorizim A dhe/ose autorizim B për projektim. Projektuesi obligohet që projektin ta përpilojë në pajtim me standardet dhe normativat për projektim dhe i njëjti është përgjegjës për harmonizimin e projektit me kushtet e ndërtimit.

(2) Projektuesi punët e projektimit i kryen te personi juridik, i cili është i regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë (në tekstin në vijim: Regjistri qendror) për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe i cili posedon licencë për projektim.

### **2.1. Licenca për projektim**

## Neni 16

(1) Personi juridik për projektimin e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, duhet ta ketë licencën A për projektim, ndërsa për ndërtime të kategorisë së dytë licencën B për projektim.

(2) Për të marrë licencën A për projektim, personi juridik duhet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe
- dëshmi se ka së paku tre inxhinierë të punësuar, prej të cilëve njëri me autorizimin A për projektim dhe njëri me autorizimin B për projektim.

(3) Me kërkesën për marrjen e licencës B për projektim, personi juridik duhet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe
- dëshmi se ka të punësuar së paku dy inxhinierë, prej të cilëve njëri me autorizimin B për projektim.

## 2. 2. Autorizimi për projektim

### Neni 17

(1) Për projektimin e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, Oda e Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar jep autorizim A për përpilimin e dokumentacionit projektues, ndërsa për ndërtimet e kategorisë së dytë autorizim B për përpilim të dokumentacionit projektues.

(2) Me kërkesën për marrjen e autorizimit A për përpilimin e dokumentacionit projektues, personi fizik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi për arsim të lartë të kryer të drejtimit adekuat teknik (diplomë apo certifikatë për arsimin e lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi e ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 300 kredi),
- dëshmi për përvojë pune prej së paku pesë vjetësh, në përpilimin e dokumentacionit projektues nga sfera adekuate dhe
- dëshmi të pjesëmarrjes në përpunimin e së paku tre dokumentacioneve projektuese nga sfera adekuate, për ndërtime të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik te i cili është përpiluar dokumentacioni projektues.

(3) Me kërkesën për marrjen e autorizimit B për përpunimin e dokumentacionit projektues, personi fizik duhet të dorëzojë:

- dëshmi për arsim të lartë të kryer të drejtimit adekuat teknik (diplomë apo certifikatë për arsimin e lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi e ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 240 kredi),
- dëshmi për përvojë pune prej së paku dy vjetësh, në përpilimin e dokumentacionit projektues nga sfera adekuate dhe
- dëshmi të pjesëmarrjes në përpilimin e së paku tre dokumentacioneve projektuese nga sfera adekuate, për ndërtime të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik te i cili është përpiluar dokumentacioni projektues.

### Neni 18

(1) Nëse në projektim marrin pjesë më shumë projektues, personi juridik për projektim, emëron projektues kryesor i cili është përgjegjës për harmonizimin e plotë të projekteve.

(2) Projektuesi kryesor gjatë projektimit e siguron dhe koordinon përpilimin e projekteve dhe përgjigjet për zbatimin e dispozitave për projektim.

(3) Projektuesi kryesor në të njëjtën kohë mund të jetë edhe projektues për llojin e caktuar të projektit i cili është pjesë adekuate e dokumentacionit projektues.

## **Neni 19**

(1) Për shkak të kontrollimit të realizimit të projektit gjatë ndërtimit, projektuesi mund të kryejë mbikëqyrje mbi projektin me kërkesën e investuesit.

(2) Inxhinieri mbikëqyrës mund të kërkojë që të kryhen ndryshime të pjesëve të caktuara të projektit.

(3) Në raste nga paragrafi (2) i këtij neni, zbatohet procedura për ndryshim gjatë ndërtimit në pajtim me nenin 69 të këtij ligji.

## **3. Revizioni**

### **Neni 20**

(1) Revidenti është personi fizik i cili kryen revizionin e projekteve për ndërtim të ndërtimeve nga neni 57 i këtij ligji, për konfirmimin e harmonizimit të projektit me dispozitat e këtij ligji, standardet dhe normativat për projektim dhe dispozitat teknike për ndërtim, dhe ka autorizim A dhe/ose autorizim B për kryerjen e revizionit.

(2) Revidenti e kryen revizionin në personin juridik i cili është i regjistruar në Regjistrin qendror për kryerjen e veprimtarisë adekuate, dhe që posedon licencë për revizion të dokumentacionit projektues.

(3) Revidenti nuk mund ta kryejë revizionin e dokumentacionit projektues për ndërtim, i cili në tërësi ose në pjesë të veçanta të tij, është i përpiluar nga personi juridik ku ai është i punësuar.

### **Neni 21**

(1) Revizioni i projektit themelor varësisht nga karakteri i ndërtimit, duhet të zbatohet në aspekt të plotësimit të kërkesave themelore të ndërtimit, në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër.

(2) Revizioni i projektit themelor, patjetër duhet të kryhet në aspekt të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtimit.

(3) Reviduesi për revizionin e kryer të projektit, obligohet që të përpilojë raport në formë të shkruar dhe ta verifikojë projektin e reviduar.

(4) Revizioni i projektit themelor, detyrimisht kryhet në të gjitha fazat e projektit themelor.

### **Neni 22**

Përmbajtjen dhe vëllimin e kryerjes së revizionit, mënyrën e verifikimit të projektit të reviduar nga ana e reviduesit, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

### **3.1. Licenca për revidimin e dokumentacionit projektues**

#### **Neni 23**

(1) Personi juridik për kryerjen e revidimit të projekteve për ndërtimet e kategorisë së parë nga neni 57 të këtij ligji, duhet ta ketë licencën A për revidimin e dokumentacionit projektues, ndërsa për ndërtimet e kategorisë së dytë licencën B, për revidim të dokumentacionit projektues.

(2) Për marrjen e licencës A për revidimin e dokumentacionit projektues, personi juridik duhet të dorëzojë:

- dëshmi se është regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe
- dëshmi se ka të punësuar së paku tre inxhinierë, njëri prej të cilëve me autorizim A për revidimin e dokumentacionit projektues dhe njëri me autorizim B për revidimin e dokumentacionit projektues.

(3) Me kërkesën për marrjen e licencës B për revidimin e dokumentacionit projektues, personi juridik duhet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe
- dëshmi se ka të punësuar së paku dy inxhinierë njëri prej të cilëve me autorizim B, për revizionin e dokumentacionit projektues.

### **3.2. Autorizimi për revizionin e dokumentacionit projektues**

#### **Neni 24**

(1) Për kryerjen e revidimit të projekteve për ndërtimet e kategorisë së parë nga neni 57 të këtij ligji, Oda e Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar e jep autorizimin A për revizionin e dokumentacionit projektues, ndërsa për ndërtimet e kategorisë së dytë autorizimin B, për revidimin e dokumentacionit projektues.

(2) Me kërkesën për marrjen e autorizimit A për revizionin e dokumentacionit projektues, personi fizik duhet të dorëzojë:

- dëshmi për arsim të lartë të kryer të drejtimit adekuat teknik (diplomë apo çertifikatë për arsimin e lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi e ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 300 kredi),
- dëshmi për përvojë pune prej së paku pesë vjetësh në kryerjen e revizionit të dokumentacionit projektues nga sfera adekuate, ose përvojë pune prej së paku pesë vjetësh në udhëheqje të procedurës për lëshimin e lejes për ndërtim, të ndërtimeve të kategorisë së parë, nga neni 57 i këtij ligji dhe
- dëshmi për pjesëmarrje në së paku tre revizione të dokumentacionit projektues nga sfera adekuate, për ndërtimet e kategorisë së parë nga neni 57 të këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik në të cilin është kryer revizioni.

(3) Me kërkesën për marrjen e autorizimit B për revizionin e dokumentacionit projektues, personi fizik duhet të dorëzojë:

- dëshmi për arsim të lartë të kryer të drejtimit adekuat teknik (diplomë apo çertifikatë për arsimin e lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi e ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 240 kredi),
- dëshmi për përvojë pune prej së paku prej dy vjetësh në kryerjen e revizionit të dokumentacionit projektues nga sfera adekuate ose përvojë pune së paku prej pesë vjetësh, në udhëheqje të procedurës për lëshimin

e lejes për ndërtim të ndërtimeve të kategorisë së dytë, nga neni 57 i këtij ligji dhe

- dëshmi për pjesëmarrje në së paku tre revizione të dokumentacionit projektues nga sfera adekuate për ndërtimet e kategorisë së dytë nga neni 57 të këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik në të cilin është kryer revizioni.

## **4. Kryerja**

### **Neni 25**

(1) Kryerës është personi juridik i cili e kryen, përkatësisht e ndërton ndërtimin ose pjesë të ndërtimit, në bazë të marrëveshjes për ndërtim të lidhur me investuesin.

(2) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin qendror për kryerjen e punëve ndërtimore dhe/ose ndërtimore - zejtare dhe të ketë licencë për kryerës.

### **4.1. Licenca për kryerës**

#### **Neni 26**

(1) Për kryerjen e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, personi juridik duhet të ketë Licencë A për realizues, ndërsa për kryerjen e ndërtimeve të kategorisë së dytë personi juridik duhet të ketë Licencë B për realizues.

(2) Me kërkesën për marrjen e licencës A për realizues të këtij ligji, personi juridik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe  
- dëshmi se ka të punësuar së paku 20 persona, prej të cilëve tre me autorizim A për inxhinier për realizim dhe një person me autorizim B për inxhinier për realizim.

(3) Me kërkesën për marrjen e licencës B për realizues, personi juridik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe  
- dëshmi se ka të punësuar së paku pesë persona, prej të cilëve dy me autorizim B për inxhinierë për kryerje.

#### **Neni 27**

Kryerësi kryerjen e punëve të caktuara të ndërtimit mund t'ia besojë personit tjetër juridik (nënkryerës), i cili i plotëson kushtet për kryerjen e atyre punëve të përcaktuara me këtë ligj, për të cilat lidh marrëveshje.

#### **Neni 28**

Kryerjen e punëve të ndërtimit dhe punëve të tjera në ndërtim, i cili është i regjistruar në Regjistrin nacional të trashëgimisë kulturore mund ta kryejë personi, i cili krahas kushteve të përcaktuara me këtë ligj, i plotëson edhe kushtet e përcaktuara me dispozitat nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

#### **Neni 29**

(1) Kryerësi është i obliguar:

- të kryejë punë ndërtimore në pajtim me licencën e marrë;

- të kryejë punë ndërtimore në pajtim me lejen për ndërtim, projektin e reviduar themelor dhe realizues, e nëse është lëshuar leje për ndërtim në bazë të projektit ideor në pajtim me Ligjin për zona zhvillimore industriale teknologjike dhe Ligjin për zona të gjelbra industriale të realizojë punë ndërtimore në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin ideor;;
- të mbajë ditar ndërtimi dhe libër ndërtimi, gjatë kryerjes së punëve të ndërtimit;
- të sigurojë dëshmi për kualitet të përcaktuar të prodhimeve të futura ndërtimore;
- të zbatojë masa për mbrojtje dhe siguri në kantierin e ndërtimit, në pajtim me ligjin dhe
- të sigurojë dëshmi për prejardhjen e gurit ndërtimor teknik, rërës për ndërtim dhe zhavorrit (marrëveshje për shitblerje, faturë, vërtetim pagesë dhe ngjashëm) dhe
- të sigurojë mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës gjatë ndërtimit dhe mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës pas ndërtimit të tërë sistemit konstruktiv të ndërtesës.

(2) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit dhe të librit të ndërtimit, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

### **Neni 30**

(1) Kryerësi cakton inxhinier për kryerje, i cili udhëheq me ndërtimin e ndërtesës dhe është përgjegjës për plotësimin e obligimeve të përcaktuara me nenin 29 të këtij ligji.

(2) Gjatë ndërtimit të ndërtesës kryerësi mund të caktojë më shumë inxhinierë për kryerje, me ç'rast e cakton inxhinierin kryesor për kryerje, i cili do të jetë përgjegjës për plotësimin e obligimeve të përcaktuara me nenin 29 të këtij ligji, si dhe për harmonizimin e ndërsjellë të punëve.

(3) Inxhinieri për ndërtim është person fizik me drejtim teknik adekuat, i cili ka autorizim për inxhinier për kryerje në pajtim me këtë ligj.

## **4.2. Autorizimet për inxhinier për kryerje**

### **Neni 31**

(1) Për udhëheqje me ndërtimin e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 të këtij ligji, Oda e Arkitektëve dhe Inxhinierë të Autorizuar jep autorizimin A për inxhinier për kryerës, ndërsa për ndërtime të kategorisë së dytë autorizimin B për inxhinier për kryerës.

(2) Me kërkesën për marrjen e autorizimit A për inxhinier për kryerje, personi fizik duhet të dorëzojë:

- dëshmi për arsim të lartë të kryer të drejtimit adekuat teknik (diplomë apo certifikatë për arsimin e lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi e ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 300 kredi),
- dëshmi për përvojë pune prej së paku prej pesë vjetësh në ndërtimin e ndërtimeve nga neni 57 të këtij ligji dhe
- dëshmi për pjesëmarrje në së paku tre ndërtime të kategorisë së parë nga neni 57 të këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik i cili i ka kryer ndërtimet.

(3) Me kërkesën për marrjen e autorizimit B për inxhinier për kryerës, personi fizik duhet të dorëzojë:

- dëshmi për arsim të lartë ose shkollë të lartë të kryer të drejtimit adekuat teknik (diplomë apo certifikatë për arsimin e lartë ose shkollën e lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi e ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 180 kredi),
- dëshmi për përvojë pune së paku prej dy vjetësh në ndërtimin e ndërtimeve nga neni 57 të këtij ligji për persona me arsim sipëror, përkatësisht së paku pesë vjet për persona me arsim të lartë dhe
- dëshmi për pjesëmarrje së paku në tre ndërtime të kategorisë së dytë nga neni 57 të këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik i cili i ka kryer ndërtimet.

## Neni 32

*I fshirë* 3

## 5. Mbikëqyrja e ndërtimit

### Neni 33

(1) Inxhinier mbikëqyrës është personi fizik i cili kryen mbikëqyrjen e ndërtimit të ndërtesës dhe ka autorizimin A dhe/ose autorizimin B për inxhinier mbikëqyrës.

(2) Inxhinieri mbikëqyrës nga paragrafi 1 i këtij neni, i kryen punët e mbikëqyrjes në personin juridik të regjistruar në Regjistrin qendror për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe që posedon licencë për mbikëqyrje.

(3) Inxhinier mbikëqyrës nuk mund të jetë personi i punësuar në personin juridik kryerës i ndërtimit në të cilin kryhet mbikëqyrja, përndryshe kjo paraqet bazë për heqjen e përhershme të autorizimit për inxhinier mbikëqyrës.

### 5.1. Licenca për mbikëqyrje

#### Neni 34

(1) Personi juridik për kryerjen e mbikëqyrjes së ndërtimit të ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, duhet të ketë licencë A për mbikëqyrje, kurse për ndërtimet e kategorisë së dytë duhet të ketë licencë B për mbikëqyrje.

(2) Me kërkesën për marrjen e licencës A për mbikëqyrje, personi juridik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe
- dëshmi se ka të punësuar së paku katër inxhinierë, prej të cilëve dy me autorizim A për kryerje të mbikëqyrjes.

(3) Me kërkesën për marrjen e licencës B për mbikëqyrje, personi juridik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi se është regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe
- dëshmi se ka të punësuar së paku tre inxhinierë, prej të cilëve dy me autorizim B për kryerje të mbikëqyrjes.

### 5.2. Autorizimet për inxhinier mbikëqyrës

#### Neni 35



(1) Për kryerjen e mbikëqyrjes së ndërtimeve të kategorisë së parë, Oda e Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar e jep autorizimin A për inxhinier mbikëqyrës, ndërsa për ndërtime të kategorisë së dytë autorizimin B për inxhinier mbikëqyrës.

(2) Me kërkesën për marrjen e autorizimit A për inxhinier mbikëqyrës, personi fizik duhet të dorëzojë:

- dëshmi për arsim të lartë të kryer të drejtimit adekuat teknik (diplomë apo certifikatë për arsimin e lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi e ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 300 kredi),
- dëshmi për përvojë pune së paku prej pesë vjetësh, në kryerjen e mbikëqyrjes mbi kryerjen e ndërtimeve nga neni 57 të këtij ligji ose në ndërtimin e ndërtimeve nga neni 57 i këtij ligji dhe
- dëshmi për pjesëmarrje në kryerjen e mbikëqyrjes nga sfera adekuate në së paku tre ndërtime të kategorisë së parë nga neni 57 të këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik në të cilin është e kryer mbikëqyrja ose dëshmi për pjesëmarrje në ndërtimin e së paku tre ndërtimeve të kategorisë së parë dhe të dytë nga neni 57 i këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik që i ka kryer ndërtimet.

(3) Me kërkesën për marrjen e autorizimit B për inxhinier mbikëqyrës, personi fizik është e nevojshme që të dorëzojë:

- dëshmi për arsim të lartë të kryer të drejtimit adekuat teknik (diplomë apo certifikatë për arsimin e lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi e ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 240 kredi),
- dëshmi për përvojë pune së paku prej tri vjetësh në kryerjen e mbikëqyrjes në ndërtimin e ndërtimeve nga neni 57 i këtij ligji, ose në ndërtimin e ndërtimeve nga neni 57 i këtij ligji dhe
- dëshmi për pjesëmarrje në kryerjen e mbikëqyrjes nga sfera përkatëse në së paku për tre ndërtime të kategorisë së tretë, të katërt dhe të pestë nga neni 57 të këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik në të cilin është kryer mbikëqyrja ose dëshmi për pjesëmarrje në ndërtimin e së paku tri ndërtimeve të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji, të vërtetuar nga personi juridik që i ka kryer ndërtimet.

## Neni 36

(1) Inxhinieri mbikëqyrës është i obligueshëm:

- të kryejë kontroll mbi ndërtimin se i njëjti a është në pajtim me projektin themelor dhe lejen për ndërtim, e nëse është lëshuar leja për ndërtim në bazë të projektit ideor në pajtim me Ligjit për zona zhvillimore industriale teknologjike dhe Ligjit për zona të gjelbra industriale të kryejë kontroll mbi ndërtimin nëse i njëjti është në pajtim me projektin ideor ose lejen për ndërtim,
- të përcaktojë nëse është bërë shënimi i ndërtimit të projektuar në terren në pajtim me nenin 82 të këtij ligji,
- të kryejë kontrollin e ndërtimit në secilën fazë të ndërtimit (gjatë shënimit dhe vënies së bazës së ndërtimit nga projektit i vetë trullit të parashikuar për ndërtim, gjatë kryerjes së mihjes për ndërtimin e themeleve, gjatë ndërtimit të secilit nivel, përkatësisht kati nga ndërtimi, gjatë ndërtimit të konstruksionit të çatisë, përfundimit të fasadave dhe të gjitha punëve të zëjtarisë),
- të vërtetojë nëse pjesëmarrësit në ndërtim i posedojnë licencat dhe autorizimet adekuate,
- ta kryejë kontrollin e kualitetit të materialëve të futura në ndërtim,
- të vërtetojë nëse realizuesi ka siguruar dëshmi për prejardhjen e gurit ndërtimor,

- të përcaktojë nëse realizuesi ka siguruar mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës gjatë ndërtimit dhe mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës pas ndërtimit të tërë sistemit konstruktiv të ndërtesës.

- teknik, rërës dhe zhavorrit ndërtimor, e nëse konstaton se ato nuk janë siguruar, për këtë ta informojë organin kompetent nga neni 58 i këtij ligji, që e ka lëshuar lejen për ndërtim si dhe Inspektoratin Shtetëror për Inspeksion Teknik,

- ta njoftojë investuesin dhe inspektorin kompetent të ndërtimtarisë, për mangësitë ose parregullsitë e konstatuara gjatë kohës së ndërtimit dhe të njëjtat t'i shënojë në ditarin e ndërtimit dhe

- të përgatisë raport përfundimtar për mbikëqyrjen e kryer.

(2) Në secilën fazë të ndërtimit të ndërtesës, kryerësi dhe investuesi janë të obliguar që t'i mundësojnë inxhinierit mbikëqyrës ta kryejë kontrollin, në të kundërtën inxhinieri mbikëqyrës është i obliguar që ta njoftojë inspektorin kompetent mbikëqyrës të kryejë kontroll në vendngjarje dhe së bashku ta konstatojnë gjendjen e ndërtimit.

(3) Për secilën fazë të ndërtimit të ndërtesës inxhinieri mbikëqyrës përpilon raport me shkrim për kontrollin e kryer me vlerësim për harmonizimin e ndërtimit, me projektin dhe kushtet për ndërtim.

(4) Gjatë ndërtimit të ndërtesës personi juridik i cili kryen mbikëqyrje, mund të caktojë më shumë inxhinierë mbikëqyrës, me ç'rast cakton inxhinier kryesor mbikëqyrës që do të jetë përgjegjës për harmonizimin e ndërsjellë të mbikëqyrjes mbi ndërtimin dhe për përgatitjen dhe dorëzimin e raportit përfundimtar për mbikëqyrjen e kryer.

### **Neni 36-a**

Personi që kryen mbikëqyrje të ndërtimit të objekteve me dedikim për depo dhe magazina për mbikëqyrjen e kryer nuk guxon të përcaktojë çmim më të lartë se 0,5% nga vlera e objektit

### **Neni 37**

*I fshirë* 4

## **6. Lëshimi dhe heqja e licencave dhe autorizimeve**

### **Neni 38**

(1) Licencat e përcaktuara me këtë ligj, lëshohen pas kërkesës së parashtruar për një periudhë prej shtatë vjetësh dhe të njëjtat nuk mund t'i bartet personit tjetër. Licencat i lëshon, heq dhe mban regjistër për lëshimin dhe tërheqjen e licencave, organi kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(2) Për marrjen e licencës personat juridikë paguajnë kompensim përkatës. Lartësinë e kompensimit varësisht nga lloji i licencës e përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, me ç'rast i njëjti nuk mund të jetë më pak se 200 euro me kundërvlerë në denarë, e as më shumë se 3 000 euro me kundërvlerë në denarë. Mjetet e realizuara prej kompensimit janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Licenca pas kalimit të afatit për të cilin është lëshuar, mund të përsëritet nëse personi juridik i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë

ligj. Për përsëritjen e licencës nuk paguhet kompensimi nga paragrafi (2) i këtij neni

(4) Licenca e lëshuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji hiqet nëse konstatohet se personi juridik - bartës i licencës pushon të plotësojë ndonjë nga kushtet për lëshimin e licencës, ose personi juridik nuk e ka plotësuar obligimin për sigurim për përgjegjësi të dëmit në kompaninë e sigurimit në Republikën e Maqedonisë në pajtim me nenin 41-a të këtij ligji, ose personi juridik ka pushuar së ekzistuari.

(5) Licenca për realizues hiqet nëse personi juridik-realizues realizon ndërtime në kundërshtim me lejen për ndërtim apo pa leje për ndërtim, licenca për mbikëqyrje hiqet nëse personi juridik për kryerjen e mbikëqyrjes së ndërtimit të ndërtimeve përpilon apo verifikon raport me shkrim për fazë të caktuar për ndërtimin me konstatime që nuk janë në përputhje me punët e realizuara, përpilon apo verifikon raport përfundimtar për mbikëqyrje të kryer me konstatime që nuk janë në përputhje me punët e realizuara, përpilon apo verifikon raport për kontroll teknik të kryer në kundërshtim me dispozitat nga neni 90 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji, licenca për projektim hiqet nëse personi juridik për projektim të ndërtesave ka përpiluar përkatësisht ka verifikuar dokumentacion projektues në kundërshtim të dispozitave ligjore, kurse licenca për revizion të dokumentacionit të projektit hiqet nëse personi juridik për revizion të dokumentacionit të projektit përpilon, përkatësisht verifikon raport për revizion të dokumentacionit të projektit në kundërshtim me rregullat ligjore.

(6) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, licenca hiqet me detyrë zyrtare, kurse në rastet nga paragrafi (5) i këtij neni, licenca hiqet në bazë të propozimit të inspektorit ndërtimor ose inspektorit të autorizuar ndërtimor me procesverbal për parregullsi të konstatuar, kurse për ndërtesat nga kategoria e dytë nga neni 57 i këtij ligji edhe në bazë të propozimit të organit kompetent për lëshim të lejes për ndërtim nga neni 58 i këtij ligji, për këtë lloj të ndërtesave, me procesverbal për parregullsi të konstatuar. Licenca hiqet me aktvendim të organit kompetent për kryerjen e punëve nga sfera për rregullimin e hapësirës, nga dita kur aktvendimi për heqjen e licencës është bërë i plotfuqishëm. Kundër aktvendimit nuk mund të paraqitet ankesë, kurse lejohet padi para Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

(7) Aktvendimi i plotfuqishëm për heqjen e licencës evidentohet në Regjistrin për licenca të lëshuara dhe të hequra. Organi kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor aktvendimin e plotfuqishëm e dorëzon te Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë për evidentim të ndalimit nga paragrafi (8) i këtij neni.

(8) Personi juridik bartës i licencës A që i është hequr për shkak të parregullsive të theksuara në paragrafin (4) të këtij neni, nuk mund të marrë licencë A për kryerjen e punëve të njëjta për të cilat ka të bëjë licenca e hequr, në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të licencës, personi juridik bartës i licencës B që i është hequr për shkak të parregullsive të theksuara në paragrafin (4) të këtij neni, nuk mund të marrë licencë A dhe licencë B për kryerjen e punëve të njëjta për të cilat ka të bëjë licenca e hequr, në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të licencës, e personi juridik licenca e të cilit është hequr për shkak të parregullsive të theksuara në paragrafin (5) të këtij neni, nuk mund të marrë licencë A dhe licencë B për kryerjen e punëve të njëjta për të cilat ka të bëjë licenca e hequr, në afat prej pesë vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje

të licencës. Personi përgjegjës në personin juridik të cilit i është hequr licenca për shkak të parregullsive të theksuara në paragrafin (4) të këtij neni, nuk mund të themelojë person tjetër juridik për kryerjen e veprimtarisë së njëjtë të cilën e ka kryer personi juridik të cilit i është hequr licenca në pajtim me këtë ligj, në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të licencës, kurse personi përgjegjës në personin juridik të cilit i është hequr licenca për shkak të parregullsive të theksuara në paragrafin (5) të këtij neni, nuk mund të themelojë person tjetër juridik për kryerjen e veprimtarisë së njëjtë të cilën e ka kryer personi juridik të cilit i është hequr licenca në pajtim me këtë ligj, në afat prej pesë vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të licencës. Personi juridik licenca e të cilit është hequr detyrohet që ta kthejë të njëjtën në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, në afat prej tetë ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit për heqje të licencës.

(9) Mënyrën dhe procedurën për lëshimin, përsëritjen, tërheqjen e licencës, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

(10) Në bazë të licencës së lëshuar për kryerjen e punëve të realizimit, projektimit, revizionit, mbikëqyrjes dhe mirëmbajtjes së ndërtimit nga neni 57 të këtij ligji, personi juridik mund t'i kryejë këto punë edhe për ndërtime të kategorisë më të ulët se kategoria të cilës i takojnë ndërtimet për të cilat është lëshuar licenca.

(11) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

## Neni 39

(1) Autorizimet e përcaktuara me këtë ligj, lëshohen pas kërkesës së parashtruar, për një periudhë prej pesë vjetësh dhe të njëjtat nuk mund të barten te personi tjetër. Autorizimet i lëshon, tërheq dhe mban regjistër për lëshimin dhe tërheqjen e autorizimeve Oda e Arkitekteve dhe Inxhinierëve të Autorizuar.

(2) Për marrjen e autorizimeve paguhet kompensim, në pajtim me listën e çmimeve për shërbime publike nga neni 109 paragrafit (1) pika 7 të këtij ligji. Mjetet e realizuara nga kompensimi për marrjen e autorizimeve nga ky nen, janë të hyra të Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar.

(3) Autorizimi pas kalimit të afatit për të cilin është lëshuar mund të përsëritet me kërkesë të personit fizik. Për përsëritjen e autorizimit nuk paguhet kompensimi nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Autorizimi i lëshuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji hiqet nëse organi kompetent i Odës së Arkitektëve të Autorizuar dhe Inxhinierëve të Autorizuar, konstaton se personi fizik nuk i përmbahet Listës së çmimeve nga neni 109 pika 7 e këtij ligji, nuk ka paguar anëtarësim vjetor ose nuk i përmbahet Kodeksit të etikës profesionale të arkitekteve të autorizuar dhe inxhinierëve të autorizuar.

(5) Autorizimi për inxhinier të realizimit hiqet nëse inxhinieri i realizimit realizon ndërtime në kundërshtim me lejen për ndërtim apo pa leje për

ndërtim, autorizimi për inxhinier mbikëqyrës hiqet nëse inxhinieri mbikëqyrës përpilon raport me shkrim për fazë të caktuar për ndërtimin me konstatime që nuk janë në përputhje me punët e realizuara, përpilon raport përfundimtar për mbikëqyrje të kryer me konstatime që nuk janë në përputhje me punët e realizuara, përpilon raport për kontroll teknik të kryer në kundërshtim me dispozitat nga neni 90 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji, autorizimi për përpunim të dokumentacionit të projektit hiqet nëse projektuesi ka përpiluar dokumentacion projektues në kundërshtim me dispozitat ligjore, kurse autorizimi për revizion të dokumentacionit të projektit hiqet nëse revidenti përpilon raport për revizion të dokumentacionit të projektit në kundërshtim me rregullat ligjore.

(6) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni autorizimi i merret sipas detyrës zyrtare, kurse në rastet nga paragrafi (5) i këtij neni autorizimi i merret në bazë të propozimit të inspektorit ndërtimore ose inspektorit të autorizuar ndërtimor me procesverbal për konstatim të parregullsive ose në bazë të propozimit të organit kompetent për lëshimin e lejes për ndërtim nga neni 58 nga ky ligj me procesverbal për parregullsi të konstatuar ose sipas detyrës zyrtare. Autorizimi hiqet me aktvendim të dhomës së arkitektëve të autorizuar ose inxhinierëve të autorizuar, nga dita kur aktvendimi për heqjen e licencës është bërë i plotfuqishëm. Kundër aktvendimit nuk mund të paraqitet ankesë, kurse lejohet padi para Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

(7) Aktvendimi i plotfuqishëm për heqjen e autorizimit evidentohet në Listën e emrave të arkitektëve dhe inxhinierëve të autorizuar.

(8) Person fizik autorizimi i të cilit është hequr për shkak të parregullsive të theksuara në paragrafin (4) të këtij nen, nuk mund të marrë autorizim A dhe autorizim B për kryerjen e punëve të njëjta për të cilët ka të bëjë autorizimi i hequr, në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të autorizimit, kurse personi fizik autorizimi i të cilit është hequr për shkak të parregullsive të theksuara në paragrafin (5) të këtij neni, nuk mund të marrë autorizim A dhe autorizim B për kryerjen e punëve të njëjta për të cilët ka të bëjë autorizimi i hequr, në afat prej shtatë vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të autorizimit. Personi fizik autorizimi i të cilit i është hequr detyrohet që ta kthejë të njëjtin në Odën e arkitektëve të autorizuar dhe inxhinierëve të autorizuar, në afat prej tetë ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit të heqjes së autorizimit.

(9) Mënyrën dhe procedurën për lëshimin, përsëritjes, heqjen e licencës, formën dhe përmbajtjen e formularit të autorizimeve si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(10) Në bazë të autorizimit të marrë A për kryerjen e punëve të realizimit, projektimit, revizionit, mbikëqyrjes së ndërtimit nga neni 57 të këtij ligji, personi fizik mund t'i kryejë këto punë edhe për ndërtime për të cilat në pajtim të këtij ligj është paraparë autorizimi.

(11) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

### **Neni 39-a**

(1) Për kërkesën nga nenet 38 paragrafi (1) dhe 39 paragrafi (1) të këtij ligji, organi kompetent është i obliguar që në afat prej 30 ditësh të lëshojë

licencë, përkatësisht autorizim ose të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës, përkatësisht autorizimit.

(2) Kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës, përkatësisht autorizimit, mund të parashtrohet ankesë në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

## **Neni 39-b**

*I fshirë* **5**

## **Neni 40**

Për kryerjen e punëve të rregullimit të brendshëm të ndërtimit, siç është vënia e ndriçimit, punëve për lyerjen-gjyrosje, vënia e parketit, pllakave, vënia e dyerve dhe dritareve, punë të instalimit të ujit, rregullimi i terrenit, si dhe punë të tjera zejtare, kryerësi i këtyre punëve duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin qendror për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe nuk duhet të ketë licencë ose autorizim në pajtim me këtë ligji.

## **Neni 41**

Pjesëmarrësit në ndërtimin e ndërtimeve nga neni 57 të këtij ligji, mund të parashikojnë dhënien e garancisë bankare, lartësinë e së cilës do ta përcaktojnë me marrëveshje reciproke, me të cilën do të garantohet kryerja me kohë dhe në mënyrë cilësore e punëve, kompensimi i dëmit eventual të shkaktuar gjatë kryerjes së punëve dhe pagesa në kohë për punët e kryera.

## **Neni 41-a**

(1) Pjesëmarrësit në ndërtimin e ndërtimeve nga neni 57 i këtij ligji (investuesi, personat juridikë për projektim, revizion, kryerje dhe mbikëqyrje të ndërtimit) përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga persona të tretë gjatë kryerjes së punës së tyre dhe obligimeve të kontraktuara.

(2) Personat juridikë për projektim, revizion, kryerje dhe mbikëqyrje të ndërtimit detyrohen që të kenë sigurim për përgjegjësi për dëm në kompani të sigurimit në Republikën e Maqedonisë, i cili me punën e tyre mund t'u shkaktohet investuesve ose personave të tretë.

(3) Shuma vjetore e siguruar për numrin e përgjithshëm të ndërtimeve për pjesëmarrësit në ndërtimin e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 euro në kundërvlerë me denarë, ndërsa për ndërtimet e kategorisë së dytë nuk mund të jetë më e vogël se 5.000 euro në kundërvlerë me denarë.

## **7. Personat e huaj fizikë dhe juridikë**

### **Neni 42**

(1) Personi i huaj juridik në Republikën e Maqedonisë mund t'i kryejë punët e projektimit, revizionit, realizimit dhe mbikëqyrjes të përcaktuara me këtë igj, nëse merr vërtetim për kryerjen e punëve të përmendura nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera për rregullimin hapësinor. Për marrjen e vërtetimit, personi juridik nga shteti i cili është anëtar i Unionit Evropian duhet të dorëzojë kërkesë dhe dëshmi me të cilat vërtetohet se personi është i regjistruar për

kryerjen e veprimtarisë përkatëse në vendin në të cilin ka seli dhe se ka leje përkatësisht licencë për kryerjen e punëve përkatëse për llojin e ndërtimit, për të cilat kërkon vërtetim, ndërsa personi juridik nga shteti i cili nuk është anëtar i Unionit Evropian, duhet të dorëzojë edhe listë për punët e kryera. Nëse në shtet nuk lëshohet leje përkatësisht licencë, personi juridik i huaj nga vendi anëtar i Unionit Evropian detyrohet që me kërkesë të dërgojë dëshmi nga organi kompetent në atë shtet se në pajtim me rregullat e tij për kryerje të punëve adekuate nuk lëshohet leje, përkatësisht licencë dhe dëshmi me të cilat vërtetohet se personi është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë adekuate në vendin në të cilin ka seli, kurse personi juridik nga shteti që nuk është anëtar i Unionit Evropian, duhet të dorëzojë edhe listë të punëve të kryera. Në bazë të dëshmive të parashtruara, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit hapësinor, do të lëshojë vërtetim se cilat pune në pajtim me këtë ligj, personi i huaj juridik mund t'i kryejë në Republikën e Maqedonisë.

(2) Personi fizik i huaj i cili ka autorizim të shtetit tjetër, mund të kryejë punë të projektimit, revizionit, kryerjes dhe mbikëqyrjes së ndërtimeve në Republikën e Maqedonisë, nëse autorizimi është i verifikuar nga ana e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar.

(3) Personi fizik i huaj mund t'i kryejë punët nga paragrafi (2) i këtij neni, te personi juridik i regjistruar në Regjistrin qendror për kryerjen e atyre punëve.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (3) të këtij neni, personi fizik vendas dhe i huaj mund të kryejë pune të projektimit, revizionit dhe mbikëqyrjes së ndërtimeve në Republikën e Maqedonisë edhe në mënyrë të pavarur, nëse është zgjedhur në procedurë për furnizim publik për kryerjen e këtyre punëve në projektin e financuar nga organizata ndërkombëtare dhe nga Unioni Evropian.

(5) Verifikimin e autorizimit e kryen komisioni nga neni 55 i këtij ligji, me ç'rast përcakton nëse autorizimi i personit fizik të huaj, është përkatës me autorizimin e përcaktuar me këtë ligj. Nëse komisioni konfirmon se autorizimi është përkatës, jep vërtetim për autenticitetin e të njëjtit dhe për llojin e autorizimit të cilin personi fizik i huaj e merr në Republikën e Maqedonisë. Për marrjen e vërtetimit paguhet kompensim, në pajtim me listën e çmimeve për shërbime publike nga neni 109, paragrafi (1), pika 7 të këtij ligji.

(6) Me përjashtim personi i huaj juridik dhe fizik, mund t'i kryejnë punët e projektimit, revizionit, kryerjes dhe mbikëqyrjes, të përcaktuara me këtë ligj nëse është lidhur marrëveshje ndërkombëtare për reciprocitet, në pajtim me kushtet e përcaktuara në marrëveshje.

## IV. DOKUMENTACIONI PROJEKTUES

### Neni 43

(1) Dokumentacioni projektues parqet tërësinë e studimeve të harmonizuara në mënyrë të ndërsjellë, projekteve, elaborateve, analizave, ekspertizave dhe të dokumentacion tjetër, me të cilat përcaktohet koncepti dhe definohet zgjidhja teknike e ndërtimit, përpunohen kushtet dhe mënyrat e ndërtimit dhe sigurohen funksioni i tyre teknologjik, kohëzgjatja e paraparë dhe kushtet për përdorim.

(2) Sipas nivelit të përpunimit, projekti mund të jetë:

- 1) projekt për punë përgatitore;
- 2) projekt themelor;
- 3) projekt ideor;
- 4) projekt i gjendjes së realizuar, dhe
- 5) projekt për përdorimin dhe mirëmbajtjen e ndërtimit.

(3) Sipas dedikimit projekti mund të jetë:

- 1) arkitektonik;
- 2) ndërtimor (statikë me sizmikë);
- 3) elektroteknik;
- 4) i komunikacionit;
- 5) termoteknik dhe
- 6) projekte dhe elaborate tjera, varësisht nga dedikimi i ndërtimit.

(4) Projektet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, përpunohen në pajtim me standardet dhe normativat për projektim dhe rregullat tjera teknike, me të cilat përcaktohen parametrat themelorë gjatë projektimit dhe formësimit arkitektonik të ndërtimit.

(5) Standardet dhe normativat për projektim nga paragrafi (4) i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

## Neni 44

(1) Dokumentacioni projektues, përkatësisht projektet e veçanta në mënyrë të obligueshme kanë pjesë të përgjithshme që përmban:

- 1) emrin dhe nënshkrimin e projektuesit, titullin e ndërtimit me lokacionin e saktë, emrin, përkatësisht titullin e investuesit, shenjën dhe numrin teknik të dokumentacionit projektues për ndërtim sipas fazave të veçanta dhe datën e përpunimit,
- 2) dëshmi për regjistrimin e personit juridik ku është i verifikuar dokumentacioni projektues me veprimtari prioritare ose shifër kryesore të hyrave dhe verifikim me vulë,
- 3) dëshmi për licencë për projektim për personin juridik dhe për autorizim për projektues,
- 4) program projektues të nënshkruar nga investuesi, me të cilin përcaktohen kushtet arkitektonike, tekniketeknologjike dhe të tjera për përpunimin e dokumentacionit projektues dhe
- 5) arsyetim të projektit, matjen dhe llogaritjen projektuese të punëve ndërtimore.

## Neni 45

*I fshirë* 6

## Neni 45-a

(1) Projekti për infrastrukturë përpilohet për objekte infrastrukture në linjë, për pjesë funksionale të objekteve infrastrukture si dhe për objekte infrastrukture që përbëhen nga më tepër pjesë prej të cilave të paktën njëra pjesë paraqet infrastrukturë të linjës. Projekti përmban zgjidhje teknike për infrastrukturën me të gjithë elementët e tij në pjesën tekstuale dhe shtojcat grafike dhe e pasqyrojnë trasenë e infrastrukturës dhe të dhëna tjera për ndërtesën.

(2) Projekti i infrastrukturës përmban dhe studim për vlerësimin e ndikimit të projektit mbi mjedisin jetësor, përkatësisht elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të miratuara nga organi kompetent, nëse me rregullat



nga sfera e mjedisit jetësor është paraparë përpilimi i studimit, përkatësisht elaboratit për lloj të atillë të infrastrukturës.

## **1. Projekti për punë përgatitore**

### **Neni 46**

Projekti për punët përgatitore varësisht nga ndërlikimi dhe struktura teknike e ndërtimit, përbëhet prej:

- pjesës tekstuale që përmban përshkrimin e lokacionit dhe mënyrën e furnizimit të kantierit të ndërtimit me energji elektrike dhe ujë, mënyrën e bartjes së hedhurinave dhe ujërave të ndotur prej lokalitetit të kantierit të ndërtimit, mënyrën e kycjes së kantierit të ndërtimit në rrugët ekzistuese të komunikacionit dhe mënyrën e trajtimit të mbeturinave ndërtimore (hedhurina ndërtimore) të krijuara në kantierin e ndërtimit dhe
- shtojcës grafike, që e përmban skemën e organizimit të kantierit të ndërtimit dhe mënyrën e kycjes së kantierit të ndërtimit në rrugët ekzistuese të komunikacionit.

## **2. Projekti themelor**

### **Neni 47**

(1) Projekt themelor, është përmbledhja e projekteve të harmonizuara në mënyrë të ndërsjellë me të cilin jepet zgjidhje teknike e ndërtimit, tregohet vendosja e ndërtimit në lokacion dhe plotësimi i kërkesave themelore për ndërtim dhe i njëjti përpunohet në bazë të ekstraktit nga plani i detajuar urbanistik ose plani urbanistik për jashtë vendbanimit ose plani urbanistik për fshat ose dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror, përkatësisht lokal, ndërsa për ndërtimet urbanistike në linjë në bazë të projektit për infrastrukturë të përpiluar në pajtim me ligjin.

(2) Në rastet nga neni 48-a paragrafi (3) të këtij ligji projekti themelor përpunohet në bazë të dispozitave të projektit ideor.

(3) Projekti themelor përmban projekte përkatëse nga neni 43 paragrafi (3) i këtij ligji.

(4) Projekti themelor përmban studim për vlerësimin e ndikimit të projektit mbi mjedisin jetësor, përkatësisht elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të miratuara nga organi kompetent, nëse me rregullat nga sfera e mjedisit jetësor është paraparë përpilimi i studimit, përkatësisht elaboratit për lloj të atillë të ndërtimit.

(5) Projekti themelor për ndërtime infrastrukturore në linjë për të cilat është përpiluar projekt për infrastrukturë, nuk përmban studim për vlerësimin e ndikimit të projektit mbi mjedisin jetësor, përkatësisht elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të miratuara nga organi kompetent.

(6) Projekti themelor përveç për ndërtime për banim individual dhe objekte publike me kapacitet për qëndrim të njëkohshëm deri në 25 persona, përmban edhe elaborat për mbrojtje nga zjarret, shpërthimet dhe materiet e rrezikshme.

(7) Në rast kur projekti themelor për ndërtime infrastrukturore në linjë është përpiluar para miratimit të projektit për infrastrukturë, harmonizimi i tij me projektin për infrastrukturë vërtetohet në raportin për revizion të projektit themelor, nga ana e personit juridik që kryen revizion të projektit themelor.

(8) Projekti themelor për ndërtesa që gjenden në apo pranë ujërave sipërfaqësore, ndërtesa që kalojnë përmes apo nën ujërat sipërfaqësore, ndërtesa që janë vendosur në afërsi të ujërave sipërfaqësore apo tokave bregdetare, e të cilat mund të ndikojnë në regjimin e ujërave, si dhe për objektet e ekonomive të ujërave të përcaktuara me Ligjin për ujëra, përmban edhe pëlqim të ekonomisë së ujërave.

(9) Projekti themelor për ndërtesa për të cilat zbatohet Rregullorja për karakteristika energjetike të ndërtesave përmban edhe vërtetim nga tregtari individ apo personi juridik që posedon licencë për kryerje të kontrollit energjetik, me të cilën vërtetohet se kërkesat minimale për efikasitet energjetik që përmbahen në projektin themelor janë në pajtim me kërkesat minimale për efikasitet energjetik.

## **Neni 48**

(1) Projekti bazë për rikonstrukcion e përmban projektin e gjendjes ekzistuese dhe projektin për rikonstrukcion.

(2) Projekti i gjendjes ekzistuese e përmban incizimin e gjendjes ekzistuese dhe kontrollin e plotësimit të kërkesave themelore për ndërtim.

(3) Projekti për rikonstrukcion varësisht nga lloji i rikonstrukcionit dhe dedikimi i ndërtimit, përmban projekte të veçanta të nevojshme nga neni 43 paragrafi (3) të këtij ligji.

(4) Projekti themelor për rikonstruktiv të ndërtesave që gjenden në apo pranë ujërave sipërfaqësore, ndërtesave që kalojnë përmes apo nën ujërat sipërfaqësore, ndërtesave që janë vendosur në afërsi të ujërave sipërfaqësore apo tokave bregdetare, e të cilat mund të ndikojnë në regjimin e ujërave, si dhe për rikonstruktimin e objekteve të ekonomive të ujërave të përcaktuara me Ligjin për ujëra, përmban edhe pëlqim të ekonomisë së ujërave.

(5) Projekti themelor për rikonstruktimin e ndërtesave për të cilat zbatohet Rregullorja për karakteristika energjetike të ndërtesave, përveç ndërtesave për banim individual, gjatë rikonstruktimit të konsiderueshëm, përmban edhe vërtetim nga tregtari individ apo personi juridik që posedon licencë për kryerje të kontrollit energjetik, me të cilën vërtetohet se kërkesat minimale për efikasitet energjetik që përmbahen në projektin themelor janë në pajtim me kërkesat minimale për efikasitet energjetik.

(6) Rikonstruktiv i konsiderueshëm në kuptim të paragrafit (5) të këtij neni është rikonstruktiv, vlera e përgjithshme e të cilit është më e madhe se 25% të vlerës së ndërtesës, duke mos e llogaritur vlerën e tokës në të cilën është ndërtuar ndërtesa dhe shpenzimet për rregullimin e tokës ndërtimore apo rikonstruktimin me të cilin më tepër se 25% e syprinës së mbështjellësit të ndërtesës është lëndë e rikonstruktimit.

## **3. Projekti ideor**

### **Neni 48-a**

(1) Projekti ideor është përmbledhje e paraqitjeve grafike dhe dokumenteve të harmonizuara ndërmjet veti me të cilat përcaktohen format themelore, zgjidhjet funksionale dhe teknike të objekteve dhe paraqitet vendosja e objektit në lokacion dhe i njëjti përpunohet në bazë të certifikatës nga plani urbanistik, dokumentacionit të planit, përkatësisht projektit për infrastrukturë.

(2) Projekti ideor varësisht nga kompleksiteti dhe struktura teknike e ndërtimit, mund të përmbajë edhe skica dhe dokumente tjera me rëndësi për përgatitjen e projektit ideor (përshkrimin e procedurës teknologjike dhe skemës teknologjike, përshkrimin e aplikimit të teknologjisë së caktuar të ndërtimit dhe të ngjashëm).

(3) Investuesi para parashtrimit të kërkesës për lëshimin e lejes për ndërtim mund ta dorëzojë te organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji edhe projektin ideor për objektin, me kërkesë për miratimin e tij ndërsa në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji, investitori është i obliguar të dorëzojë projekt ideor për ndërtimin, me kërkesë për miratimin e të njëjtit.

(4) Me kërkesën nga paragrafi (3) të këtij neni dorëzohet projekt ideor me ekstrakt nga plani urbanistik apo dokumentacioni urbanistik i planit përkatësisht projekt për infrastrukturë të verifikuar nga organi kompetent nëse bëhet fjalë për ndërtime infrastrukture të linjës, ndërsa për ndërtimet nga neni 59-s paragrafi (1) të këtij ligji dorëzohet vetëm projekt ideor.

(5) Organi kompetent nga neni 58 nga ky ligj është i obliguar në afat prej dhjetë ditë pune nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (3) i këtij neni, të përcaktojë nëse projekti është përpunuar në pajtim me rregullat për projektim, nëse projekti është përpunuar në pajtim me ekstraktin nga plani urbanistik apo dokumentacioni urbanistik i planit përkatësisht projekti për infrastrukturë, ndërsa në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) i këtij ligji nëse me projektin prishen standardet dhe normativat për objektet me dedikim banim në shtëpi banesore (A1) në lidhje me lartësinë e lejuar (kate dhe metra) dhe numrin e njërive banesore, të cilat janë përcaktuar në Rregulloren për standarde dhe normativa për planifikim urbanistik, me çka e lejon projektin me vërtetim dhe vulë të njëjtit apo dorëzon njoftim te kërkuesit për mangësitë e konstatuara.

#### **Neni 48-b**

*I fshirë* 7

#### **Neni 49**

*I fshirë* 8

#### **Neni 50**

*I fshirë* 9

### **4. Projekti i gjendjes së realizuar**

#### **Neni 51**

(1) Projekti i gjendjes së realizuar, është projekt me të cilin tregohet gjendja faktike e ndërtimit të ndërtuar, në pajtim me nenin 69 të këtij ligji.

(2) Projektin e gjendjes së realizuar, e përgatit personi juridik me licencë për projektim.

(3) Në rastin kur ndërtimi është ndërtuar në pajtim me projektin themelor pa ndryshime, projekti themelor njëkohësisht paraqet dhe projekt të gjendjes së realizuar.

## 5. Projekti për përdorim dhe mirëmbajtje

### Neni 52

(1) Me projektin për përdorim dhe mirëmbajtje, vërtetohen kushtet optimale teknike - teknologjike dhe funksionale me të cilat sigurohet qëndrueshmëria e projektuar e pjesëve të veçanta, përkatësisht e ndërtimit në tërësi e veçanërisht i përmban llojin, mënyrën, dedikimin dhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së sistemit të konstruksionit, pajisjes, aparateve dhe instalimeve, përcjellja periodike në intervale të përcaktuara me analizimin e ndikimeve të procesit teknologjik, të ndikimeve klimatike, si dhe ndikimeve tjera mbi kapacitetin bartës dhe stabilitetin e elementeve të veçanta, përkatësisht konstruksionit në tërësi, afatet për riparim të rregullt, përkatësisht riparim të përgjithshëm të impianteve, pajisjes dhe instalimeve, si dhe afatet për ndërrimin e obligueshëm të elementeve, instalimeve, pajisjes, instalimeve dhe pjesëve tjera të ndërtimit.

(2) Me projektin për përdorim dhe mirëmbajtjen e objekteve infrastrukturore në linjë mund të parashihet dhe të bëhet ndërrim i stabilimenteve, aparateve, pajisjes, instalimeve dhe pjesëve tjera të objektit për ruajtje të kërkesave themelore të tij.

(3) Projekti për përdorim dhe mirëmbajtje përpilohet për ndërtime të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, si dhe për objekte infrastrukturore në linjë.

(4) Projekti për përdorim dhe mirëmbajtje të objekteve infrastrukturore në linjë me raport pozitiv për revizionin e projektit, dorëzohet te organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, i cili detyrohet që në afat prej shtatë ditësh të punës ta miratojë projektin me vënien e verifikimit dhe vulës në të njëjtin apo të dorëzojë njoftim për mangësitë e konstatuara.

## 6. Përpilimi dhe ruajtja e dokumentacionit projektues

### Neni 53

(1) Dokumentacioni i projektit përpilohet në formë elektronike në format përkatës në mënyrë të përcaktuar me rregullën nga neni 54 i këtij ligji.

(2) Dokumentacioni projektues bashkë me lejen për ndërtim, është dokumentacion me vlerë të përhershme dhe organet kompetente janë të obliguara që ta ruajnë në pajtim me ligjin.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, dokumentacioni i projektit për objektet në zonat zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe nga personat juridikë, të cilët i ndërtojnë qiramarrësit dhe pronarët e tokës në zonat zhvillimore teknologjike industriale (përveç për objektet infrastrukturore në suazat e zonës, të cilat i ndërtojnë subjektet- dhënës të shërbimeve publike të cilat janë kompetente për ndërtimin e infrastrukturës elektroenergjetike, të ujës-jellësit, kanalizimit, gazpërçuesit dhe telekomunikimit), për ndërtimet në zonat e lira shëndetësore, si dhe për objektet në zonat industriale dhe të gjelbra të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë të cilat i ndërtojnë pronarët e tokës në zonat industriale dhe të gjelbra, përpunohet dhe verifikohet në formë të shkruar, në mënyrë të përcaktuar me rregullën nga neni 54 të këtij ligji.

### Neni 54

Përmbajtjen, shënimin, mënyrën e verifikimit të projekteve nga ana e personave përgjegjës, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të shkrimeve elektronike, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

## **7. Verifikimi i harmonizimit të dokumentacionit projektues (nostrifikimi)**

### **Neni 55**

(1) Projektet të përpiluar sipas dispozitave të huaja, harmonizohen me dispozitat për ndërtim të Republikës së Maqedonisë, me verifikimin e pajtueshmërisë së projekteve - nostrifikimin.

(2) Projektet nga paragrafi (1) i këtij neni para se të nostrifikohen, investuesi i parashtron të përkthyer në gjuhën maqedonase dhe në shkrimin e saj cirilik, si dhe në gjuhë tjetër zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, në pajtim me ligjin. Me përkthimin parashtrohet dhe teksti burimor në gjuhë të huaj.

(3) Nostrifikimin e projekteve e kryen Oda e Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar nëpërmjet komisionit të përbërë së paku prej tre anëtarësh, të cilin e formon kryetari i Odës së Inxhinierëve dhe Arkitektëve të Autorizuar. Anëtar i komisionit mund të jetë personi që ka autorizim të përcaktuar me këtë ligj.

(4) Nostrifikimin që e bën Oda, duhet të kryhet në afat jo më të gjatë se 60 ditë.

(5) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni përpilon raport me shkrim, e verifikon projektin dhe jep pëlqim për nostrifikim me të cilin vërtetohet se dokumentacioni projektues, i plotëson kushtet e parapara me dispozitat për ndërtim, të Republikës së Maqedonisë.

(6) Procedurën për nostrifikim, përmbajtjen e raportit me shkrim, pëlqimin për nostrifikim, mënyrën e verifikimit të projekteve nga ana e komisionit, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

## **V. LEJA PËR NDËRTIM**

### **Neni 56**

(1) Kryerja e ndërtimeve nga neni 57 i këtij ligji, mund të fillojë me dhënien e lejes për ndërtim e cila është e plotfuqishme në procedurë administrative.

(2) Ndërtimet dhe pjesët e ndërtimeve të ndërtuara pa leje për ndërtim, janë ndërtime të paligjshme. Pjesët e ndërtimit të ndërtuara në kundërshtim me projektin e verifikuar dhe lejen për ndërtim, janë bazë për pavlefshmërinë e lejes për ndërtim.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) të këtij neni, organi kompetent që e ka lëshuar lejen për ndërtim, miraton akt për pavlefshmërinë e lejes për ndërtim, i cili i dorëzohet organit kompetent për mbajtjen e librit publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive dhe i njëjti është kusht për shlyerjen e të gjitha shënimeve dhe parashënimeve të lidhura me patundshmërinë.

# 1. Kategorizimi i ndërtimeve

## Neni 57

(1) Ndërtime të kategorisë së parë janë: centralet bërthamore, termocentralet dhe hidrocentralet me kapacitet mbi 1 MV, largpërçuesit me nivel tensioni prej dhe mbi 350 KV, ndërtimet për prodhimin e energjisë elektrike nga burime rigjeneruese me kapacitet më të madh se 1 MW, trafostacionet me nivel të tensionit prej dhe mbi 35 kV, naftësjellësit, produktsjellësit, gazsjellësit magjistrare, përçuesit magjistrare të nxehtësisë, stacionet matëse të gazsjellësit, objektet shoqëruese të rrugëve shtetërore të përcaktuara me ligj, hekurudhat kryesore, stacionet hekurudhore të hekurudhave kryesore, aeroportet, deponitë për plehra të rrezikshme, digat me akumulim, ndërtimet për industri bazike kimike, ndërtimet e industrisë për metalurgji të zezë dhe me ngjyrë, ndërtimet për prodhimin e celulozës dhe letrës, ndërtimet për përpunimin e lëkurës dhe gëzofit, ndërtimet për përpunimin e kauçukut, barotit dhe municionit eksploziv, ndërtimet për magazina të mjeteve eksplozive, magazina të produkteve të naftës, gazit natyror dhe GLN-së me kapacitet magazinimi mbi 1000 tone, ndërtime për sanacionin e rrëshqitjeve te dheut, ndërtimet që mund ta rrezikojnë ambientin, ndërtimet për autoritetet shtetërore dhe agjencitë dhe fondet e përcaktuara nga Republika e Maqedonisë, ndërtesa për nevojat e personave juridikë në pronësi të plotë apo dominonte të Republikës së Maqedonisë, ndërtimet për misionet diplomatike dhe konsullore dhe organizatat ndërkombëtare, zonat e zhvillimit turistik dhe të ndërtimet në këto zona, zona industriale dhe zona të gjelbra të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe ndërtesat në këto zona zona të lira shëndetësore dhe ndërtimet në këto zona, zonat teknologjike industriale zhvillimore të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe personat juridikë dhe ndërtimet në këto zona, ndërtimet e arsimit të lartë, observatorët, institucionet nacionale të kulturës, ndërtimet që paraqesin trashëgimi të mbrojtur kulturore të paluajtshme në pajtim me ligjin, (të mirat individuale, tërësitë monumentale pa zona kontaktuese dhe lokalitete arkeologjike) monumentet përkujtimore, ndërtimet e dedikuara për mbrojtje shëndetësore terciare, qendrat e telekomunikacionit për pranimin e sinjaleve satelitore, ndërtimet për nevojat e vendkalimeve kufitare, objekte të parapara me dokumentacionin e planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë, sistemet rajonale të furnizimit me ujë dhe sistemet e trajtimit të ujerave të zeza, deponitë rajonale, teleferikët, ndërtimet e parapara në rajonin e dy ose më shumë komunave, ndërtimet në të cilat ekzistojnë instalime për prodhimin e energjisë termike, limanet e liqeneve dhe lumenjve, stadiumet dhe sallat sportive me kapacitet mbi 10 000 shikues.

(2) Ndërtime të kategorisë së dytë janë: ndërtime të dedikuara për arsim fillor dhe të mesëm, ndërtime nga sfera e kulturës, ndërtime për nevojat e organeve të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, zona industriale dhe të gjelbra të themeluara nga komunat dhe ndërtesat në këto zona ndërtime të dedikuara për mbrojtje primare dhe sekondare, ndërtime për nevojat e bashkësive fetare, ndërtime industriale, ndërtime ekonomike, ndërtime afariste, ndërtime banesore afariste, ndërtime për banim individual, objekte për banim individual të parapara me dokumentacionin e planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë, shtëpi vikendi, ndërtime për banim kolektiv, ndërtime për nevojat e agrobursave, qendra tregtare, hotele, qendra rekreative, ndërtime për veprimtari shkencore hulumtuese, garazhe në kate, tregje, rrugë komunale, objekte shoqëruese shërbyese të rrugëve komunale dhe rrugicave të përcaktuara me ligj, rrjete dhe mjete elektronike për

komunikim, termocentrale dhe hidrocentrale me kapacitet deri 1MV, turbina me erë, ndërtime për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet rigjeneruese me kapacitet deri 1MW, foto - panele me tension për prodhimin e energjisë elektrike të cilat ndërtohen në tokë,, largpërçues me nivel tensioni deri 35 KV, trafostacione me nivel tensioni deri 35 KV, magazina për derivatet e naftës, gazit natyror dhe GLN-së me kapacitet të magazinimit deri në 1 000 ton, rrjeti sekondar gazsjellës, rrjeti sekondar i përçimit të energjisë termike, hekurudha të tramvajit, ndërtime për mbrojtje kundër zjarrit, ndërtime për mbrojtje veterinare, kopshte për fëmijë, ndërtime në zona parqe jonacionale dhe parqe pyjore, ndërtime për separacionin e materialit për prodhimin e betonit, bazave të betonit, bazave të asfaltit, sistemet lokale ujësjellëse dhe të kanalizimit me sisteme për pastrim, ndërtime që janë në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë natyrore (qendra informative), deponi për hedhurina të brendshme (hedhurina ndërtimore), dhe deponi për hedhurina të parrezikshme, miniera dhe ndërtime për nevojat e minierave, autokampe dhe ndërtime për nevojat e autokampeve, objekte për magazinim, trajtim dhe /ose përpunim të hedhurinave, stacione ndërkombëtare të autobusëve, kopshte zoologjike, stadione dhe salla sportive me kapacitet nën 10 000 shikues, sisteme për ujitje dhe kullim, pishina në nivel të terrenit për përdorim publik, parqe publike, parkingje publike dhe ski - lifte.

## 2. Organet kompetente për dhënien e lejes për ndërtim

### Neni 58

(1) Ndërtimet e kategorisë së parë të nenit 57 të këtij ligji, janë ndërtime të rëndësishme për Republikën dhe leje për ndërtim lëshon organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

(2) Ndërtimet e kategorisë së dytë nga neni 57 të këtij ligji, janë ndërtime me rëndësi lokale dhe leje për ndërtim lëshon kryetari i komunës, përkatësisht kryetarët e komunave në Qytetin e Shkupit.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, leje për ndërtim të ndërtimeve në zonat zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe nga personat juridikë, të cilat i ndërtojnë qiramarrësit dhe pronarët e tokës në zonat zhvillimore teknologjike industriale, (përveç për objektet infrastrukturore në suazat e zonës, të cilat i ndërtojnë subjektetdhënës të shërbimeve publike të cilat janë kompetente për ndërtimin e infrastrukturës elektroenergjetike, të ujësjellësit, kanalizimit, gazpërçuesit dhe telekomunikimit), për ndërtimet në zonat e lira shëndetësore, si dhe për objektet në zonat industriale dhe të gjelbra të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë të cilat i ndërtojnë pronarët e tokës në zonat industriale dhe të gjelbra, lëshon Drejtoria për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me Ligjin për zonat zhvillimore teknologjike industriale përkatësisht Ligjin për zonat e gjelbra-industriale, kurse për objektet në zonat zhvillimore teknologjike industriale (përveç për objektet infrastrukturore në suazat e zonës, të cilat i ndërtojnë subjektet-dhënës të shërbimeve publike të cilat janë kompetente për ndërtimin e infrastrukturës elektroenergjetike, të ujësjellësit, kanalizimit, gazpërçuesit dhe telekomunikimit) për të cilat është lidhur marrëveshje me partneritet privat publik, leje për ndërtim lëshon Ministria e Ekonomisë në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me Ligjin për zona zhvillimore teknologjike industriale.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, procedurën për lëshim të lejes për ndërtim për rrugë magjistrale dhe përmbledhëse në rajonin e Qytetit të Shkupit, lejes për ndërtim për objekte infrastrukturore në linjë, ndërtimi i të cilave në pajtim me Ligjin për Qytetin e Shkupit është në kompetencë të Qytetit të Shkupit, lejes për ndërtim shtesë, mbindërtim dhe lejes për rikonstruktim të objekteve për të cilat është miratuar vendim nga Këshilli i Qytetit të Shkupit në pajtim me nenin 67-a paragrafi (1) të këtij ligji, lejes për ndërtim dhe lejes për rikonstruktim të shesheve që janë në kompetencë të Qytetit të Shkupit, lejes për ndërtim dhe lejes për rikonstruktim të rrugëve që mundësojnë qasje të sheshet që janë në kompetencë të Qytetit të Shkupit, lejes për ndërtim për ndërtesa infrastrukturore me përmbajtje përcjellëse në shtretër të lumenjve që gjenden në rajonin e Qytetit të Shkupit, lejes për ndërtim të përmbajtjeve përcjellëse në parqe që janë në kompetencë të Qytetit të Shkupit, e zbaton Qyteti i Shkupit dhe lejen për ndërtim shtesë, mbindërtim, përkatësisht lejen për rikonstruktim e lëshon kryetari i Qytetit të Shkupit.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, procedurën për lëshimin e lejes për ndërtim për objekte infrastrukturore në linjë, stadione dhe salla sportive me sipërfaqe bruto zhvillimore mbi 1500m<sup>2</sup>, për të cilat investitor është Republika e Maqedonisë dhe ndërtimi i të cilave është financuar vetëm me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, e zbaton organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës dhe lejen për ndërtim e lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(6) Nëse me planin urbanistik ose dokumentacionin e planit shtetëror, përkatësisht lokal është planifikuar ndërtim me rol të shumëfishtë në të cilin janë paraparë ndërtime të kategorisë së parë dhe të dytë nga neni 57 i këtij ligji, leje për ndërtim lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(7) Ekzemplari nga leja e plotfuqishme për ndërtim të cilën e miraton organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit të hapësirës përkatësisht Drejtoria për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale, përkatësisht Qyteti Shkupit dorëzohet në njësinë e vetadministrimit lokal në zonën e të cilës do të ndërtohet ndërtimi, në afat prej pesë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e lejes për ndërtim.

### **3. Procedura për dhënien e lejes për ndërtim**

#### **Neni 59**

(1) Procedura për lëshimin e lejes për ndërtim udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(2) Për marrjen e lejes për ndërtim, investuesi parashtron kërkesë në formë elektronike në organin kompetent nga neni 58 i këtij ligji, me dokumentacionin në vijim:

- projekt arkitekturor - urbanistik të verifikuar nga organi kompetent, nëse me planin urbanistik është paraparë përpilimi i këtij projekti, përkatësisht projekt për infrastrukturë nëse kërkesa ka të bëjë me ndërtime infrastrukture të linjës;
- projekt themelor me raport për revizion të projektit themelor ose raport me shkrim me pëlqim për nostrifikimin e projektit themelor, nëse ai është përpiluar jashtë vendit si dhe mendim pozitiv për shkallën e projektuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës,
- projekt ideor nëse i njëjti paraprakisht është dorëzuar dhe miratuar në



pajtim me nenin 48-a të këtij ligji.

- dëshmi për të drejtën e ndërtimit dhe
- elaborat gjeodezik për të dhënat numerike për tokën ndërtimore.

(3) Nëse është parashtruar kërkesë për leje për ndërtim për objekte shërbyese shoqërore në rrugë komunale, përkatësisht shtetërore të përcaktuara me ligj, krahas provave nga paragrafi (2) i këtij neni, kërkuesi dorëzon edhe aktvendim për ndryshim të përhershëm të regjimit të komunikacionit nga organi kompetent dhe deklaratë nga kërkuesi të dhënë nën përgjegjësi të plotë materiale dhe penale me të cilën i njëjti vërteton se aktvendimi për ndryshimin e përhershëm të regjimit të komunikacionit ka të bëjë me projektin e dorëzuar përmes sistemit informatik e-leje për ndërtim.

(4) Nëse është parashtruar kërkesë për leje për ndërtime të cilat paraqesin trashëgimi kulturore të patundshme të mbrojtur në pajtim me ligjin, krahas dëshmimeve nga paragrafi (2) i këtij neni, dorëzohet edhe leje konservimi, e lëshuar nga Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe deklaratë nga kërkuesi të dhënë nën përgjegjësi të plotë materiale dhe penale me të cilën i njëjti vërteton se leja për konservim ka të bëjë me projektin e dorëzuar përmes sistemit informatik e-leje për ndërtim.

(5) Nëse është dorëzuar kërkesë për miratimin e ndërtimit të ndërtesave për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike për të cilat në pajtim me dispozitat për energjetikë është paraparë autorizim për ndërtim të këtij lloji të objekteve, krahas dëshmimeve nga neni (2) i këtij ligji dorëzohet edhe autorizim për ndërtimin e ndërtesave për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike të lëshuar nga organi kompetent.

(6) Nëse është parashtruar kërkesë për leje për ndërtim të rrjeteve dhe mjeteve elektronike komunikuese, krahas dëshmimeve nga paragrafi (2) i këtij neni dorëzohet edhe notifikim për bartjen e të dhënave elektronike, të lëshuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike.

(7) Nëse është parashtruar kërkesë për leje për ndërtim të deponive për hedhurina të rrezikshme, deponive për hedhurina të pa rrezikshme dhe deponie për hedhurina interne, krahas dëshmimeve nga paragrafi (2) i këtij neni dorëzohet edhe aktvendim me të cilin lejohet themelimi i deponisë, të lëshuar nga organi kompetent.

(8) Organi kompetent i nenit 58 të këtij ligji është i detyruar në afat prej pesë ditësh pune nga pranimi i kërkesës ta shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të përcaktojë nëse kërkesa është e kompletuar, nëse dokumentacioni i dorëzuar ka mangësi, nëse projekti themelor është përpiluar në përputhje me rregullat për projektim, planin urbanistik ose dokumentacionin e planit urbanistik ose projektin për infrastrukturë dhe nëse kërkuesi është bartës i vetëm i të drejtës për ndërtim. Nëse me kërkesën është dorëzuar projekti themelor dhe raporti pozitiv për revizion të projektit themelor, organi kompetent është i detyruar që menjëherë pas pranimit të kërkesës të veprojë në pajtim me nenin 59-v të këtij ligji ndërsa në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji nëse me projektin themelorë prishen standardet dhe normativat për objektet me dedikim banim në shtëpi banesore (A1) në lidhje me lartësinë e lejuar (kate dhe metra) dhe numrin e njërive banesore, të cilat janë përcaktuar në Rregulloren për standarde dhe normativa për planifikim urbanistik.

(9) Pas zbatimit të veprimet nga paragrafi (8) i këtij neni, nëse konstatohet se dokumentacioni i paraqitur është i kompletuar, janë plotësuar kushtet e paragrafit (8) të këtij neni dhe është marrë mendim

pozitiv përkatësisht pëlqim nga ana e subjekteve nga neni 59-v i këtij ligji, tek të cilët është dorëzuar kërkesë për këqyrje në projektin themelor, organi kompetent është i detyruar të veprojë në përputhje me paragrafin (11) të këtij neni, ndërsa në të kundërtën është i detyruar të miratojë konkluzion për ndërprerje të procedurës me të cilin do ta detyrojë kërkuuesin që t'i mënjanojë mangësitë e konstatuara dhe ta plotësojë kërkesën në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit.

(10) Nëse kërkuesi nuk i mënjanon mangësitë e konstatuara dhe nuk e plotëson kërkesën në afatin nga paragrafi (9) i këtij neni, organi kompetent është i detyruar të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës për leje për ndërtimi, ndërsa nëse kërkuesi i mënjanon mangësitë e konstatuara, e plotëson kërkesën në afatin nga paragrafi (9) i këtij neni, ndërsa në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni është marrë mendim pozitiv përkatësisht pëlqim nga ana e subjekteve nga neni 59-v i këtij ligji për të cilat është dorëzuar kërkesë për këqyrje në projektin themelor, organi kompetent është i detyruar të veprojë në përputhje me paragrafin (11) të këtij neni. Nëse ndonjë nga subjektet në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni kanë paraqitur vërejtje të projektit themelor, organi kompetent është i detyruar menjëherë pas kryerjes së plotësimit të kërkesës nga ana e kërkuetit, të dorëzojë kërkesë për këqyrje të sërishme në projektin themelor, te subjektet nga neni 59-v i këtij ligji, të cilët kishin paraqitur vërejtje për të njëjtin, me qëllim që ata të konstatojnë nëse është vepruar sipas vërejtjeve të paraqitura paraprakisht.

(11) Nëse dokumentacioni i dorëzuar ose i plotësuar është i kompletuar, janë plotësuar kushtet nga paragrafi (8) i këtij neni dhe është marrë mendim pozitiv ose pëlqim nga subjektet e nenit 58-v të këtij ligji, te të cilët është dorëzuar kërkesë për këqyrje në projektin themelor, organi kompetent është i detyruar në afat prej dy ditëve nga kompletimi i dokumentacionit ose nga pranimi i mendimit pozitiv apo pëlqimit ta verifikojë projektin themelor dhe të dorëzojë te kërkuesi njoftim me përlogaritje për pagesën e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore. Për ndërtesat e kategorisë së parë, organi kompetent, pas verifikimit të projektit themelor të njëjtin e dorëzon te komuna përkatëse për përpilim të përlogaritjes së kompensimit për rregullim të tokës ndërtimore. Kërkuesi është i detyruar që kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore ta paguajë ose ta rregullojë pagesën në mënyrë të përcaktuar në paragrafi (12) të këtij neni, në afat prej 15 ditësh pune nga pranimi i njoftimit me përlogaritje për pagesë të kompensimit.

(12) Nëse kërkuesi respektivisht investitori në afatin nga paragrafi (11) të këtij neni nuk e paguan kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore respektivisht nuk lidh marrëveshje me komunën për pagim të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në këste ose nuk lidh marrëveshje me të cilën është përcaktuar se do ta rregullojë tokën në shpenzim të tij ose nuk dorëzon garanci bankare për pagim të kompensimit ose nuk vendos hipotekë në dobi të komunës ose nuk është miratuar akt në bazë të të cilit kërkuesi respektivisht investitori është i liruar nga pagimi i kompensimit, organi kompetent do ta refuzojë kërkesën për marrjen e lejes për ndërtim.

(13) Leja për ndërtim lëshohet në afat prej pesë ditëve te punës nga dorëzimi i dëshmisë për kompensim të paguar për rregullimin e tokës ndërtimore, përkatësisht nga dita e lidhjes së marrëveshjes për mënyrën e pagesës së kompensimit ose marrëveshje me të cilën, përcaktohet se investuesi do ta rregullojë tokën me shpenzim personal, përkatësisht nga dita e miratimit të aktit në bazë të të cilit investuesi lirohet nga pagesa e kompensimit ose nga dita e dorëzimit të garancisë bankare për pagesë të

kompensimit ose dorëzimit të dëshmisë për hipotekë të vendosur në dobi të komunës.

(14) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për leje për ndërtim, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(15) Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim, detyrohet që investuesit t'i dorëzojë llogaritje për pagesën e shpenzimeve për regjistrimin e objektit në librat publikë të patundshmërive në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-leje për ndërtim.

(16) Organi kompetent në procedurën e lëshimit të lejes për ndërtim nuk mund të kërkojë nga kërkuesi dokumentacion tjetër, përveç dokumentacionit të paraparë me këtë ligj.

(17) Për objekte të linjës infrastrukturore të cilët janë rrugë shtetërore, rrugë lokale dhe rrugica, sisteme ujësjellësi dhe kanalizimi, hekurudha, gazsjellës dhe largpërçues, produksjellës, përçues të nxehjes, naftësjellës, teleferikë, ndërtesa për prodhim të energjisë elektrike nga burime rigjeneruese, sisteme për ujitje dhe drenazhim, basene në nivel të terrenit për përdorim publik, ndërtesa që paraqesin trashëgimi të patundshme të mbrojtur kulturore në pajtim me ligjin, si dhe për objekte për nevojat e organeve shtetërore, agjencive ose fondeve të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe personat juridikë në pronësi të plotë ose dominuese të Republikës së Maqedonisë, leje për ndërtim mund të jepet edhe pa çështje të zgjedhura pronësore juridike për të gjithë parcelën ndërtimore, me obligim që investuesi t'i rregullojë çështjet pronësore juridike më së voni deri në parashtrimin e kërkesës për leje për përdorim, përkatësisht deri në përgatitjen e raportit për kontroll të kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës, me çfarë në këtë rast me kërkesën nga paragrafi (2) të këtij neni nuk dorëzohet elaborat gjeodezik për të dhëna numerike për tokën ndërtimore.

(18) Kërkesa për marrjen e lejes për ndërtim dhe dokumentacioni nga paragrafët (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni parashtrihen në formë elektronike, nëpërmjet sistemit informativ e-leje për ndërtim, në mënyrë të përcaktuar me rregullën nga neni 59-e paragrafi (2) të këtij ligji.

(19) Kërkuesi përgjigjet për autenticitetin e të gjitha dokumenteve të cilat janë dorëzuar me kërkesën në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-leje për ndërtim, me dokumentet origjinale të cilat janë lëshuar nga subjektet kompetente.

(20) Leja për ndërtim e lëshuar në bazë të dokumenteve të dorëzuara në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-leje për ndërtim, të cilat nuk janë autentike me dokumentet origjinale të lëshuara nga subjektet kompetente, është e pavlefshme.

## Neni 59-a

Si dëshmi për të drejtën për ndërtim sipas këtij ligji konsiderohet:

- aktzotërimi me të drejtë të shënuar të pronësisë ose të drejtë të qirasë afatgjate ose të drejtë servituti të tokës ndërtimore, që është pjesë përbërëse e elaboratit gjeodezik për të dhënat numerike për tokën ndërtimore,
- marrëveshja për bartjen e të drejtës për ndërtim të tokës për ndërtim në fjalë,

- marrëveshja për koncesion ose marrëveshje për partneritet privat publik,
- vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me të cilin organ shtetëror, agjencia ose fondi i themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, persona juridikë në pronësi të plotë ose dominante të Republikës së Maqedonisë ose njësia e vetadministrimit lokalë, e kanë fituar të drejtën për ndërtim,
- marrëveshja me bashkësinë e pronarëve të pjesëve të posaçme të objektit ose pëlqimi me shkrim nga shumica e pronarëve të pjesëve të posaçme të objektit që paraqesin me shumë se gjysmën e sipërfaqes së përgjithshme të objektit me aktzotërime për pjesët e posaçme të objektit, nëse bëhet fjalë për ndërtim shtesë dhe mbindërtim të ndërtesave në pronësi me kate,
- vendim të këshillit të komunës, këshillit të komunës në Qytetin e Shkupit përkatësisht këshillit të Qytetit të Shkupit, nëse bëhet fjalë për ndërtim shtesë dhe mbindërtim të objektit për të cilin është miratuar vendim në pajtim me nenin 67-a paragrafi (1) të këtij ligji,
- deklaratë nga investuesi me të cilën i njëjti do të vërtetojë se e ndërmerr obligimin që t'i rregullojë marrëdhëniet pronësore-juridike gjatë ndërtimit dhe se ato plotësisht do t'i rregullojë deri në parashtrimin e kërkesës për leje për përdorim, përkatësisht përpilim të raportit për kontrollin e kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës, nëse bëhet fjalë për ndërtim të objekteve infrastrukturore në linjë që janë rrugë shtetërore, rrugë lokale dhe rrugica, furnizues me ujë dhe sistemi i kanalizimit, vija hekurudhore, gazpërçues dhe largpërçues, produktsjellës, përçues të nxehtësisë, naftësjellës, teleferikë, ndërtesa për prodhim të energjisë elektrike nga burime rigjeneruese, sisteme për ujitje dhe drenazhim, basene në nivel të terrenit për përdorim publik ndërtesa që paraqesin trashëgimi të patundshme të mbrojtur kulturore në pajtim me ligjin, si dhe për objekte për nevojat e organeve shtetërore, agjencive ose fondeve të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe personat juridikë në pronësi të plotë ose dominuese të Republikës së Maqedonisë, e që nuk janë zgjidhur marrëdhëniet pronësore-juridike për tërë parcelën ndërtimore dhe
- aktzotërimi me të drejtë të shënuar të pronësisë së Republikës së Maqedonisë, apo aktvendim përfundimtar për eksproprijim, apo listë pronësie me të drejtë të regjistruar të pronësisë apo të drejtë të qirasë afatgjate apo të drejtë për servitut të tokës ndërtimore nëse bëhet fjalë për ndërtim të ndërtimeve infrastrukturore të linjave që është pjesë përbërëse e elaboratit gjeodezik për të dhënat numerike për tokën ndërtimore.

(2) Në rastet kur është parashtruar kërkesë për marrjen e lejes për ndërtim për pjesë nga largpërçuesi që nuk paraqesin tërësi funksionale ndërtimore-teknike dorëzohet dëshmi për të drejtën e ndërtimit nga paragrafi (1) i këtij neni, vetëm për pjesën që është lëndë e kërkesës për lëshimin e lejes për ndërtim.

(3) Në rastet kur është parashtruar kërkesë për marrje të lejes për ndërtim të teleferikut ose largpërçuesit mbitokësor, dorëzohet dëshmi për të drejtë të ndërtimit nga paragrafi (1) i këtij neni dhe zgjidhen marrëdhëniet pronësore-juridike vetëm për tokën në të cilën janë vendosur shtyllat e teleferikut përkatësisht largpërçuesit.

## Neni 59-b

Për ndërtime të dedikuara për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup>, nuk është i detyrueshëm revizioni i projektit themelor dhe mbikëqyrja mbi ndërtimin e ndërtimit, kurse realizuesi detyrohet që të japë deklaratë të verifikuar në noter, me përgjegjësi të plotë materiale dhe penale, me të cilën do të vërtetojë se objekti është

ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji, revizioni i projektit themelor është i detyrueshëm, ndërsa realizuesi nuk jep deklaratë tek noteri me përgjegjësi të plotë materiale dhe penale me të cilën do të vërtetohet se objekti është ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor apo projektin e gjendjes së realizuar.

## Neni 59-v

(1) Organi kompetent i nenit 58 të këtij ligji, është i detyruar të dorëzojë kërkesë për këqyrje në projektin themelor te subjektet kompetente për infrastrukturë elektroenergjetike, të ujësjellësit dhe kanalizimit, menjëherë pas pranimit të kërkesës për leje për ndërtim, nëse me të njëjtën është dorëzuar projekti themelor dhe raporti pozitiv për revizion të projektit themelor dhe raport pozitiv për revizion dhe procedura është ndërprerë në pajtim me nenin 59 paragrafi (9) të këtij ligji, menjëherë pas plotësimit të kryer të kërkesës.

(2) Subjekti kompetent për infrastrukturë elektroenergjetike detyrohet në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për këqyrje, të kryejë këqyrje në projektin themelor dhe të dorëzojë mendim nëse objekti mund të kyçet në sistemin përkatës elektroenergjetik.

(3) Subjekti kompetent për infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit është i detyruar në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për këqyrje, të kryejë këqyrje në projektin themelor dhe të dorëzojë mendim nëse objekti mund të kyçet në sistemin përkatës të ujësjellësit dhe kanalizimit. Subjekti kompetent për infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit është i detyruar të jep mendim edhe në rast kur projekti themelor nuk përmban kushte hidroteknike për kyçje të objektit të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit në pajtim me Ligjin për furnizim me ujë të pijshëm dhe shkarkimin e ujërave zeza urbane.

(4) Nëse me projektin themelor parashihen kyçja e objektit në infrastrukturë të nxehjes dhe gazsjellëse, organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, në afatin e përcaktuar në paragrafi (1) të këtij neni, dorëzon kërkesë për këqyrje në projektin themelor te subjektet kompetente për infrastrukturë të nxehjes dhe gazsjellëse, që janë të detyruar në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, të kryejnë këqyrje në projektin themelor dhe të dorëzojnë mendim nëse objekti mund të kyçet në infrastrukturën e nxehjes dhe gazsjellëse.

(5) Nëse bëhet fjalë për ndërtim të magazinave për magazinim e materieve shpërthyes, magazinave, depove ose rezervuarit për magazinim të lëndëve të ndezshme dhe gazrave, vendmbushje, stacion për furnizim me karburant, naftësjellës ose gazsjellës, duke përfshirë magazinën, stabilimentin apo pajisjen që është teknologjikisht i lidhur me naftësjellësin ose gazsjellësin, organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji në afat të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, dorëzon kërkesë për këqyrje në projektin themelor te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, që është i detyruar në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të kryejë këqyrje në projektin themelor dhe të jap pëlqim ose të japë vërejtje nëse nuk janë plotësuar kushtet për pëlqim.

(6) Nëse bëhet fjalë për ndërtim të ndërtesave për të cilat projekti themelor në pajtim me nenin 47 paragrafi (5) të këtij ligji përmban dhe

elaborat për mbrojtje nga zjarri, shpërthimet dhe materiet e rrezikshme, organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, në afatin e përcaktuar në paragrafi (1) të këtij neni, dorëzon kërkesë për këqyrje në projektin themelor edhe për Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, që detyrohet në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të kryejë këqyrje në projektin themelor dhe të japë pëlqim të elaboratit ose të japë vërejtje nëse nuk janë të plotësuar kushtet për pëlqim.

(7) Nëse bëhet fjalë për ndërtim të rrjeteve komunikuese elektronike dhe mjeteve, organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, në afatin e përcaktuar në paragrafi (1) të këtij neni, dorëzon kërkesë për këqyrje në projektin themelor edhe te Agjencia për Komunikime Elektronike që është e detyruar në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të kryejë këqyrje në projektin themelor dhe të japë pëlqim ose të japë vërejtje nëse nuk janë plotësuar kushtet për pëlqim.

(8) Nëse subjektet nga paragrafët (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni nuk veprojnë në pajtim me këtë nen, konsiderohet se nuk kanë vërejtje dhe nëse për shkak të mosveprimit të tyre në të ardhmen ndodhin dëme, detyrimi për kompensim të dëmit do të jetë në ngarkim të subjektit mosveprimi i të cilit e ka shkaktuar dëmin.

(9) Subjektet nga paragrafët (2), (3), (4), (5), (6) и (7) të këtij neni që kanë dorëzuar vërejtje të projektit themelor, janë të detyruar të kontrollojnë nëse është vepruar për vërejtjet e dhëna paraprake nga ana e kërkuesit, në afat prej dy ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës për këqyrje të sërishme në projektin themelor që është dorëzuar nga ana e organit kompetent nga neni 58 i këtij ligji.

(10) Nëse subjektet nga paragrafët (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni, duke vepruar në pajtim me paragrafin (9) të këtij neni dhe pas kontrollit të kryer përsëri kanë pasur vërejtje të projektit themelor përkatësisht kanë dhënë mendim negativ ose nuk kanë dhënë pëlqim, organi kompetent miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës për leje për ndërtim.

(11) Kërkesa për këqyrje në projektin themelor, mendimi ose pëlqimi përkatësisht vërejtjet, dorëzohen në formë elektronike, përmes sistemit informativ e-leje për ndërtim, në mënyrë të përcaktuar me rregullën nga neni 59- e paragrafi (2) i këtij ligji.

## **Neni 59-g**

Kushtet mbrojtëse - konservuese në procedurën për lëshimin e lejes për ndërtim, përcaktohen vetëm nëse në planin urbanistik nuk ka inkompatibilitet bazë mbrojtëse konservuese.

## **Neni 59-d**

(1) Organi kompetent i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim, detyrohet që në afat prej tre ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e lejes për ndërtim, të dorëzojë ekzemplar nga leja, me ekzemplar nga projekti themelor i verifikuar në organin kompetent për mbajtjen e librit publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive për regjistrim dhe parashënim në librin publik në të cilin është regjistruar e drejta mbi tokën dhe ekzemplar inspektorit kompetent të ndërtimit, e nëse i është lëshuar leje për ndërtim investuesit - person fizik për ndërtim të ndërtesës me dedikim banim në ndërtesa banesore, ndërtesës me dedikim afarist dhe ndërtesës me dedikim afarist banesor, organi kompetent detyrohet që ekzemplarën e lejes së plotfuqishme për ndërtim ta dorëzojë te Drejtoria e

të Hyrave Publike, në formë elektronike përmes sistemit informatik e-leje për ndërtim.

(2) Kur leja për ndërtim u lëshohet më tepër investuesve, në leje shënohen të gjithë investuesit në pjesë ideale ose reale, në bazë të veprës juridike për rregullimin e të drejtave të ndërsjella dhe obligimeve për ndërtim, të verifikuara në noter.

(3) Dispozitat e këtij ligji kanë të bëjnë edhe me procedurën e lëshimit të lejes për ndërtim shteteve të huaja, për nevojat e përfaqësive të tyre diplomatike konsullore, nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është rregulluar ndryshe.

## **Neni 59-gj**

*I fshirë* **10**

## **Neni 59-e**

(1) Organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji është i detyruar që procedurën për lëshimin e lejes për ndërtim ta zbatojë në mënyrë elektronike, nëpërmjet sistemit informativ e-leje për ndërtim.

(2) Mënyrën e zbatimit të procedurës për marrjen e lejes për ndërtim në mënyrë elektronike, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(3) Leja për ndërtim e cila është lëshuar në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni, është e pavlefshme.

(4) Mënyrën e veprimit të administratorit në sistemin informativ e-leje për ndërtim, e përcakton, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(5) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, organet kompetente nga neni 58 paragrafi (3) i këtij ligji, procedurat për lëshimin e licencës për ndërtim i zbatojnë në formë të shkruar, në mënyrë të përcaktuar me Ligjin për zonat zhvillimore teknologjike industriale përkatësisht Ligjin për zonat e gjelbra-industriale.

## **Neni 59-zh**

(1) Qyteti i Shkupit është i detyruar të ndërtojë rrugë lokale apo rrugicë në rajonin e qytetit të Shkupit që është në funksion të ndërtimeve për nevojat e organeve shtetërore, agjencive dhe fondeve të themeluara nga Republika e Maqedonisë dhe personave juridikë në pronësi të plotë apo dominuese të Republikës së Maqedonisë, për ndërtimin e të cilave është paguar kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore nga ana e investitorit të ndërtimit, në të cilin funksion duhet të ndërtohet rruga përkatësisht rrugica, nëse nga ana e komunës kompetente në qytetin e Shkupit nuk është dhënë leje për ndërtim për rrugën përkatësisht rrugicën dhe/ose nuk është filluar me ndërtimin e të njëjtave deri në përpilimin e raportit përfundimtar për mbikëqyrje të kryer nga neni 36 paragrafi (1) alineja 9 të këtij ligji për ndërtesën në funksionin e së cilës duhet të ndërtohet rruga.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, procedurën për dhënien e lejes për ndërtim e zbaton dhe lejen për ndërtim e jep organi i administratës

shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(3) Gjatë zbatimit të procedurës nga paragrafi (2) i këtij neni investuesi nuk paguan kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore ndërsa komuna në qytetin e Shkupit është e obliguar që mjetet nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtim të rrugës respektivisht të rrugicës, që janë paguar nga investuesi i ndërtimit në funksion të të cilit duhet ndërtohet rruga respektivisht rrugica, t'ia transmetojë qytetit të Shkupit, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për bartjen e mjeteve nga qyteti i Shkupit.

(4) Nëse Qyteti i Shkupit nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, rrugën respektivisht rrugicën mundet ta ndërtojë investuesi i ndërtimit në funksion të të cilit duhet të ndërtohet rruga respektivisht rrugica, ndërsa komuna e qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit janë të obliguar që mjetet nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e rrugës respektivisht të rrugicës që janë paguar nga investuesi i ndërtimit në funksion të të cilit duhet të ndërtohet rruga respektivisht rrugica, t'ia kthejë investuesit, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për kthimin e mjeteve.

### **Neni 59-z**

(1) Verifikim të projektit themelorë me të cilin përcaktohet se projekti themelorë është përpunuar në pajtim me rregullat për projektim, planin urbanistik apo dokumentacionin urbanistik të planit apo projekti për infrastrukturë, ndërsa në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) i këtij ligji se me projektin themelorë nuk prishen standardet dhe normativat për objektet me dedikim banim në shtëpi banesore (A1) në lidhje me lartësinë e lejuar (kate dhe metra) dhe numrin e njësisive banesore, të cilat janë përcaktuar në Rregulloren për standarde dhe normativa për planifikim urbanistik, mund të kryejnë vetëm persona zyrtarë të organit kompetent nga neni 58 i këtij ligji, të cilët janë inxhinierë arkitektë të diplomuar apo inxhinierë ndërtimorë të diplomuar.

(2) Për ndërtimet nga kategoria e parë nga neni 57 i këtij ligji, personat zyrtarë nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të kenë përvojë pune prej më së paku dy vjet në procedura për lëshimin e lejeve për ndërtimin e ndërtimeve nga kategoria e parë apo e dytë nga neni 57 i këtij ligji apo të kenë autorizim për projektim apo autorizim për revizion të dokumentacionit projektues për ndërtime nga kategoria e parë apo e dytë nga neni 57 i këtij ligji.

(3) Për ndërtimet nga kategoria e dytë nga neni 57 i këtij ligji, personat zyrtarë nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të kenë përvojë pune prej më së paku një vit në procedura për lëshimin e lejeve për ndërtimin e ndërtimeve nga kategoria e parë apo e dytë nga neni 57 i këtij ligji apo të kenë autorizim për projektim apo autorizim për revizion të dokumentacionit projektues për ndërtime nga kategoria e parë apo e dytë nga neni 57 i këtij ligji.

### **Neni 59-x**

(1) Për mbindërtim të objekteve për banim individual mund të jepet leje për ndërtim edhe në rastet kur mbindërtimi nuk është paraparë në planin urbanistik apo dokumentacionin urbanistik të planit, nëse objekti ekzistues është me të drejtë të përcaktuar të pronësisë në librin publik për regjistrimin e të drejtave dhe patundshmërive dhe me mbindërtimin nuk do të prishen standardet dhe normativat për objektet me dedikim banim



në shtëpi banesore (A1) në lidhje me lartësinë e lejuar (kate dhe metra) dhe numrin e njërive banesore, të cilat janë përcaktuar në Rregulloren për standarde dhe normativa për planifikim urbanistik.

(2) Procedura për mbindërtim në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet për objektin ekzistues për banim individual, i cili është ndërtuar me leje për ndërtim apo për të njëjtin është miratuar aktvendim të plotfuqishëm për përcaktimin e statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje, i cili gjendet:

- jashtë përfshirjes së planit të planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit urbanistik të planit apo
- në kuadër të përfshirjes së planit të planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit urbanistik të planit, ndërsa i njëjti nuk është inkuadruar në planin përkatësisht dokumentacionin e planit apo
- në kuadër të përfshirjes së planit të planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit urbanistik të planit, i njëjti është inkuadruar në planin përkatësisht dokumentacionin e planit, ndërsa për të cilin objekt nuk janë përcaktuar parametrat e lejuara maksimale në lidhje me lartësinë (kate dhe metra) dhe numrin e njërive banesore, të cilat mund të përcaktohen për këtë lloj të objekteve në pajtim me standardet dhe normativat në Rregulloren për standarde dhe normativa për planifikim urbanistik.

(3) Me përjashtim nga neni 59 paragrafi (2) i këtij neni, në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni me kërkesën për marrjen e lejes për ndërtim për mbindërtim të objektit, dorëzohet dokumentacioni si vijon:

- projekt themelorë me raport pozitiv për revizion,
- projekt ideor të lejuar në pajtim me nenin 48-a nga ky ligj,
- deklaratë nga projektuesi të dhënë nën përgjegjësi penale dhe materiale me të cilën vërteton se gjendja ekzistuese e objektit është paraqitur si autentike në projektin themelorë,
- mendim pozitiv për shkallën e projektuar të rezistencës mekanike, qëndrueshmëri dhe mbrojtje sizmike e ndërtimit,
- aktzotërim për objektin ekzistues në të cilin do të bëhet mbindërtimi me dedikim të përcaktuar banim familjarë në shtëpi banesore (A1) dhe me të drejtë të përcaktuar të pronësisë së investitorit,
- pëlqim për mbindërtim nga pronari i objektit ekzistues, nëse i njëjti nuk është investitor dhe
- leje konservatore të lëshuar nga Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe deklaratë nga kërkuesi të dhënë nën përgjegjësi materiale dhe penale me të cilën i njëjti do të vërteton se leja konservatore ka të bëjë me projektin e dorëzuar nëpërmjet sistemit informativ për leje për ndërtim, nëse është parashtruar kërkesë për mbindërtimin e objektit i cili paraqet trashëgimi kulturorë të patundshme mbrojtëse në pajtim me ligj.

(4) Mbikëqyrja mbi ndërtimin e mbindërtimit në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është e domosdoshme nëse bruto sipërfaqja e zhvilluar e mbindërtimit nuk është më e madhe se 300 m<sup>2</sup>, ndërsa mbindërtimi vihet në përdorim dhe regjistrohet në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive në bazë të raportit për kontroll të kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës.

(5) Gjatë zbatimit të procedurës për ndryshime gjatë ndërtimit për mbindërtimet nga paragrafi (1) i këtij ligji, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga neni 69 të këtij ligji, ndërsa organi kompetent përcakton nëse prishen standardet dhe normativat për objektet me dedikim banim në shtëpi banesore (A1) në lidhje me lartësinë e lejuar (kate dhe metra) dhe numrin e njërive banesore, të cilat janë përcaktuar në Rregulloren për standarde dhe normativa për planifikim urbanistik.

(6) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni, nuk zbatohen për mbindërtim të objekteve për banim individual të ndërtuara në përfshirje në të cilën në pajtim me planin urbanistik ose dokumentacionin e planit urbanistik është paraparë ndërtim i objektit me interes publik të përcaktuar me ligj.

## Neni 60

(1) Mënyra dhe procedura për rregullimin e truallit ndërtimor, kryhet në pajtim me Ligjin për truallin ndërtimor dhe dispozitat që dalin prej këtij ligji.

(2) Nëse organi kompetent nuk e rregullon truallin ndërtimor në pajtim me marrëveshjen për rregullimin e truallit ndërtimor, investuesi nuk bart pasoja për moskryerjen me kohë të ndërtimit.

## Neni 61

(1) Nëse organi kompetent lëshon leje për ndërtim në kundërshtim me këtë ligj apo nuk lëshon leje për ndërtim, përkatësisht nuk e refuzon kërkesën për leje për ndërtim në afatin nga neni 59 i këtij ligji, personi përgjegjës, përkatësisht personi zyrtar, i nënshtrohen përgjegjësisë penale në pajtim me kodin penal.

## Neni 62

(1) Leja për ndërtim jepet për të gjithë ndërtimin dhe në emër të investuesit ndërsa mund të lëshohet edhe për pjesë të ndërtimit, nëse pjesa e ndërtimit paraqet tërësi të veçantë ndërtimore teknike dhe funksionale.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni dhe neni 71 paragrafi (1) i këtij ligji, me kërkesë të investitorit, leje për ndërtim për ndërtime infrastrukturore në linje mund të lëshohet edhe për pjesë të ndërtimit që nuk janë tërësi funksionale nëse ato paraqesin tërësi teknike ndërtimore, ndërsa për largpërçues dhe për pjesë të largpërçuesit të cilat nuk paraqesin tërësi ndërtimore - teknike dhe funksionale.

(3) Leja për ndërtim e cila është e lëshuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji është e pavlefshme. Organi i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim, e cila është shpallur e pavlefshme, i bartë shpenzimet për kthimin e hapësirës në gjendjen që ka qenë, para lëshimit të lejes për ndërtim, ndërsa investuesi ka të drejtë për kompensim të dëmit dhe kompensim të fitimit të humbur nga organi.

(4) Në rastet kur leja për ndërtim është shpallur e pavlefshme në pajtim me nenet 59 paragrafi (20), 66 paragrafi (2) dhe 67 paragrafët (3) dhe (7) të këtij ligji, organi që e ka lëshuar lejen për ndërtim nuk i bart shpenzimet për kthim të hapësirës në gjendjen në të cilën ka qenë para lëshimit të lejes për ndërtim dhe investitori nuk ka të drejtë kompensimi të dëmit dhe fitimit të humbur nga organi.

(5) Formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes për ndërtim, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

## Neni 62-a

(1) Organi kompetent i cili e ka miratuar lejen për ndërtim, detyrohet që në afat prej tri ditësh nga miratimi i lejes për ndërtim, t'i njoftojë fqinjët e

afërt të parcelës ndërtimore me të cilën ka të bëjë leja, për lejen e lëshuar për ndërtim dhe se në afat prej 15 ditësh nga dita e lëshimit të lejes për ndërtim, mund të kryejnë inspektim në dokumentacion.

(2) Nëse fqinjët e afërt nuk kryejnë inspektim dhe/ose nuk parashtrojnë ankesë kundër lejes për ndërtim në afat prej 15 ditësh nga dita e lëshimit të lejes për ndërtim, leje për ndërtim bëhet e plotfuqishme.

(3) Organi kompetent për mbajtjen e librit publik për regjistrim të të drejtave të patundshmërive është i detyruar që të dorëzojë të dhëna për fqinjë të drejtpërdrejtë të parcelës ndërtimore për të cilën miratohet leja për ndërtim, si dhe përllogaritje për shpenzimet për regjistrim të objektit në librat publike për patundshmëri, në formë elektronike, pas pranimit të kërkesës në formë elektronike nga organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, për lejen e lëshuar për ndërtim për ndërtesa në zona zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe nga persona juridikë, për ndërtimet në zonat e lira shëndetësore, për objektet në zonat e gjelbra dhe zonat industriale si dhe për ndërtime të linjës infrastrukturore, nuk njoftohen fqinjët e drejtpërdrejtë të parcelës ndërtimore për të cilën miratohet leja.

## **Neni 62-b**

Leje për ndërtim shtesë dhe mbindërtim mund të lëshohet edhe për objekt në të cilin janë ndërtuar pjesë, respektivisht nivele të cilat nuk paraqesin tërësi funksionale, nëse për objektin ekzistues është lëshuar aktvendim për përcaktimin e statusit juridik në pajtim me Ligjin për veprim me objektet e ndërtuara pa leje, e me dokumentacionin e planit me të cilin është kryer përfshirje e pjesës së objektit për të cilin është miratuar aktvendim për përcaktimin e statusit juridik, janë paraparë kushte për ndërtim të ardhshëm.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, për mbindërtimet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji, leje për mbindërtim mund të jepet edhe nëse për objektin ekzistues është dhënë aktvendim për përcaktimin e statusit juridik në pajtim me Ligjin për veprim me objekte të ndërtuara pa leje, ndërsa me dokumentacionin e planin nuk është bërë inkuadrimi i pjesës nga objekti për të cilin është miratuar aktvendim për përcaktimin e statusit juridik.

## **Neni 63**

Gjatë ndërtimit-shtesë dhe mbindërtimit të objektit, zbatohet procedura e njëjtë e paraparë për marrjen e lejes për ndërtim, e përcaktuar me këtë ligj.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij neni, zbatohet procedura e njëjtë e paraparë për marrjen e lejes për ndërtim të përcaktuar me këtë ligj, përveç në lidhje me dokumentacionin i cili dorëzohet me kërkesën për leje për mbindërtim, me c'rast me kërkesën për leje për mbindërtim nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji dorëzohet dokumentacioni i përcaktuar në nenin 59-x paragrafi (3) të këtij ligji.

## **Neni 64**

(1) Në qoftë se për ndërtimin nevojitet që investuesi të mënjanojë konstruksion të ndërtuar ose një pjesë të tij, ndërsa të njëjtat gjenden në

kuadër të sipërfaqes për ndërtim, është i obliguar që atë ta bëjë pas plotfuqishmërisë së lejes për ndërtim, në bazë të elaboratit të veçantë për mënyrën e mënjanimi të ndërtimit ekzistues, në të cilin do të jepen zgjidhje për trajtimin e mbeturinave ndërtimore, të krijuara nga mënjanimi i konstruksionit të ndërtuar më herët.

(2) Nëse ndërtimet nga paragrafi 1 i këtij neni gjenden jashtë sipërfaqes për ndërtim, e në kuadër të parcelës ndërtuese, ndërtuesi është i obliguar që t'i mënjanojë më së voni deri në dhënien e lejes për përdorim.

## Neni 65

(1) Kundër lejes për ndërtim të lëshuar nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës përkatësisht Drejtoria për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale përkatësisht Ministria e Ekonomisë, mund të parashtrohet ankesë në afatin e përcaktuar në nenin 62-a të këtij ligji, në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, ndërsa kundër lejes për ndërtim të lëshuar nga kryetari i komunës përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupit, mund t'i parashtrohet ankesë në afatin e përcaktuar në nenin 62-a të këtij ligji, organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(2) Kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për leje për ndërtim të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit hapësinor, përkatësisht Drejtorisë për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale përkatësisht Ministria e Ekonomisë mund të paraqitet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, ndërsa kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për leje për ndërtim të kryetarit të komunës, përkatësisht kryetarit të Qytetit të Shkupit, mund të paraqitet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit hapësinor.

(3) Dokumentacioni i dorëzuar me kërkesën për marrjen e lejes për ndërtim në sistemin informativ e-leje për ndërtim, shfrytëzohet nga organi i shkallës së dytë kompetent për veprim për ankesa kundër akteve administrative të lëshuara në procedurën për lëshimin e lejes për ndërtim, Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme gjatë veprimit për padinë e paraqitur dhe ankesën në procedurë për lëshimin e lejes për ndërtim.

(4) Mënyrën e shfrytëzimit të sistemit informativ e lejeve për ndërtim nga organi i shkallës së dytë kompetent për veprim për ankesa kundër akteve administrative të lëshuara në procedurën për lëshimin e lejes për ndërtim, Gjykata Administrative dhe Gjykata Administrative Supreme gjatë veprimit për padinë e paraqitur dhe ankesën në procedurë për lëshimin e lejes për ndërtim e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

## Neni 65-a

(1) Investuesi mund të fillojë ndërtimin e ndërtimit në bazë të lejes së plotfuqishme për ndërtim.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, investuesi në përgjegjësi dhe rrezik personal mund të fillojë ndërtimin edhe në bazë të lejes përfundimtare për ndërtim.

(3) Nëse leja për ndërtim nuk është e plotfuqishme, për shkak se ankuesi ka filluar kontest administrativ, ndërsa investuesi nuk ka filluar ndërtimin e ndërtimit para se leja për ndërtim të bëhet e plotfuqishme, investuesi ka të drejtë të kërkojë kompensim të dëmit dhe kompensim për fitim të humbur nga ankuesi, nëse kërkesa e paditur dhe/ose kërkesa për ankesë nga gjykatat kompetente janë refuzuar si të pabaza dhe/ose të palejueshme.

## Neni 66

(1) Leja për ndërtim shfuqizohet në qoftë se investuesi nuk fillon me ndërtimin në afat prej gjashtë muajsh nga dita kur leja për ndërtim bëhet e plotfuqishme.

(2) Në rastet e paragrafit (1) të këtij neni, organi kompetent që e ka dhënë lejen për ndërtim, miraton akt për anulimin e lejes, që i dërgohet organit kompetent për mbajtjen e librit publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërisë, dhe i njëjti është bazë për shlyerjen e të gjitha shënimeve dhe parashënimeve të lidhura me patundshmërinë.

(3) Në qoftë se ndërtimi ka filluar të ndërtohet pas afatit të skaduar nga paragrafi (1) i këtij neni, llogaritet se ndërtimi është i paligjshëm.

## Neni 67

(1) Investuesi është i obliguar që me shkrim ta paraqesë fillimin e ndërtimit te organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, inspeksioni ndërtimor dhe inspeksioni i punës, para fillimit të ndërtimit.

(2) Në informimin nga paragrafi (1) i këtij neni, investuesi është i obliguar që t'i emërojë kryerësin dhe personin juridik për kryerjen e mbikëqyrjes me inxhinier të caktuar mbikëqyrës. Në qoftë se në procesin e ndërtimit ndërrohet kryerësi ose personi juridik për kryerjen e mbikëqyrjes përkatësisht inxhinieri i caktuar mbikëqyrës, investuesi është i obliguar që në afat prej shtatë ditësh nga ndryshimi i bërë, ta informojë organin kompetent nga paragrafi (1) i këtij neni për ndryshimin e bërë. Për ndërtime të dedikuara për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup>, nuk është i detyrueshëm caktimi i personit juridik për kryerjen e mbikëqyrjes me inxhinier mbikëqyrës të përcaktuar në njoftimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Në qoftë se investuesi nuk vepron në pajtim me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, organi kompetent i cili e ka dhënë lejen për ndërtim, miraton akt për pavlefshmërinë e lejes, e cila i dorëzohet organit kompetent për mbajtjen e librit publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërisë, dhe i njëjti është bazë për fshirjen e të gjitha shënimeve dhe parashënimeve lidhur me patundshmërinë.

(4) Në rast të ndërprerjes së ndërtimit, investuesi është i obliguar që të ndërmarrë masa për sigurimin e ndërtimit, ndërtimeve fqinje dhe të truallit.

(5) Këshilli i komunës, përkatësisht këshillat e komunave në Qytetin e Shkupit, me vendim mund ta caktojnë periudhën kohore gjatë vitit kalendarik, në të cilën nuk mund të ndërtohet ndërtesë, përkatësisht të kryhen punët ndërtimore në hapësirë të caktuar turistike. Investuesi është

i obliguar që ndërtimin ta harmonizojë, përkatësisht kryerjen e punëve ndërtimore në përputhje me vendimin, përpos në raste kur lëndë e ndërtimit është ndërtesa me interes publik të përcaktuar me ligj.

(6) Këshillat e komunave të Qytetit të Shkupit, vendimin nga paragrafi (5) të këtij neni e miratojnë pas mendimit paraprak pozitiv të Qytetit të Shkupit.

(7) Vendimi nga paragrafi (5) i këtij neni nuk zbatohet për ndërtesa me interes publik të përcaktuar me ligj.

(8) Me përjashtim, këshilli i komunës përkatësisht këshillat e komunave në Qytetin e Shkupit, mund ta përcaktojnë pamjen e një ose të më tepër ndërtimeve në hapësirë të caktuar në territorin e komunës, nëse vërtetojnë se ajo është me rëndësi për komunën, me ç'rast miratojnë program që përbëhet nga të dhëna dhe kahe për pamjen e ndërtimit, përkatësisht të ndërtimeve dhe pasqyrës grafike të pamjes së përcaktuar.

(9) Në rastet nga paragrafi (8) të këtij neni, investuesi është i obliguar që pamjen e ndërtimit ta harmonizojë me programin, në të kundërtën organi kompetent që ia ka dhënë lejen për ndërtim miraton akt për anulimin e lejes, që i dërgohet organit kompetent për mbajtjen e librit publik për regjistrimin e së drejtës së patundshmërive dhe i njëjti është bazë për shlyerjen e të gjitha shënimeve dhe parashënimeve lidhur me patundshmërinë.

(10) Gjatë ndërtimit të konstruksioneve pamja e të cilave është përcaktuar në pajtim me paragrafin (8) të këtij neni, komuna është e obliguar që ta lirojë investuesin 50% nga pagesa e kompensimit për rregullimin e truallit ndërtimor.

(11) Nëse është lëshuar leje për ndërtim në mënyrë elektronike, njoftimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, investuesi i dorëzon në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-leje për ndërtim.

## Neni 67-a

(1) Këshilli i komunës, këshilli i komunës së Qytetit të Shkupit përkatësisht këshilli i Qytetit të Shkupit me vendim mund ta përcaktojnë pamjen e fasadës së një ose më tepër objekteve të cilat janë vënë në përdorim, dhe/ose për të cilat është paraparë ndërtim plotësues dhe/ose mbindërtim apo për të njëjtat është miratuar aktvendim i plotfuqishëm për përcaktim të statusit juridik të objektit pa leje, në pajtim me Ligjin për veprim me objekte të ndërtuara pa leje, nëse konstatojnë se kjo është me rëndësi për komunën, komunën në Qytetin e Shkupit përkatësisht Qytetin e Shkupit

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, investues është komuna, komuna në Qytetin e Shkupit përkatësisht Qyteti i Shkupit, këshilli i së cilës ka miratuar vendim me të cilin përcaktohet pamja e fasadës së objektit, përkatësisht objekteve.

(3) Shpenzimet për kryerjen e punëve ndërtimore për realizimin e vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, sigurohen nga buxheti i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit, përkatësisht Qytetit të Shkupit, këshilli i së cilës e ka miratuar vendimin për pamjen e fasadës, e nëse gjatë kryerjes së punëve ndërtimore i shkaktohet dëm pronarit të objektit, investuesi detyrohet që të njëjtën ta kompensojë.

(4) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të parashihet ndërtim shtesë dhe/ose mbindërtim i objektit për të cilin është miratuar aktvendim

i plotfuqishëm për përcaktim të statusit juridik të objektit pa leje, në pajtim me Ligjin për veprim me objekte të ndërtuara pa leje, me ç'rast nëse objekti pa leje nuk është i përfshirë në dokumentacionin e planit urbanistik, me vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen edhe parametrat e ndërtimit shtesë, përkatësisht mbindërtimit. Në këtë rast projekti themelor përpilohet në pajtim me parametrat e përcaktuar në vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Nëse ndërtimi shtesë dhe mbindërtimi paraqesin tërësi të posaçme ndërtimore dhe funksionale dhe janë ndërtuar në objekt në pronësi katesh, ose në objekt me dedikim publik apo afarist, të drejtë të pronësisë mbi to merr komuna, komuna e Qytetit të Shkupit përkatësisht Qyteti i Shkupit, këshilli i së cilës e ka miratuar vendimin me të cilin është përcaktuar pamja e fasadës së objektit, e në të kundërtën të drejtën e pronësisë e merr pronari i objektit.

(6) Me përjashtim nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, pronari i objektit përkatësisht shumica e pronarëve të pjesëve të veçanta të objektit, që paraqesin më tepër se gjysmën nga sipërfaqja e përgjithshme e objektit në pronësi katesh, mund të jenë investues dhe t'i bartin shpenzimet për kryerjen e punëve ndërtimore, nëse komuna, komuna e Qytetit të Shkupit përkatësisht Qyteti i Shkupit, këshilli i së cilës e ka miratuar vendimin me të cilin është përcaktuar pamja e fasadës së objektit, kanë lidhur marrëveshje me pronarin e objektit, përkatësisht shumicën e pronarëve, me të cilën përcaktohet se investues do të jetë pronari i objektit, përkatësisht shumica e pronarëve.

(7) Me përjashtim nga paragrafi (5) i këtij neni, pronari, përkatësisht pronarët e objektit dhe komuna, komuna e Qytetit të Shkupit përkatësisht Qyteti i Shkupit, këshilli i së cilës e ka miratuar vendimin me të cilin është përcaktuar pamja e fasadës së objektit mund edhe në mënyrë të ndryshme ta rregullojnë marrjen e të drejtës së pronësisë mbi ndërtimin shtesë dhe mbindërtimin, me lidhje të marrëveshjes për rregullim të marrëdhënieve.

## **4. Afati për ndërtim**

### **Neni 68**

Investuesi detyrohet që ndërtesat nga kategoria e parë dhe e dytë t'i ndërtojë në afat jo më të gjatë se dhjetë vjet.

## **5. Ndryshimet gjatë ndërtimit**

### **Neni 69**

(1) Gjatë rrjedhës së ndërtimit mund të bëhen ndryshme të ndërtesës, nëse me ndryshimet nuk ndikohet në plotësimin e cilësdo kërkesë themelore për ndërtesën dhe nuk ndryshohet harmonizimi i ndërtesës me parametrat e planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, respektivisht lokal, dokumentacionit të planit urbanistik për zonë zhvillimore turistike, dokumentacionit të planit urbanistik për autokamp ose projektit për infrastrukturë. Për kryerjen e ndryshimeve investuesi është i obliguar që të paraqesë kërkesë me të cilën paraqet edhe plotësim të projektit themelor me raport për revizion të plotësimit të projektit themelor te organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji që e ka dhënë lejen për ndërtim.

(2) Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji është i obliguar në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, të sigurojë mendim dhe pëlqime nga subjektet e nenit 59-v të këtij ligji, sigurimi i të cilave del nga ndryshimi i kërkuar dhe të përcaktojë nëse janë plotësuar kushtet ligjore për ndryshime gjatë ndërtimit të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, me ç'rast nëse përcakton se të njëjtat janë plotësuar, janë siguruar mendimet e nevojshme dhe pëlqimet nga subjektet e nenit 59-v të këtij ligji, miraton aktvendim me të cilin lejohen ndryshime gjatë ndërtimit dhe e vërteton plotësimin në projektin themelor.

(3) Organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, me aktvendim do ta refuzojë kërkesën nëse vërteton se me plotësimin e kërkuar të pjesës së projektit themelor, ndryshohet përputhshmëria e ndërtimit parametrat e planit urbanistik ose dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, përkatësisht lokal ose projektit të infrastrukturës, ose prishet rezistenca mekanike, stabiliteti dhe mbrojtja sizmike, ose është dorëzuar mendim negativ përkatësisht nuk është dhënë mendim nga ana e subjekteve nga neni 59-v të këtij ligji.

(4) Nëse me ndryshimet e propozuara parashihet edhe sipërfaqe e re e shfrytëzueshme për ndërtesën në fjalë, investitori është i obliguar para lëshimit të aktvendimit me të cilin miratohen ndryshime të paguajë kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore për sipërfaqen e re të shfrytëzueshme.

(5) Aktvendimi për ndryshime gjatë ndërtimit është pjesë përbërëse e lejes për ndërtim, ndërsa gjatë miratimit të ndryshimeve gjatë ndërtimit të projektit për gjendjen e realizuar përpilohet në pajtim me projektin plotësues themelor.

(6) Një ekzemplar i aktvendimit nga paragrafë (2) dhe (3) të këtij neni, i dërgohet inspeksionit kompetent për ndërtim. Një ekzemplar nga aktvendimi nga paragrafi (2) të këtij neni dhe nga projekti themelor i ndryshuar, përkatësisht i vërtetuar te organi nga neni 58 i këtij ligji, organi i cili i ka miratuar ndryshimet e projektit themelor investuesi e dërgon te organi kompetent për regjistrimin investuesi e të drejtave të patundshmërive, për shkak të shënimit të të dhënave të ndryshuara në listën për parashënimin e ndërtimit. Pas miratimit të ndryshimeve, përkatësisht të plotësimeve të projektit themelor, investuesi është i obliguar që t'i kryejë ndryshimet dhe plotësimet në aktet/veprat juridike të lidhura me ndërtimin, ndërsa të shënuara në listën a parashënimin të ndërtimit dhe të njëjtat t'i dorëzojë te organi kompetent për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive, për regjistrim e ndryshimeve të bëra në listën për parashënimin e ndërtimit.

(7) Kundër aktvendimit nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, mund t'i paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit, organit kompetent për vendimmarrje për ankesën nga neni 65 të këtij ligji.

(8) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe të ekzemplarit të aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

## 6. Ndërrimi i investuesit

### Neni 70



(1) Nëse gjatë ndërtimit ndërrohet investuesi, për ndërrimin e bërë, investuesi i ri është i obliguar që ta njoftojë organin kompetent për dhënien e lejes për ndërtim dhe me njoftimin të paraqesë dëshmi se ka status të investuesit. Investuesit të ri me aktvendim do t'i pranohet statusi për investues ndërtimi, vetëm nëse me ndërmarrjen e së drejtës për ndërtim i ndërmerr edhe të drejtat dhe obligimet që investuesi i mëparshëm i ka pasur me pjesëmarrësit në ndërtim (udhëheqësin e ndërtimit, personat juridikë për kryerjen e punëve të projektimit, revizionit, mbikëqyrjes dhe kryerësit), si dhe nëse i ndërmerr të drejtat dhe obligimet që i ka pasur investuesi i mëparshëm si rezultat i marrëveshjeve të kontraktuara për hipotekë dhe vepra të tjera juridike, për qarkullimin e ndërtimit ose pjesëve nga ndërtimi të shënuara në listën për parashënim të ndërtimit, në të kundërtën pas ndërtimit nuk do t'i jepet leje për përdorimin e ndërtimit në emrin e tij, përkatësisht nuk do të përgatitet raport për kontrollin e kryer teknik nga ana e inxhinierit mbikëqyrës. Gjithashtu, në këtë rast inxhinieri mbikëqyrës nuk guxon të përpilojë raport për kontroll të kryer teknik, ndërsa për ndërtimet për banim individual më sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300m<sup>2</sup>, realizuesi nuk guxon që të japë deklaratë me të cilën do të vërtetojë se objekti është ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar. Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji është i obliguar në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës të konstatojë nëse janë plotësuar kushtet ligjore për ndërrimin e investuesit dhe të miratojë aktvendim për ndërrimin e investuesit ose aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa.

(2) Ndryshimet në aktet që jepen nga organet kompetente në lidhje me ndërtimin, të bëra për shkak të ndryshimeve në çështjet juridike të pjesëmarrësve në ndërtimin edhe atë në lidhje me marrjen e së drejtës për ndërtim, pronësisë së ndërtimit dhe marrjen e të drejtave dhe obligimeve nga investuesi, bëhen vetëm në bazë të punëve të verifikuara juridike ose akteve përfundimtare të organeve shtetërore, të përshtatshme për regjistrimin e të drejtave mbi patundshmëritë, në librin publik të patundshmërive me shënim.

(3) Me ndërrimin e investuesit, organi i cili e ka miratuar aktin për ndërrim të investuesit, është i obliguar që aktin me të cilin është bërë ndërrimi i lejes për ndërtim, menjëherë t'ia dërgojë organit kompetent për regjistrimin e të drejtave të patundshmërisë për shënimin e ndërrimit të investuesit, në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive.

(4) Ndërrimi i investuesit mund të parashtrohet deri në dhënien e lejes për përdorim, përkatësisht deri në përgatitjen e raportit për kontrollin e kryer teknik kurse për ndërtimet për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup>, para dhënies së deklaratës nga ana e realizuesit nga neni 59-b i këtij ligji, me të cilën vërteton se objekti është ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, mund t'i parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, organit kompetent për vendimmarrje për ankesë nga neni 65 i këtij ligji.

## Neni 70-a

(1) Me përjashtim nga neni 70 paragrafi (1) i këtij ligji, ndërrimi i investuesit kryhet edhe nëse personi juridik apo fizik, e ka marrë të drejtën e ndërtimit me aktvendim të gjykatësit të falimentimit gjatë shitjes të së drejtës për ndërtim në procedurë të falimentimit.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkesë për ndërrimin e investuesit dorëzon personi juridik ose fizik i cili e ka marrë të drejtën e ndërtimit në procedurë të falimentimit, bashkë me të cilën dorëzohet aktvendim të plotfuqishëm të gjykatësit të falimentimit me të cilin personi e ka marrë të drejtën e ndërtimit.

(3) Ndërrimi i investuesit kryhet me aktvendim, me ç'rast investuesi, e drejta e ndërtimit e të cilit ka qenë lëndë e shitjes në procedurë të falimentimit zëvendësohet me personin juridik ose fizik i cili e ka marrë të drejtën e ndërtimit në procedurë të falimentimit. Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të konstatojë nëse janë plotësuar kushtet ligjore për ndërrimin e investuesit dhe të miratojë aktvendim për ndërrimin e investuesit ose aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa.

(4) Nëse investuesi e drejta e ndërtimit e të cilit ka qenë lëndë e shitjes në procedurë të falimentimit, ka qenë investues i përbashkët me persona tjerë juridikë ose fizikë, gjatë miratimit të aktvendimit për ndërrim të investuesit nga paragrafi (3) i këtij neni, këta persona përcaktohen si investues të përbashkët me personin juridik ose fizik i cili e ka marrë të drejtën e ndërtimit në procedurë të falimentimit.

(5) Pas miratimit të aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni, zbatohen dispozitat e nenit 70 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji.

## **7. Leja për ndërtimin e një pjese ose të pjesëve të ndërtimit**

### **Neni 71**

(1) Leje me kërkesën e investuesit mund t'i jepet edhe për një ose për më shumë pjesë të tij, nëse paraqesin tërësi funksionale dhe ndërtuese, si fazë ndërtuese.

(2) Kërkesën për dhënien e lejes për një pjesë të ndërtimit, e paraqet investuesi me dokumentacionin e paraparë në pajtim me nenin 59 të këtij ligji.

(3) Në kërkesën nga paragrafi 2 të këtij neni theksohen pjesa respektivisht pjesët nga ndërtesa me të cilat ka të bëjë kërkesa, në pajtim me projektin themelor përkatësisht projektin për infrastrukturë (segmente rrugore, stacionazhe, numri i shtyllave e ngjashëm).

## **8. Leja për punët përgatitore**

### **Neni 72**

(1) Për ndërtimin e ndërtesave sipas nevojës mund të kryhen punët përgatitore. Punët përgatitore kryhen me marrjen e lejes për punë përgatitore. Investuesi ose realizuesi paraqet kërkesë me shkrim për marrjen e lejes për punët përgatitore. Me lejen për punë përgatitore organizohet kantieri i ndërtimit me vendosjen e konstruksioneve, që janë në funksion për ndërtimin e ndërtesës.

(2) Ndërtimet për kryerjen e punëve përgatitore janë:

- rrethoja për rrethimin e kantierit të ndërtimit,
- baza e asfaltit, reparacioni i agregateve, reparti për prodhimin e betonit,
- largpërçuesi dhe stacioni i transformatorit, që nevojitet të instalohet për shkak të furnizimit të kantierit të ndërtimit me energji elektrike,

- instalimi për sjelljen dhe kullimin e ujit,
- ndërtime për vendosjen e punëtorëve dhe të prodhimeve ndërtimore,
- depot për magazinimin e lëndëve djegëse dhe mjeteve shpërthyes dhe
- ndërtime tjera që janë të nevojshme për ndërtimin e ndërtesës.

(3) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohen projekti për punët përgatitore, pëlqimet, mendimet dhe dëshmitë për marrëdhëniet e rregulluara pronësore-juridike, për truallin në të cilin do të vendosen ndërtimet për punët përgatitore.

(4) Ndërtimet nga paragrafi (2) të këtij neni janë me karakter të përkohshëm dhe nuk parashihen me planin urbanistik, kurse kryerësi është i obliguar t'i mënjanojë dhe tokën ta rregullojë në mënyrë përkatëse, më së voni deri në paraqitjen e kërkesës për leje për përdorim.

(5) Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, të lëshojë leje për punë përgatitore ose të miratojë aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa. Në lejen për punë përgatitore përcaktohet afati për mënjanimin e ndërtimeve për kryerjen e punëve përgatitore.

(6) Nëse investitori nuk siguron leje për ndërtim në afat prej një viti nga dita e marrjes së lejes për punët përgatitore, leja e marrë shfuqizohet dhe kryerësi është i obliguar që menjëherë t'i mënjanojë ndërtimet e vendosura për punët përgatitore dhe truallin ta rregullojë në mënyrë përkatëse.

(7) Një ekzemplar të lejes së dhënë për punët përgatitore nga paragrafi (1) të këtij neni, përkatësisht të aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa për dhënien e lejes për punët përgatitore nga paragrafi (1) të këtij neni, i dërgohet edhe inspektoratit kompetent për ndërtim.

(8) Kundër lejës gjegjësisht aktvendimi nga paragrafi (5) i këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e dhënies së lejes, te organi kompetent për vendimmarrje për ankesën nga neni 65 i këtij ligji.

## **9. Ndërtimet për të cilat nuk nevojitet leja për ndërtim**

### **Neni 73**

(1) Leja për ndërtim nuk është e nevojshme për ndërtimet vijuese:

- stacionet matëse për mbrojtje të medimeve të mjedisit jetësor,
- ndërtimet e përkohshme të dedikuara për veprimtari hulumtuese (ndërtime për kryerjen e matjeve hulumtuese, resurse natyrore, stacione matëse për erë, diell, ajër, shpime, mihje dhe të ngjashme), kur ekziston vendimi i organit kompetent, për një periudhë prej më së shumti tre vitesh, periudhë pas së cilës duhet të mënjanohen,
- ndërtime në funksion të mbrojtjes nga breshri dhe ndërtim për sinjalizim në komunikacionin ajror,
- rruga e pakategorizuar që shërben për ekonomizim me pyjet dhe shfrytëzim të resurseve të tjera natyrore, të lejuara me dispozitë të veçantë,
- përmendore, shenja përkujtimore dhe skulptura,
- varreza dhe përmendore në varreza, në suazat e varrezave të përcaktuara me planin urbanistik,
- ndërtime me të cilat mundësohet dhe lehtësohet lëvizja e personave me invaliditet në ndërtim dhe deri te ndërtimi,
- gjatë montimit dhe ndërrimit të pajisjes në ndërtim është në përdorim, për shkak të zgjerimit të kapacitetit të ndërtimit, e me të cilën nuk

ndryshohet dedikimi i ndërtimit dhe hapësira ku është vendosur pajisja, as nuk ndryshohen kushtet e përgjithshme për mbrojtje dhe shpëtim të parapara me projektin themelor për ndërtim pajisje telekomunikuese për transmetim intern të të folurit dhe fotografisë, pajisja në funksion të mbrojtjes së ndërtimit nga vjedhjet, mbrojtjes dhe shpëtimit dhe

- rrethoja;
- pajisja komunikuese elektronike për transmetim të fotografisë, të folurit dhe të dhënave tjera që vendoset në objektet për të cilat është dhënë leje për përdorim dhe
- pano reklamuese dhe informative që vendosen në objekte.
- mure mbështetëse,
- ndërtime ndihmëse të cilat janë në funksion të objektit për banim ose lloj tjetër të objektit dhe ndërtohen në parcelë të njëjtë urbanistike (garazh me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 50 m<sup>2</sup>, depo, gropë septike e të ngjashme),
- strehë në funksion të objektit,
- basene në nivel të terrenit për përdorim individual,
- ndërtesa të përkohshme për nevojat e Drejtorisë për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale të cilat ndërtohen në kuadër të zonave zhvillimore teknologjike industriale,
- fusha sportive të hapura dhe të mbyllura,
- salla sportive me sipërfaqe bruto të zhvilluar deri në 1500 m<sup>2</sup>,
- kuti matëse dhe ndarëse për energji elektrike dhe kablo me tension të ulët,
- kablo optikë, kablo optikë me kanalizim kabllosh dhe kanalizim kabllosh për kablo optikë,
- ndërtesa të përkohshme për vendosje të punëtorëve gjatë ndërtimit të objekteve industriale dhe objekteve infrastrukturore në linjë,
- enë nëntokësore për hedhurina komunale,
- objekte shoqëruese të varrezave (morg, krematorium, objekte të posaçme për djegie të hedhurinave dhe materialit tjetër të hedhur nga varrezat, objekte sanitare, puse me ujë industrial dhe shitore për shitje të qirinjve dhe luleve),
- stacione hekurudhore ndërtimi i të cilave është financuar me mjete të Bashkimit Evropian ose organizatës tjetër ndërkombëtare,
- pajisje për rregullim automatik të kalimit nëpërmjet hekurudhave ekzistuese dhe instalime për ndjekje automatike dhe menaxhim të komunikacionit në hekurudhat ekzistuese dhe
- foto-panelet me tension për prodhimin e energjisë elektrike me kapacitet maksimal të instaluar deri në 1 MW të cilat vendosen në objekte,
- pano reklamuese elektronike informative (me sipërfaqe mbi 30 m<sup>2</sup> dhe me elemente konstruktive) të cilat vendosen në sipërfaqe publike),
- plazhe me objekte shoqëruese të cilat ndërtohen në sipërfaqe tokësore dhe ujore në kuadër të hapësirës së paraparë për plazh,
- shtigje për këmbësorë,
- puse nëntokësore me sisteme të linjës të cilat janë në funksion të puseve,
- pajisje komunikuese elektronike për ndjekje dhe rregullim të komunikacionit në rrugët ekzistuese.

(2) Për ndërtimet nga paragrafi 1 alineja 6 e këtij neni, nuk zbatohen dispozitat nga neni 74 i këtij ligji, e të njëjtat ndërtohen në pajtim me Ligjin për varreza dhe shërbime të varrimit.

(3) Ndërtimet nga paragrafi (1) alinetë 16, 17, 18, 21, 23 dhe 24 të këtij neni., të cilat nuk parashihen me planin urbanistik, përkatësisht dokumentacionin urbanistik të planit, parashihen me programin që përbëhet nga pjesa grafike dhe tekstuale, me ç'rast pjesa tekstuale përmban të dhëna për ndërtesën dhe hapësirën për vendosjen e

ndërtesës, kurse pjesa grafike përbëhet nga pasqyra e gjendjes ekzistuese dhe gjendjes së planifikuar. **11**

(4) Programin nga paragrafi (3) i këtij neni për ndërtesat për nevojat e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit e lejon Këshilli i komunës, Këshilli i komunës në Qytetin e Shkupit, përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit, e për ndërtesat, realizimi i të cilave financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë ose nga persona juridikë në pronësi të plotë ose dominuese të Republikës së Maqedonisë ose me mjete të Bashkimit Evropian përkatësisht organizatës tjetër ndërkombëtare. si dhe për ndërtesa të përkohshme për vendosjen e punëtorëve gjatë ndërtimit të objekteve të linjës infrastrukturore nga kategoria e parë e nenit 57 të këtij ligji, e lejon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e rregullimit hapësinor. **12**

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e rregullimit hapësinor miraton Udhëzim për mënyrën e hartimit të programit nga paragrafi (3) të këtij neni.

## Neni 74

(1) Për realizimin e ndërtesave, përkatësisht vendosjen e pajisjes nga neni 73 paragrafi (1) të këtij ligji, investuesi parashtron kërkesë për realizim përkatësisht vendosje me dokumentacion të nevojshëm te komuna, komuna në Qytetin e Shkupit përkatësisht Qyteti i Shkupit, në rajonin e të cilës duhet të realizohet ndërtesa, përkatësisht të vendoset pajisja dhe aktvendimin e jep kryetari i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit përkatësisht Qytetit të Shkupit.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkesa për realizimin e ndërtesave përkatësisht vendosjen e pajisjes nga neni 73 paragrafi (1) i këtij ligji, realizimi i të cilës, përkatësisht vendosja është e financuar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, ose nga ana e personave juridikë në pronësi të plotë ose dominuese të Republikës së Maqedonisë ose me mjete të Bashkimit Evropian përkatësisht organizatës tjetër ndërkombëtare. si dhe për ndërtesa të përkohshme për vendosjen e punëtorëve gjatë ndërtimit të objekteve të linjës infrastrukturore nga kategoria e parë e nenit 57 të këtij ligji, parashtrohet në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës dhe aktvendimin e jep ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirëskërkesa për realizimin e ndërtesave përkatësisht vendosjen e pajisjes nga neni 73 paragrafi (1) i këtij ligji në sazat e zonave zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe nga personat juridikë si edhe në zonat industriale dhe zonat e gjelbra të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, parashtrohet në Drejtorinë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale dhe aktvendimin e lëshon drejtori i Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale, ndërsa kërkesa për realizimin e ndërtesave përkatësisht vendosjen e pajisjeve nga neni 73 paragrafi (1) i këtij ligji në suazat e zonave zhvillimore teknologjike industriale për të cilat është nënshkruar marrëveshje me partneritet privat publik parashtrohet në Ministrinë e Ekonomisë dhe aktvendimin e lëshon ministri i Ekonomisë. **13**

(3) Organi kompetent nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, miraton aktvendim për realizimin e ndërtesës përkatësisht vendosje të pajisjes, në afat prej pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës, nëse, dokumentacioni i dorëzuar është i kompletuar dhe janë plotësuar kushtet për realizimin e ndërtesës përkatësisht të vendosjes së pajisjes, kurse në

të kundërtën miraton konkluzion për ndërprerje të procedurës me të cilin e ngarkon investuesin që t'i mënjanojë mangësitë e konstatuara në afat prej shtatë ditësh pune nga pranimi i konkluzionit. Nëse investuesi i mënjanon mangësitë e konstatuara dhe e plotëson kërkesën në afatin e përcaktuar, organi kompetent është i detyruar në afat prej tri ditësh pune të miratojë aktvendim për realizimin e ndërtesës, përkatësisht vendosjen e pajisjes, kurse në të kundërtën miraton aktvendim për refuzim të kërkesës.

(4) Kundër konkluzionit përkatësisht aktvendimit të kryetarit të komunës, komunës së Qytetit të Shkupit përkatësisht Qytetit të Shkupit mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të konkluzionit përkatësisht aktvendimit, te ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit të hapësirës.

(5) Kundër konkluzionit përkatësisht aktvendimit të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit të hapësirës, konkluzioni përkatësisht aktvendimi i drejtorit të Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale dhe konkluzioni përkatësisht aktvendimi i ministrit të Ekonomisë, mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimi të konkluzionit përkatësisht aktvendimit, në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

(6) Aktvendimi për vendosje në rrugë të pa kategorizuar që shërben për ekonomizim me pyje dhe shfrytëzim të resurseve tjera natyrore të miratuara me rregull të veçantë, pajisja komunikuese elektronike për bartje të fotografisë, zërit dhe të dhënave tjera që vendoset në objekte, ndërtesa ndihmëse që janë në funksion të objektit për banim ose lloj tjetër të objektit dhe ndërtohen në parcelën e njëjtë urbanistike (garazh me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 50m<sup>2</sup>), basene në nivel të terrenit për përdorim individual, kablo optike, kablo optikë me kanalizim të kabllave dhe kanalizim të kabllave për kablo optikë, fusha sportive të hapura dhe salla sportive me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 1500 m<sup>2</sup> si dhe stacione hekurudhore ndërtimi i të cilave është financuar me mjete të Bashkimit Evropian ose organizatës tjetër ndërkombëtare, i miratuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, që është i plotfuqishëm, paraqet bazë juridike për shënimin, parashënimin dhe regjistrimin e të drejtës së pronësisë të ndërtesës përkatësisht pajisjes në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive.. 14

(7) Ndërtimet nga paragrafit (7) i këtij neni lëshohen në përdorim dhe regjistrohen në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive pas përgatitjes së raportit për kontrollin e kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës, në të cilin konstatohet se ndërtimi është vendosur përkatësisht realizuar sipas aktvendimit për vendosje përkatësisht realizim dhe se ndërtimi mund të lëshohet në përdorim.

(8) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për lëshimin e aktvendimit për realizim përkatësisht për vendosje, dokumentacionin e nevojshëm dhe formularin e aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve për rregullim të hapësirës.

(9) Nëse për ndërtesat përkatësisht pajisjet nga neni 73 të këtij ligji është paraparë pagim i kompensimit për rregullimin e ndërtimit për tokë ndërtimore në pajtim me Rregulloren për shkallën e rregullimit të tokës ndërtimore me objekte të infrastrukturës komunale dhe mënyrën e përcaktimit të shumës së harxhimeve për rregullimin varësisht nga shkalla

e rregullimit, investitori është i obliguar ta paguajë kompensimin para lëshimit të aktvendimit për realizimin e ndërtesave përkatësisht vendosjen e pajisjes.

(10) Investitori mund të fillojë me ndërtim të ndërtesës përkatësisht vendosje të pajisjes nga neni 73 të këtij ligji në bazë të aktvendimit të plotfuqishëm për realizimin e ndërtesës përkatësisht vendosjen e pajisjes nga neni 73 të këtij ligji, ndërsa me përjashtim me përgjegjësi personale dhe rrezik investitori mund të fillojë me ndërtim dhe në bazë të aktvendimit përfundimtar.

## **10. Rastet e veçanta të ndërtimit**

### **Neni 75**

(1) Në rast rreziku nga dukuritë natyrore ose nga shkatërrimet e luftës dhe shkatërrimeve të tjera, që drejtpërdrejt mund t'i rrezikojnë njerëzit dhe të mirat materiale, gjatë këtyre rreziqeve dhe menjëherë pas ndërprerjes së tyre, pa leje për ndërtim mund të ndërtohen ato ndërtime që shërbejnë për parandalimin e veprimit të atyre rreziqeve, përkatësisht mënjanimin e pasojave të dëmshme.

(2) Ndërtimet nga paragrafi 1 të këtij neni, duhet të mënjanojnë më së voni një vit nga dita e pushimit të rrezikut.

### **Neni 76**

Në rast të dëmtimit të objekteve nën ndikimin e dukurive natyrore ose nga shkatërrimet e luftërave dhe shkatërrimet tjera, ndërtimi varësisht nga shkalla e dëmtimit mund të kthehet në gjendjen e mëparshme pa leje për ndërtim, e në pajtim me lejen për ndërtim, përkatësisht me projektin e miratuar në bazë të së cilit është ndërtuar. Në rast se bëhet fjalë për ndërtim të regjistruar në Regjistrin nacional për trashëgimi kulturore, nevojitet që të kërkohet leje sipas rregullave nga fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

### **Neni 77**

(1) Objekti mund të kthehet në gjendjen e mëparshme në bazë të projektit për renovim, ndërsa organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji do ta konsiderojë si të renovuar, nëse pronari i tij dorëzon:

- 1) një ekzemplar nga projekti për rindërtim,
- 2) një ekzemplar nga leja për ndërtim, përkatësisht të projektit të miratuar në bazë të së cilit është ndërtuar objekti,
- 3) procesverbal për pranim - dorëzim e ndërtimit të rindërtuar me raportin përfundimtar nga inxhinieri mbikëqyrës, me vërtetim se objekti është rindërtuar në pajtim me projektin për rindërtim, dhe
- 4) një kopje nga plani i kadastrës.

(2) Objekti, leja për ndërtim të të cilit ose leja tjetër përkatëse, përkatësisht dokumentacioni është zhdukur ose është i pakapshëm në rastet nga neni 76 të këtij ligji, do të llogaritet si i rindërtuar, nëse pronari i saj parashtron:

- 1) një ekzemplar nga projekti për rindërtim;
- 2) procesverbal për pranim - dorëzim të ndërtimit të rikonstruktuar, me raport përfundimtar nga inxhinieri mbikëqyrës, me vërtetim se objekti është rindërtuar në pajtim me projektin për rindërtim;
- 3) kopje nga plani i kadastrës.

(3) Ndërtimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, llogaritet për ndërtim të përdorshëm.

## Neni 78

(1) Projekti për rindërtimin e objektit ose pjesë të objektit, përmban zgjidhje teknike dhe përshkrim për mënyrën e rindërtimit të objektit ose pjesës së tij, të paraqitur si gjendje ekzistuese dhe gjendje e rindërtuar, me çfarë nuk do të ndikojë në stabilitetin e truallit ose në plotësimin e kërkesave themelore të objekteve fqinje, si dhe transportin dhe përkujdesjen e hedhurinave ndërtimore që mënjanohet dhe rregullimin e parcelën ndërtimore.

(2) Në projektin për rindërtim nga paragrafi (1) të këtij neni, kryhet revizion në pajtim me nenin 21 të këtij ligji.

## Neni 78-a

(1) Gjatë ndërtimit të rrugëve shtetërore dhe komunale mund të formohet venddepozitim i tokës, e cila paraqet hapësirë në të cilën depozitohet toka gjatë ndërtimit të rrugës.

(2) Për formimin e venddepozitimit të tokës, investitori në rrugë shtetërore respektivisht komunale dorëzon projekt për infrastrukturë, të cilin e miraton organi kompetent nga paragrafi (3) të këtij neni.

(3) Projekti për infrastrukturë për venddepozitim të tokës në rrugë shtetërore e miraton organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, për venddepozitim të tokës në rrugë komunale e miraton komuna, komuna e qytetit të Shkupit respektivisht qyteti i Shkupit.

(4) Venddepozitimi i tokës mund të shfrytëzohet nëse toka është përfshirë me projektin për infrastrukturë me të cilin është formuar venddepozitimi është në pronësi të Republikës së Maqedonisë, kurse nëse nuk është në pronësi të Republikës së Maqedonisë respektivisht e njëjta është në pronësi të personit fizik ose juridik, mund të shfrytëzohet pas zgjidhjes së marrëdhënieve juridike pronësore me pronarin e tokës.

(5) Formimi i venddepozitimit në tokë në rrugë shtetërore dhe në rrugë komunale, paraqet interes publik.

## Neni 78-b

(1) Nëse gjatë ndërtimit të rrugës shtetërore ose hekurudhës nevojitet të bëhet dislokimi i largpërçuesit ose trafostacionit, zbatohet procedurë për dislokim të objektit energjetik.

(2) Dislokimi i objektit energjetik nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet në bazë të projektit të miratuar për dislokim të objektit energjetik.

(3) Për miratimin e projektit për dislokim të objektit energjetik, operatori i sistemit elektrodistributiv në kuadër të të cilit është largpërçuesi dhe/ose trafostacioni që janë lëndë e dislokimit, parashtron kërkesë te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, me të cilën dorëzohet projekti për dislokimin e objektit energjetik me raport pozitiv për revizionin e të njëjtit.

(4) Organi kompetent nga paragrafi (3) i këtij neni, është i detyruar që në afat prej pesë ditë pune të miratojë aktvendim për miratimin e projektit



për dislokim të objektit energjetik dhe ta verifikojë projektin me verifikim dhe vulë ose të dorëzojë njoftim për mangësitë e konstatuara të parashtruesi i kërkesës. Nëse parashtruesi i kërkesës për miratimin e projektit për dislokim të objektit energjetik nuk i mënjanon mangësitë e konstatuara në afat prej 10 ditësh pune nga pranimi i njoftimit për mangësitë e konstatuara, organi kompetent nga paragrafi (3) i këtij neni miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës.

(5) Kontrollin teknik të objekteve të dislokuara energjetike nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen inxhinieri mbikëqyrës me autorizim A për kryerjen e mbikëqyrjes së ndërtimit të objekteve dhe të njëjtat vihen në përdorim pas përpilimit të raportit për kontroll të kryer teknik në pajtim me nenin 90 paragrafi (3) të këtij ligji, në të cilin është konstatuar se largpërçuesi përkatësisht trafostacioni janë ndërtuar në pajtim me projektin për dislokim të objektit energjetik dhe se mund të vihen në përdorim.

(6) Aktvendimi i plotfuqishëm për miratim të projektit për dislokim të objektit energjetik paraqet bazë juridike për shënim, parashënim dhe regjistrim të së drejtës së pronësisë të largpërçuesit përkatësisht trafostacionit në librin publik për regjistrim të të drejtave të patundshmërive.

(7) Nëse toka në të cilën është paraparë të vendosen shtyllat e largpërçuesit ose të ndërtohet trafostacioni është në pronësi të personave fizikë ose juridikë, operatori i sistemit elektrodistributiv largpërçuesi përkatësisht trafostacioni i të cilit është lëndë e dislokimit, është i detyruar që pas miratimit të aktvendimit për miratim të projektit për dislokim të objektit energjetik të sigurohjë marrëveshje për qiramarrje afatgjate për tokën të lidhur me pronarin e tokës ose pëlqim nga pronari i tokës për vendosje të shtyllës përkatësisht ndërtim të trafostacionit ose të themelojë të drejtë të servitutit të tokës në fjalë ose në procedurë për eksproprijim të jetë miratuar vendim për vendosje në zotërim të tokës në pajtim me Ligjin për eksproprijim, e në të kundërtën largpërçuesi përkatësisht trafostacioni nuk mund të vihet në përdorim.

(8) Objektet e dislokuara energjetike nga paragrafi (1) i këtij neni, për të cilat është hartuar raport për kontrollin e kryer teknik në pajtim me nenin 90 paragrafi (3) të këtij ligji, në të cilin është konstatuar se largpërçuesi përkatësisht trafostacioni janë ndërtuar në pajtim me projektin për dislokimin e objektit energjetik, e për të cilat në procedurën e eksproprijimit është miratuar vendimi për vendosje në zotërim të tokës në pajtim me Ligjin për eksproprijim, mund të vihen në përdorim, por nuk mund të regjistrohen në librin publik për patundshmëri deri në zgjidhjen e marrëdhënieve juridike pronësore me pronarin e tokës në të cilën të njëjtat janë ndërtuar.

(9) Dislokimi i largpërçuesit dhe trafostacionit gjatë ndërtimit të rrugës shtetërore apo vijës hekurudhore paraqet interes publik.

(10) Formën dhe përmbajtjen e projektit për dislokimin e objektit energjetik dhe të aktvendimin për miratimin e projektit për dislokimin e objektit energjetik, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

## **11. Objektet e përkohshme dhe pajisja urbane**

### **Neni 79**

(1) Komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, miratojnë Program vjetor për vendosjen e objekteve të përkohshme, me të cilin përcaktohet hapësira ku mund të vendosen objektet e përkohshme, që duhet të jetë truell ndërtimor i pandërtuar, pronësi e Republikës së Maqedonisë, me infrastrukturë të ndërtuar dhe për të cilin është miratuar dokument i planit urbanistik.

(2) Programi nga paragrafi (1) miratohet nga ana e këshillit të komunës, përkatësisht këshillave të komunave në Qytetin e Shkupit dhe këshillin e Qytetit të Shkupit, me marrjen e pëlqimit nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës. Programi përbëhet nga pjesa grafike dhe tekstuale. Pjesa tekstuale përmban të dhëna për hapësirën për vendosjen e objektit të përkohshëm, sipërfaqen dhe lartësinë e objektit të përkohshëm dhe për llojin e veprimtarisë që do të kryhet. Pjesa grafike përbëhet nga skema e gjendjes së planifikuar dhe ekzistuese.

(3) Pas miratimit të programit nga paragrafi (1) i këtij neni, organi kompetent për zbatimin e procedurës për dhënien e tokës ndërtimore me qira afatshkurtër në pajtim me Ligjin për tokë ndërtimore, zbaton procedurë për ndarjen me qira afatshkurtër të tokës ndërtimore të përfshirë me program.

(4) Kushtet e mikro - lokacionit paraqesin ekstrakt nga pjesa grafike dhe tekstuale e Programit vjetor për objekte të përkohshme, dhe i përpilojnë organet kompetente nga paragrafi (1) i këtij neni dhe në bazë të të njëjtave përpilohet elaborati gjeodezik.

(5) Objektet e përkohshme vendosen pas marrjes së lejes për vendosje të objektit të përkohshëm, që ua lëshojnë kryetari i komunës, përkatësisht kryetarët e komunave në Qytetin e Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit, personave që kanë lidhur marrëveshje për qira afatshkurtër për truallin në fjalë.

(6) Me kërkesë për vendosje të objektit të përkohshëm parashtrohet:

- marrëveshja për qira afatshkurtër të kantierit të ndërtimit të truallit ndërtimor, e lidhur në pajtim me ligjin,
- aktzotërimi për truallin në fjalë dhe
- projekti ideor për vendosjen e objektit të përkohshëm, të përpiluar në pajtim me kushtet e mikrolokacionit.

(7) Dhënia e lejes për vendosjen e objekteve të përkohshme pa dhënien e pëlqimi të Programit nga paragrafi (1) të këtij neni, dhe/ose në kundërshtim me dispozitat ligjore, paraqet kusht për heqjen e kompetencës për dhënien e lejes për vendosjen e objekteve të përkohshme.

## Neni 80

(1) Pajisja urbane vendohet në sipërfaqet publike që paraqesin truall ndërtimor të ndërtuar dhe të rregulluar, me ç`rast pa e çrregulluar dedikimin themelor të hapësirës dhe sigurinë e komunikacionit. Nevojën për vendosjen e pajisjes urbane e përcakton këshilli i komunës, këshillat e komunave të Qytetit të Shkupit dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit.

(2) Pajisja urbane vendoset pas marrjes së lejes për vendosje të pajisjes urbane, që e jep kryetari i komunës, kryetarët e komunave në Qytetin e Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) të këtij neni, për pajisje urbane elektronike informative dhe pano reklamuese (me sipërfaqe mbi 30 m<sup>2</sup>

dhe me elemente konstruktive) të cilat vendosen në sipërfaqe publike, lëshohet aktvendim në pajtim me nenin 73 të këtij ligji.

### **Neni 80-a**

(1) Për vendosjen e pajisjes urbane, këshilli i komunës, këshillat e komunave në Qytetin e Shkupit dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit, miratojnë program me të cilin përcaktohet numri, lloji dhe madhësia e pajisjes urbane si dhe lokacionet dhe objektet në të cilat mund të vendoset e njëjta.

(2) Këshillat e komunave në Qytetin e Shkupit, programin nga paragrafi (1) i këtij neni, e miratojnë pas mendimit paraprak pozitiv nga Qyteti i Shkupit.

### **Neni 81**

(1) Me lejen për vendosjen e objektit të përkohshëm dhe lejen për vendosjen e pajisjes urbane, përcaktohen kushtet, mënyra dhe afati për vendosjen dhe mënjanimin e objektit të përkohshëm përkatësisht të pajisjes urbane.

(2) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në sferën e rregullimit të hapësirës, miraton Udhëzim për mënyrën e përpilimit të Programit vjetor për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe kushtet e mikro - lokacionit, dhe e përcakton formën dhe përmbajtjen e lejes për vendosjen e objektit të përkohshëm dhe lejes për vendosjen e pajisjes urbane.

(3) Organet kompetente nga neni 79, paragrafi (1) të këtij ligji, janë të obliguara që të mbajnë regjistër për lejet e dhëna për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe të pajisjeve urbane.

## **VI. KANTIERI I NDËRTIMIT**

### **1. Formimi dhe rregullimi i kantierit të ndërtimit**

#### **Neni 82**

(1) Para fillimit të kryerjes së punëve në truallin e parcelës ndërtimore, investuesi është i obliguar që të sigurojë shënjimin e ndërtimit të projektuar në terren, me shenja adekuate nga ana e tregtarit individual, përkatësisht të shoqërisë tregtare për punë gjeodezike, e cila përgatit elaborat gjeodezik për shënimin e ndërtimit të projektuar.

(2) Mënyrën e shënit të ndërtimit të projektuar në terren, do ta përcaktojë ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

#### **Neni 83**

(1) Kryerësi është i obliguar që kantierin e ndërtimit ta rrethojë për shkak të pengimit të qasjes së pakontrolluar në kantierin e ndërtimit me rrethojë adekuate, në mënyrë që punët në kantierin e ndërtimit nuk do t'i rrezikojnë kalimtarët.

(2) Në kantierin e ndërtimit i cili shtrihet në sipërfaqe më të madhe (hekurudha, rrugë, largpërçues dhe të ngjashme), pjesët e kantierit të

ndërtimit që nuk mund të rrethohen, doemos duhen të jenë të mbrojtura me shenja të caktuara komunikacioni ose të shënuara në mënyrë tjetër.

(3) Kantieri i ndërtimit doemos duhet të shënohet me tabelë informative, e cila në mënyrë të obligueshme duhet të përmbajë: emrin, përkatësisht emrin e pjesëmarrësve në ndërtim, emrin dhe llojin e ndërtimit që ndërtohet, organin kompetent nga neni 58 i këtij ligji, numrin dhe datën e lejes së dhënë për ndërtim, si dhe shenjën se punohet për trashëgimi kulturore të patundshme të mbrojtur në pajtim me ligjin, nëse ky ndërtim është i regjistruar në Regjistrin nacional të trashëgimisë kulturore.

### **Neni 84**

(1) Kryerësi është i obliguar që gjatë zënies së përkohshme të truallit fqinj, përkatësisht truallit përreth për nevojat e kantierit të ndërtimit, të veprojë në pajtim me ligjin.

(2) Për zënien e përkohshme të sipërfaqeve publike të komunikacionit për nevojat e kantierit të ndërtimit, realizuesi është i obliguar që të nxjerrë akt nga organi kompetent, në pajtim me ligjin.

### **Neni 85**

(1) Ndërtimet për punët përgatitore dhe pajisja e montuar në kantierin e ndërtimit, doemos duhet t`u përgjigjen kërkesave themelore për ndërtim.

(2) Ndërtimet nga paragrafi (1) të këtij neni, materialet e pashfrytëzuara ndërtimore dhe të tjera, hedhurinat dhe të ngjashme, doemos duhet të mënjanohen në afatin e përcaktuar në lejen për punët përgatitore, nga neni 72 të këtij ligji.

## **2. Dokumentacioni i kantierit ndërtimor**

### **Neni 86**

(1) Kryerësi i ndërtimit është i obliguar ta posedojë dokumentacionin vijues:

- 1) aktvendimin për regjistrim në Regjistrin qendror dhe licencën adekuate, të lëshuar në pajtim me këtë ligj;
- 2) vërtetimin për inxhinier të caktuar për realizim dhe inxhinier mbikëqyrës të kantierit të ndërtimit;
- 3) lejen për ndërtim me projektin themelor;
- 4) raportin për revizionin e kryer nga reviduesi;
- 5) ditarin për ndërtim dhe librin për ndërtim;
- 6) dëshminë për kualitet të përcaktuar për prodhimet si dhe dëshmi për prejardhjen e gurit ndërtimor teknik, rërës ndërtimore dhe zhavorrit e futura ndërtimore;
- 7) elaboratin për mbrojtje gjatë punës;
- 8) mendim për shkallën e projektuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës, mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës gjatë ndërtimit dhe mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës pas ndërtimit të tërë sistemit konstruktiv të ndërtesës.
- 9) të dhëna komplete për pjesëmarrësit në ndërtim dhe
- 10) dokumentacionin tjetër, nëse me ligj tjetër është përcaktuar obligimi se kryerësi duhet ta posedojë në kantierin e ndërtimit.

(2) Në rastet kur procedura për lëshimin e lejes për ndërtim është realizuar në mënyrë elektronike lëshuesi nuk është i obliguar që në kantier

të ketë projekt themelor dhe raport për revizion të kryer nga revizori.

(3) Në rastet kur është lëshuar leja për ndërtim në pajtim me Ligjin për zona zhvillimore industriale teknologjike dhe Ligjin për zona të gjelbra industriale, realizuesi ka për detyrë që në vendin e ndërtimit ta ketë dokumentacionin në bazë të të cilit është lëshuar leja për ndërtim në pajtim me Ligjin për zona zhvillimore industriale teknologjike dhe Ligjin për zona të gjelbra industriale.

## VII. LEJA E PËRDORIMIT

### Neni 87

(1) Ndërtimi do të lëshohet në përdorim pas lëshimit të lejes për përdorim për ndërtimet e kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, pas përpilimit të raportit për kontroll teknik të kryer nga inxhinieri mbikëqyrës në të cilin konstatohet se ndërtimi mund të lëshohet në përdorim për ndërtimet e kategorisë së dytë edhe për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji, ndërsa ndërtimet e dedikuara për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup> (përveç mbindërtimeve në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji) do të lëshohen në përdorim pas dhënies së deklaratës së verifikuar në noter, me përgjegjësi të plotë materiale dhe penale nga realizuesi, me të cilën do të vërtetohet se objekti është ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar.

(2) Lejen për përdorim, për ndërtime të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji e jep organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim pasi që me kontrollin teknik do të vërtetohet se ndërtimi është ndërtuar në pajtim me projektin themelor ose me projektin e gjendjes së realizuar, nëse janë bërë ndryshime gjatë ndërtimit.

(3) Procedura për dhënien e lejes për përdorim, zbatohet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(4) Lejen për përdorimin e objektit i jepet investuesit, në bazë të dëshmisë nga libri publik për regjistrimin e së drejtës së patundshmërive-aktzotërimit me drejtën e regjistruar të pronësisë, të drejtave të tjera reale dhe të gjitha parashënimet dhe shënimet ose dëshmi tjetër për arritjen e së drejtës së ndërtimit, në pajtim me ligjin.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (4) i këtij neni, për objektet infrastrukturore në linijë të cilat janë rrugë shtetërore, rrugë dhe rugica lokale, sisteme të furnizimit me ujë dhe sisteme të kanalizimit, vija hekurudhore, gazsjellës, largpërçues, përçues të produkteve, përçues të nxehtësisë, naftësjellës, teleferikë, sisteme për ujitje dhe kullim, rrugë magjistrale dhe mbledhëse në zonën e qytetit të Shkupit si dhe hidrocentrale dhe diga me akumulime, leja për përdorimin e objektit mund t'i lëshohet investuesit, nëse në procedurën për eksproprijim është miratuar vendim për vendosje në zotërim të tokës në pajtim me Ligjin për eksproprijim

(6) Kundër lejes për përdorim përkatësisht kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa për dhënien e lejes për përdorim, të lëshuar nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, përkatësisht nga Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale përkatësisht Ministria e Ekonomisë, mund t'i parashtrahet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të lejes,

përkatësisht pranimit të aktvendimit, Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(7) Një ekzemplar nga leja për përdorimin e ndërtimit, i dërgohet inspektoratit kompetent për ndërtim, kurse për ndërtim për të cilin ka strehimore i dërgohet edhe organit kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes dhe shpëtimit, për mbajtjen e evidencës së strehimores.

(8) Kur leja për ndërtim është në emër të më shumë personave, investuesve, në lejen për përdorim shënohen të gjithë personat, kurse pjesët për çdonjërin shprehen në pjesët ideale (thyesa) ose pjese reale, në bazë të dispozitave nga marrëveshja për rregullimin e marrëdhënieve reciproke dhe të pjesëve në lidhje me ndërtimin e verifikuar nga noteri, e të parashtruar në procedurën për dhënien e lejes për ndërtim.

(9) Në rastet nga neni 62 paragrafi (2) i këtij ligji, ndërtimi lëshohet në përdorim, përkatësisht lëshohet leje për përdorim apo përpilohet raport për kontroll teknik nga inxhinieri mbikëqyrës vetëm për tërë ndërtimin, pasi do të ndërtohen të gjitha pjesët e ndërtimit dhe ndërtimi do të paraqesë tërësi teknike ndërtimore dhe funksionale.

(10) Formën dhe përmbajtjen e lejes për përdorim, përkatësisht deri në përgatitjen e raportit për kontrollin e kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës, e përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

## **1. Kërkesa për dhënien e lejes për përdorim**

### **Neni 88**

(1) Kërkesën për dhënien e lejes për përdorim, e parashtron investuesi.

(2) Me kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni, investuesi parashtron:

- projekt themelor, e nëse janë bërë ndryshime gjatë ndërtimit, projekt të gjendjes së realizuar,
- raport përfundimtar të inxhinierit mbikëqyrës me të cilin vërtetohet se ndërtimi është ndërtuar në pajtim me projektin themelor dhe lejen për ndërtim dhe
- ekstrakt nga libri publik për regjistrimin e së drejtës së patundshmërive për gjendjen e fundit të të drejtave të regjistruara të ndërtimit (aktzotërimi) për përcaktimin e marrëdhënies juridike në lidhje me ndërtimin, ndërmjet investuesit dhe pronarit të truallit ndërtimor.

(3) Në rastet kur është lëshuar leje për ndërtimin e objekteve infrastrukturore në linjë që janë rrugë shtetërore, rrugë dhe rrugë lokale, sisteme ujësjellësi dhe kanalizimi, vija hekurudhore gazsjellës dhe largpërçues, produktsjellës, përçues të nxehjes, naftësjellës, teleferikë, ndërtesa për prodhim të energjisë elektrike nga burime rigjeneruese, sisteme për ujitje dhe drenazhim, basene në nivel të terrenit për përdorim publik ndërtesa që paraqesin trashëgimi të patundshme të mbrojtur kulturore në pajtim me ligjin, si dhe për objekte për nevojat e organeve shtetërore, agjencive ose fondeve të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe personat juridikë në pronësi të plotë ose dominuese të Republikës së Maqedonisë, me obligim që investuesi t'i rregullojë marrëdhëniet pronësore- juridike deri në parashtrimin e kërkesës për leje për përdorim, përkatësisht deri në përpilimin e raportit për kontrollin e kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës, krahas dokumentacionit nga paragrafi (2) i këtij neni investuesi është i detyruar me kërkesën të

dorëzohet elaborat gjeodezik për të dhënat numerike dhe dëshmi për marrëdhënie të zgjidhura pronësore-juridike.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, për objektet infrastrukturore në linjë të cilat janë rrugë shtetërore, rrugë dhe rrugica lokale, sisteme të furnizimit me ujë dhe sisteme të kanalizimit, vija hekurudhore, gazsjellës, largpërçues, përçues të produkteve, përçues të nxehtësisë, naftësjellës, teleferikë, sisteme për ujitje dhe kullim, rrugë magjistrale dhe mbledhëse në zonën e Qytetit të Shkupit si dhe hidrocentrale dhe diga me akumulime, për të cilat në procedurën për eksproprijim është miratuar vendimi për vendosje në zotërim të tokës në pajtim me Ligjin për eksproprijim, krahas dokumentacionit nga paragrafi (2) të këtij neni, investuesi ka për detyrë që me kërkesë të dërgojë vendim për vendosje në zotërim të tokës të miratuar në pajtim me Ligjin për eksproprijim.

(5) Në rastet kur është lëshuar leje për ndërtim të ndërtesës për të cilën zbatohet Rregullorja për karakteristika energjetike të ndërtesave krahas dokumentacionit nga paragrafi (2) i këtij neni, investuesi me kërkesë dorëzon edhe certifikatë për karakteristika energjetike të ndërtesës të lëshuar nga tregtari individ apo personi juridik që posedon licencë për kryerje të kontrollit energjetik.

## **2. Kontrolli teknik**

### **Neni 89**

(1) Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, është i obliguar që pas pranimit të kërkesës për dhënien e lejes për përdorim, ta bëjë kontrollin teknik të ndërtimit.

(2) Në rast të kërkesës jo të plotë, organi kompetent është i obliguar që në afat prej shtatë ditësh nga pranimi i lejes, të kërkojë plotësim.

(3) Kontrollin teknik të ndërtimit, e kryen komisioni në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës së plotë. Komisioni përbëhet së paku prej tre anëtarësh dhe zëvendësve të tyre, me autorizimin e inxhinierit mbikëqyrës të dhënë në përputhje me këtë ligj, varësisht nga kategoria e ndërtimit në të cilin do të bëhet kontrolli teknik, kurse për rrjetin e komunikimeve dhe mjeteve elektronike, është e nevojshme që në komision të ketë së paku dy anëtarë nga Agjencia për Komunikime Elektronike.

(4) Komisionin për kontroll teknik të ndërtimeve nga kategoria e parë nga neni 57 të këtij ligji, e formon organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji i cili ka lëshuar lejen për ndërtim.

(5) Për ndërtimet e kategorisë së dytë nga neni 57 të këtij ligji, edhe për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji kontrollin teknik e kryen inxhinieri mbikëqyrës për çfarë përpilon raport për kontrollin e kryer teknik. Raporti dorëzohet në komunë ku është ndërtuar objekti së bashku me elaboratin gjeodezik për matje të kryer të objektit dhe dëshminë për shpenzimet e paguara për regjistrim të objektit në librat publike të patundshmërive në pajtim me llogaritjen nga neni 59 paragrafi (15) i këtij ligji.

(6) Për ndërtimet e dedikuara për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup> (përveç për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji), nuk kryhet kontroll teknik, ndërsa realizuesi detyrohet që të japë deklaratë të verifikuar në noter, me

përgjegjësi të plotë materiale dhe penale, me të cilën do të vërtetohet se objekti është ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar. Deklarata me të cilën vërtetohet se objekti është ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar, dorëzohet në komunën ku është ndërtuar objekti bashkë me elaboratin gjeodezik për matje të kryer të objektit dhe dëshminë për shpenzimet e paguara për regjistrim të objektit në librat publike të patundshmërive në pajtim me llogaritjen nga neni 59 paragrafi (15) i këtij ligji.

### **Neni 89-a**

Për ndërtesat nga kategoria e dytë nga neni 57 i këtij ligji për të cilat zbatohet Rregullorja për karakteristika energjetike të ndërtesave, investuesi para kryerjes së kontrollit teknik siguron certifikatë për karakteristika energjetike të ndërtesës të lëshuar nga tregtari individ apo personi juridik që posedon licencë për kryerje të kontrollit energjetik.

### **Neni 90**

(1) Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, e organizon kontrollin teknik dhe i njofton pjesëmarrësit në ndërtim për vendin, ditën dhe orën e kryerjes së kontrollit teknik.

(2) Komisioni që bën kontroll teknik, për punën e vet përpilon procesverbal në të cilin konstaton nëse:

- nëse ndërtimi është ndërtuar në pajtim me projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar dhe lejen për ndërtim;
- ndërtimi është me fasadë dhe mund të përdoret,
- ka mangësi të caktuara, që patjetër duhet të mënjanohen që të mund të jepet leje për përdorim dhe
- ka mangësi që i çrregullojnë kërkesat themelore të ndërtimit, që kanë të bëjnë me rezistencën mekanike, stabilitetin dhe mbrojtjen sizmike dhe do të propozojë që për atë ndërtim të mos jepet leje përdorimi.

(3) Inxhinieri mbikëqyrës i cili kryen kontroll teknik për ndërtime të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji, edhe për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji në raportin teknik për kontroll të kryer teknik konstaton nëse ndërtimi është ndërtuar në pajtim me projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar dhe lejen për ndërtim, nëse ndërtimi është me fasadë dhe mund të përdoret, nëse ka mangësi të caktuara të cilat doemos duhet të mënjanohen dhe nëse ka mangësi të caktuara të cilat i shkelin kërkesat themelore të ndërtimit, të cilat kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë mekanike, stabilitetin dhe mbrojtjen sizmike për shkak të të cilave ndërtimi nuk mund të lëshohet në përdorim.

(4) Në rastet nga neni 59 paragrafi (17) i këtij ligji, Komisioni, përkatësisht inxhinieri mbikëqyrës që kryen kontroll teknik, detyrimisht konstaton nëse investitori i ka rregulluar marrëveshjet pronësore juridike për tërë parcelën ndërtimore, e nëse të njëjtat nuk janë rregulluar plotësisht, ndërtimi nuk mund të lëshohet në përdorim.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (4) i këtij neni, për objektet infrastrukturore në linjë të cilat janë rrugë shtetërore, rrugë dhe rrugica lokale, sisteme të furnizimit me ujë dhe sisteme të kanalizimit, vija hekurudhore, gazsjellës, largpërçues, përçues të produkteve, përçues të nxehtësisë, naftësjellës, teleferikë, sisteme për ujitje dhe kullim, rrugë magjistrale dhe mbledhëse në zonën e qytetit të Shkupit si dhe hidrocentrale dhe diga me akumulime, ndërtimi mund të vihet në përdorim



nëse në procedurën për eksproprijim është miratuar vendimi për vendosje në zotërim të tokës në pajtim me Ligjin për eksproprijim.

(6) Në rastet kur gjatë kryerjes së kontrollit teknik të objektit për nevojat e organeve shtetërore, agjencive dhe fondeve të themeluara nga Republika e Maqedonisë dhe persona juridikë në pronësi të plotë ose dominuese të Republikës së Maqedonisë, Komisioni përkatësisht inxhinieri mbikëqyrës konstaton se nuk është ndërtuar rrugë ose rrugicë lokale në të cilën duhet të lidhet objekti, i njëjti mund të lëshohet në përdorim, nëse gjatë kryerjes së kontrollit teknik sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni nuk konstatohen mangësi të tjera për shkak të të cilave objekti nuk mund të lëshohet në përdorim.

(7) Formën dhe përmbajtjen e raportit për kontroll të kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës për ndërtimet e kategorisë së dytë, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

### **Neni 90-a**

Nëse gjatë kryerjes së kontrollit teknik, Komisioni, përkatësisht inxhinieri mbikëqyrës që kryen kontroll teknik, konstaton se nuk ekzistojnë dëshmi për prejardhjen e gurit ndërtimor teknik, rërës ndërtimore dhe zhavorrit, detyrohen që për këtë ta njoftojnë organin kompetent nga neni 58 i këtij ligji që e ka lëshuar lejen për ndërtim, si dhe Inspektoratin Shtetëror për Inspeksion Teknik.

### **Neni 90-b**

Nëse nuk janë siguruar mendim pozitiv për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës gjatë ndërtimit dhe mendim pozitiv për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës pas ndërtimit të tërë sistemit konstruktiv të ndërtesës, ndërtesa nuk mund të lëshohet në përdorim.

### **Neni 90-v**

Nëse nuk është siguruar certifikatë për karakteristika energjetike të ndërtesës të lëshuar nga tregtari individ apo personi juridik që posedon licencë për kryerje të kontrollit energjetik, ndërtesa për të cilën zbatohet Rregullorja për karakteristika energjetike e ndërtesave nuk mund të vihet në përdorim, përkatësisht realizuesi nuk mund ta japë deklaratën nga neni 89 paragrafi (6) të këtij ligji.

### **Neni 91**

Realizuesi detyrohet që në ditën e kryerjes së kontrollit teknik, komisionit nga neni 89 i këtij ligji, përkatësisht inxhinierit mbikëqyrës i cili duhet të kryejë kontroll teknik, t'ia jap në shikim dokumentacionin e tërësishëm të shënuar në nenin 86 të këtij ligji.

### **Neni 92**

(1) Investuesi është i obliguar që në llogari të vet, t'i kompensojë shpenzimet për kryerjen e kontrollit teknik.

(2) Mënyrën e kryerjes së kontrollit teknik, e përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(3) Lartësinë e shpenzimeve për kontrollin teknik nga paragrafi (1) të këtij neni, me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

### **Neni 92-a**

(1) Procedurën për lidhjen e objektit me rrjet të ujësjellësit dhe të kanalizimit, e zbaton njësia e vetadministrimit lokal në territorin e të cilës është ndërtuar objekti.

(2) Objekti i cili është ndërtuar pa leje për ndërtim nuk mund të lidhet me infrastrukturë teknike (elektroenergjetike, të ujësjellësit, të kanalizimit, rrugore dhe të ngjashme).

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni objekti që ndërtohet pa leje për ndërtim mund të lidhet me infrastrukturën teknike nëse për këtë lëshohet pëlqim urbanistik apo aktvendim për përcaktim të statusit juridik të objektit pa leje në pajtim me Ligjin për përcaktim të statusit juridik të objekteve pa leje.

(4) Komuna është e obliguar që ta fillojë procedurën për lidhjen e objektit me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit të njoftimit nga inxhinieri mbikëqyrës, ndërsa për objektet për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup> nga realizuesi, nëse nuk është caktuar inxhinier mbikëqyrës.

## **3. Lëshimi i lejes për përdorim**

### **Neni 93**

(1) Organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, do të lëshojë leje për përdorim për ndërtimin në afat prej 15 ditësh nga dita e kontrollit të kryer teknik, nëse komisioni që e ka bërë kontrollin teknik, në procesverbal konstaton se ndërtimi mund të vihet në përdorim.

(2) Nëse komisioni gjatë kryerjes së kontrollit teknik, vërteton mangësi për shkak të së cilave nuk mund të jepet leje për përdorim, do ta lajmërojë me shkrim investuesin për mënjanimin e tyre në afat jo më të gjatë se 30 ditë.

(3) Kërkesën për dhënien e lejes për përdorim, organi kompetent do ta refuzojë me aktvendim nëse në kohën e caktuar nga paragrafi (2) të këtij neni, nuk mënjanohe mangësitë e përcaktuara gjatë kryerjes së kontrollit teknik.

### **Neni 94**

(1) Leje për përdorimin e ndërtimit të kategorisë së parë, nga neni 57 të këtij ligji, me kërkesën e investuesit mund të jepet për një ose për më shumë pjesë të tij, nëse paraqesin tërësi ndërtimore dhe funksionale, si fazë ndërtimi.

(2) Për ndërtimet e kategorisë të dytë nga neni 57 të këtij ligji, me kërkesë të investitorit mund të përgatitet raport për kontrollin e kryer teknik për një apo më shumë pjesë për ndërtimin, nëse paraqesin tërësi ndërtimore apo funksionale si fazë ndërtimore.

## **4. Pranim - dorëzimi i ndërtimit të kryer**

## Neni 95

Pas dhënies së lejes për përdorim nga organi kompetent i nenit 58 të këtij ligji, përkatësisht pas përgatitjes së raportit për kontrollin e kryer teknik nga ana e inxhinierit mbikëqyrës, përkatësisht pas dhënies së deklaratës nga realizuesi për objektet për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup>, kryerësi dhe investuesi, e kryejnë pranim - dorëzimin e objektit ndërtimor dhe për atë përpilojnë procesverbal për pranim - dorëzimin e ndërtimit të kryer si objekt ndërtimor.

## 5. Regjistrimi i patundshmërive në librin publik

### Neni 96

(1) Procedurën për regjistrimin e objektit në librin publik të patundshmërive e zbaton organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim.

(2) Për ndërtimet e kategorisë së parë, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, detyrohet që në emër dhe për llogari të investuesit, të dorëzojë kërkesë për regjistrimin e objektit ndërtimor në librin publik të patundshmërive, në organin kompetent për regjistrimin e të drejtave mbi patundshmëritë, në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimin të elaboratit gjeodezik për matje të kryer të objektit dhe dëshmisë për shpenzimet e paguara për regjistrim të objektit në librat publike të patundshmërive nga ana e investuesit, në pajtim me llogaritjen nga neni 59 paragrafi (15) i këtij ligji.

(3) Për ndërtimet e kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji, edhe për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji, komuna detyrohet që në emër dhe për llogari të investuesit, të dorëzojë kërkesë për regjistrimin e objektit ndërtimor në librin publik të patundshmërive, në organin kompetent për regjistrimin e të drejtave mbi patundshmëritë, në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimin të raportit të inxhinierit mbikëqyrës me elaborat gjeodezik për matje të kryer të objektit dhe dëshmi për shpenzimet e paguara për regjistrim të objektit në librat publike të patundshmërive nga ana e investuesit në pajtim me llogaritjen nga neni 59 paragrafi (15) i këtij ligji, ndërsa për objektet për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup> (përveç për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji), në afat në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimin të deklaratës nga realizuesi me elaborat gjeodezik për matje të kryer të objektit dhe dëshmi për shpenzimet e paguara për regjistrim të objektit në librat publike të patundshmërive nga ana e investuesit në pajtim me llogaritjen nga neni 59 paragrafi (15) i këtij ligji.

(4) Për ndërtime në zonat zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe nga personat juridikë, të cilët i ndërtojnë qiramarrësit dhe pronarët e tokës në zonat zhvillimore teknologjike industriale, (përveç për objektet infrastrukturore në suazat e zonës, të cilat i ndërtojnë subjektet-dhënës të shërbimeve publike të cilat janë kompetentë për ndërtimin e infrastrukturës elektroenergjetike, të ujësjellësit, kanalizimit, gazpërçuesit dhe telekomunikimit), për ndërtimet në zonat e lira shëndetësore, si dhe për objektet në zonat industriale dhe të gjelbra të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë të cilat i ndërtojnë pronarët e tokës në zonat industriale dhe të gjelbra, organi kompetent nga neni 58 paragrafi (3) i këtij ligji i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim është i obliguar në emër dhe në llogari të investitorit të parashtrijë kërkesë për regjistrimin e objektit ndërtimor në librin publik të

patundshmërive, në organin kompetent për regjistrimin e të drejtave për patundshmëri, në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të elaboratit gjeodezik për matje të kryer të objektit dhe dëshmisë për shpenzime të paguara për regjistrimin e objektit në librat publikë të patundshmërive nga ana e investitorit.

(5) Për rrugë magjistrale dhe lidhëse në rajonin e Qytetit të Shkupit si dhe për objekte infrastrukturore në linjë ndërtimi i të cilave në pajtim me Ligjin për Qytetin e Shkupit është në kompetencë të Qytetit të Shkupit, Qyteti i Shkupit është i obliguar që në emër dhe për llogari të investuesit të paraqesë kërkesë për regjistrimin e objektit ndërtimor në librin publik të patundshmërive, te organi kompetent për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive, në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të elaboratit gjeodezik për matjen e kryer të objektit dhe dëshmi për shpenzime të paguara për regjistrimin e objektit në librat publikë të patundshmërive nga investuesi në pajtim me përlllogaritjen nga neni 59 paragrafi (15) i këtij ligji.

(6) Organi kompetent për regjistrimin e të drejtave mbi patundshmëritë, objektin ndërtimor do ta regjistrojë në librin publik të patundshmërive pas kërkesës së parashtruar nga organet nga paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni, të cilës i bashkëngjitet projekti themelor ose projekti i gjendjes së realizuar, nëse janë bërë ndryshime gjatë ndërtimit, elaborati gjeodezik për matje të kryer të objektit, si dhe leja për përdorimin e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, raporti për kontrollin e kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës për ndërtime të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji, edhe për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji, përkatësisht deklarata e verifikuar në noter, e dhënë me përgjegjësi të plotë materiale dhe penale nga realizuesi, me të cilën vërtetohet se objekti është ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar për ndërtimet e dedikuara për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m<sup>2</sup> (përveç për mbindërtimet në rastet nga neni 59-x paragrafi (1) të këtij ligji).

(7) Me përjashtim nga paragrafi (6) i këtij neni, objektet infrastrukturore në linjë të cilat janë rrugë shtetërore, rrugë dhe rrugica lokale, sisteme të furnizimit me ujë dhe sisteme të kanalizimit, vija hekurudhore, gazsjellës, largpërçues, përçues të produkteve, përçues të nxehtësisë, naftësjellës, teleferikë, sisteme për ujitje dhe kullim, rrugë magjistrale dhe mbledhëse në zonën e qytetit të Shkupit si dhe hidrocentrale dhe diga me akumulime, për të cilat është lëshuar leja për përdorim në pajtim me nenin 93 paragrafi (1) të këtij ligji përkatësisht për të cilat është hartuar raporti për kontrollin e kryer teknik në pajtim me nenin 90 paragrafi (3) të këtij ligji në të cilin është konstatuar se mund të vihen në përdorim, e për të cilat në procedurën për eksproprijim është miratuar vendim për vendosje në zotërim të tokës në pajtim me Ligjin për eksproprijim, nuk mund të regjistrohen në librin publik të patundshmërive deri në zgjidhjen e marrëdhënieve juridike pronësore me pronarin e tokës në të cilën të njëjtat janë ndërtuar.

## VIII. PËRDORIMI, MIRËMBAJTJA DHE MËNJANIMI I OBJEKTIT PËR NDËRTIM

### 1. Përdorimi, ridedikimi, adaptimi dhe rekonstruktimi i objektit ndërtimor

#### Neni 97

(1) Objekti përdoret në pajtim me dedikimin e tij.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, pjesë e veçantë e objektit, banesë ose pjesë e banesës, mund të ridedikohet, rikonstruktohet ose të përshtatet, nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(3) Për ridedikim të pjesës së veçantë të objektit , banesës ose pjese të banesës pronari i objektit, te organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, paraqet kërkesë për ridedikim me ç'rast me kërkesën paraqet:

- ekstrakt të planit urbanistik ose dokumentacionit të planit me të cilin konfirmohet se lëndë e ridedikimit është parashikuar me dokumentacionin e planit;

- provë për të drejtën e pronësisë së pjesës së fundit të objektit, gjegjësisht banesës ose pjesës e banesës, që është lëndë e ridedikimit; projekt themelor për ridedikimin e parashikuar, me raport pozitiv për revizionin e të njëjtit dhe

- marrëveshje me komunitetin e pronarëve të pjesëve të veçanta të objektit ose pëlqim me shkrim nga shumica e pronarëve të pjesëve të veçanta të objektit të cilët paraqesin më tepër se gjysma e sipërfaqes së përgjithshme të objektit me lista pronësore për pjesët e veçanta të objektit nëse bëhet fjalë për objekt në pronë të katit.

(4) Për rikonstruktim të objektit ose një pjese të objektit, pronari i objektit, ndërsa në rastet kur është miratuar vendim në pajtim me nenin 67-a paragrafi (1) të këtij ligji, komuna, komunat në qytetin Shkupi ose qyteti Shkup, me organin kompetent nga neni 58 të këtij ligji paraqet kërkesë për rikonstruktim, me ç'rast me kërkesën paraqet:

- provë për të drejtën e pronësisë mbi pjesën e veçantë të objektit, respektivisht banesës ose pjesës së banesës, ndërsa nëse bëhet fjalë për rikonstruktim të objektit për të cilin është miratuar vendim në pajtim me nenin 67-a (1) të këtij ligji, vendim i këshillit të komunës, këshilli i komunës në qytetin e Shkupit ose këshilli i qytetit të Shkupit;

- aktzotërim për objektin lëndë e rikonstruktimit ose aktvendimit të plotfuqishëm për përcaktimin e statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje i miratuar në pajtim me Ligjin për veprim me objekte të ndërtuara pa leje, për objektin për të cilin është paraqitur kërkesë për rikonstruktim dhe
- projekt themelor të parashikuar për rikonstruktim, me raport pozitiv për revizionin e të njëjtit.

(5) Për përshtatje të pjesës së veçantë të objektit , banesës ose pjesës të banesës pronari pjesës së veçantë të objektit, banesës ose pjesës të banesës te organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, paraqet kërkesë për përshtatje me ç'rast me kërkesën paraqet:

- aktzotërim për objektin lëndë e përshtatjes ose aktvendimit të plotfuqishëm për përcaktimin e statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje të miratuar në pajtim me Ligjin për veprim me objekte të ndërtuara pa leje, për objektin për të cilin është paraqitur kërkesë për përshtatje dhe
- projekt për përshtatje i cili përmban gjendjen aktuale dhe gjendjen e re që parashihet me përshtatjen.

(6) Organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, në afat prej pesë ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës, konstaton nëse është i kompletuar dokumentacioni i dorëzuar, konstaton nëse janë plotësuar kushtet për ridedikimin e kërkuar, rikonstruktimin ose përshtatjen dhe siguron mendime dhe pëlqime në pajtim me nenin 59-v të këtij ligji, nëse konstaton se të njëjtat duhet të sigurohen.

(7) Nëse dokumentacioni i dorëzuar është i kompletuar, janë plotësuar kushtet për ridedikimin e kërkuar ose rikonstruktimin ose përshtatjen dhe mendimi pozitiv i siguar respektivisht pëlqimi nga subjektet e nenit 58-v

të këtij ligji te të cilat është paraqitur kërkesë për inspektim në projektin themelor, organi kompetent në afatin e përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni miraton aktvendim me të cilin aprovohet ridedikimi ose rikonstruktimi ose përshtatja dhe e vërteton dokumentacionin e projektit, ndërsa në të kundërt miraton konkluzë për ndërprerje me çka e angazhon kërkuesin t'i largojë mangësitë e konstatuara në afat prej 10 ditë pune.

(8) Nëse kërkuesi nuk i largon mangësitë e konstatuara dhe nuk e plotëson kërkesën në afatin nga paragrafi (7) të këtij neni, organi kompetent është i obliguar në afat prej tre ditë pune të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës, ndërsa nëse kërkuesi e plotëson kërkesën dhe i mënjanon mangësitë e konstatuara, organi kompetent në afat prej pesë ditë pune miraton aktvendim me të cilin lejohet ridedikimi ose rikonstruktimi ose përshtatja.

(9) Nëse ndonjë nga subjektet nga neni 59-v te të cilët është paraqitur kërkesa për këqyrje kanë dhënë vërejtje për projektin themelor, organi kompetent është i obliguar menjëherë pas plotësimit të kryer të kërkesës nga kërkuesi, të paraqesë kërkesë për këqyrje të sërishme në projektin themelor, te subjektet e nenit 59-v të këtij ligji të cilët kanë dhënë vërejtje, ndërsa të njëjtit të kontrollojnë nëse është vepruar në lidhje me vërejtjet e dhëna paraprakisht, në afat prej dy ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës për këqyrje të sërishme mbi projektin themelor.

(10) Nëse gjatë procedurës për ridedikim konstatohet se nevojitet të paguhet kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore, organi kompetent lëshon aktvendim me të cilin aprovohet ri dedikimi, deri te kërkuesi paraqet përlllogaritje, ndërsa kërkuesi është i obliguar në afat prej 15 ditë pune nga dita e pranimit të përlllogaritjes ta paguajë kompensimin, ndërsa në të kundërt miratohet vendim për refuzimin e kërkesës.

(11) Nëse gjatë kryrjes së rikonstrukcionit ose përshtatjes të pjesës së fundit të objektit, banesës ose pjesës së banesës kryhet edhe ridedikimi, kërkuesi është i obliguar te organi kompetent të paraqesë kërkesë për rikonstruktim me ridedikim ose përshtatje me ridedikim dhe t'i paraqesë provat e përcaktuara në paragrafin (3) të këtij neni.

(12) Kundër aktvendimit për leje ose aktvendimit për refuzimin e kërkesës për ridedikim, rikonstruktim, rikonstruktim me ridedikim, përshtatje, përshtatje me ridedikim mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit, te organi kompetent për vendimmarrje për ankesa nga neni 65 të këtij ligji.

(13) Ekzemplar nga aktvendimi i plotfuqishëm me të cilin është aprovuar kërkesa për ridedikim, rikonstruktim, rikonstruktim me ridedikim, përshtatje, përshtatje me ridedikim si dhe dokumentacion projektues të verifikuar, paraqitet te organi kompetent për regjistrimin e të drejtave të patundshmërinë dhe te inspekcioni ndërtimor kompetent.

(14) Ridedikimi dhe përshtatja e pjesës së veçantë të objektit, banesës ose pjesës së banesës nuk mund të lejohet nëse cenohen parametrat për dedikimin dhe/ose ridedikimin për numrin e njëjësive banesore të objektit të cilat janë përcaktuar në planin e vlefshëm urbanistik gjegjësisht dokumentacionin e planit urbanistik.

## **Neni 97-a**

Në rastet kur është lëshuar leja për rikonstrukcion të objektit për të cilin zbatohet Rregullorja për karakteristikat energjetike të ndërtesave, e bëhet fjalë për rikonstrukcion të konsiderueshëm në pajtim me nenin 48

paragrafi (6) të këtij ligji, përveç për objektin për banim individual, investuesi pas rikonstruksionit të kryer siguron certifikatë për karakteristikat energjetike të ndërtesës të lëshuar nga tregtari individ apo personi juridik që posedon licencë për kryerje të kontrollit energjetik.

### **Neni 97-b**

(1) Rikonstruksioni i objekteve nga neni 73 paragrafi (1) të këtij ligji kryhet në bazë të projektit të lejuar për rikonstruksion.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) të këtij neni, për lejimin e projektit për rikonstruksion parashtrohet kërkesë te organi kompetent nga neni 74 i këtij ligji, me të cilën dorëzohet projekti për rikonstruksion me raport pozitiv për revizion të të njëjtit.

(3) Organi kompetent nga neni 74 i këtij ligji te i cili është dorëzuar kërkesa nga paragrafi (2) i këtij neni, detyrohet që në afat prej shtatë ditësh pune ta lejojë projektin me vënien e verifikimit dhe vulës në të njëjtin apo të dorëzojë njoftim për mangësitë e konstatuara.

### **Neni 97-v**

(1) Rikonstruktimi i objekteve infrastrukture në linjë kryhet në bazë të projektit të miratuar për rikonstruktim.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) të këtij neni, për miratimin e projekteve për rikonstruktim paraqet kërkesë te organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, të cilit i bashkëngjitet projekti për rikonstruktim me raport pozitiv për revizionin e të njëjtit.

(3) Organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, te i cili paraqitet kërkesa nga paragrafi (2) të këtij neni, është i obliguar në afat prej shtatë ditësh pune të aprovojë projektin me vendosjen e vërtetimit dhe vulës mbi të ose ta paraqesë njoftimin për konstatimin e parregullsive.

## **2. Mirëmbajtja e objektit për ndërtim**

### **Neni 98**

(1) Pronari i objektit është i obliguar që nëpërmjet mirëmbajtjes vijuese dhe investuese, t'i ruajë kërkesat themelore për ndërtim, në pajtim me projektin për shfrytëzim dhe mirëmbajtje.

(2) Për punët nga paragrafi (1) i këtij neni, pronari i objektit mund të caktojë person juridik - udhëheqës për mirëmbajtje vijuese-investuese të objekteve të kategorisë së parë dhe të dytë (përveç objekteve për banim mbi tre nivele), nga neni 57 të këtij ligji.

(3) Udhëheqës për mirëmbajtje mund të jetë personi juridik, i regjistruar në Regjistrin qendror për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe që ka licencë për udhëheqës të mirëmbajtjes.

(4) Me kërkesën për marrjen e licencës nga paragrafi (3) i këtij neni, personi juridik është i obliguar që të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe
- dëshmi se ka të punësuar së paku dy persona, prej të cilëve njëri me autorizim A për inxhinier për kryerjen ose autorizimin A për inxhinier mbikëqyrës, ndërsa një person me autorizim B për inxhinier për kryerje ose autorizimin B për inxhinier mbikëqyrës.

### 3. Mënjanimi i objektit

#### Neni 99

(1) Mënjanimi i objektit ose i pjesës së tij, bëhet në rast të dëmtimit të objektit nëse ekziston rreziku për rrënimin e tij.

(2) Pronari i objektit është i obliguar që të ndërmarrë edhe masa urgjente për mënjanimin e objektit, përkatësisht ta shënojë objektin si të rrezikshëm me shenja adekuate, të vendosë rrethojë mbrojtëse, deri në mënjanimin e rrezikut dhe t'i parashtrojë kërkesë për marrjen e lejes për mënjanim, organit kompetent nga neni 58 i këtij ligji.

(3) Nëse pronari i objektit nuk i kryen punët nga paragrafi (2) i këtij neni, atë do ta kryejë organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji.

(4) Kërkesës për lejen e mënjanimit, i bashkëngjitet;  
- dëshmi për pronësi të objektit dhe  
- projekti për mënjanimin e objektit ose të një pjese të tij.

(5) Procedura për dhënien e lejes për mënjanim, zbatohet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

(6) Organi kompetent nga paragrafi (2) i këtij neni, sipas detyrës zyrtare merr pajtueshmëri ose mendim nga organet tjera, për kushtet për vlerësimin dhe mënjanimin e objektit, të cilët janë të obliguar që më së voni në afat prej shtatë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës, ta dorëzojnë pajtimin ose mendimin, përkatësisht të refuzojnë kërkesën për dhënien e pëlqimit, në të kundërtën do të konsiderohet se kanë dhënë pëlqim, përkatësisht mendim pozitiv. Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji është i obliguar në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës, të lëshojë leje për mënjanim ose të miratojë aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa.

(7) Mënjanimi i objektit kryhet pas marrjes së lejes për mënjanim, të dhënë nga organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, për ndërtime të kategorisë të parë dhe të dytë, nga neni 57 të këtij ligji.

(8) Me përjashtim nga paragrafi (7) i këtij neni, pa lejen për mënjanim mund të mënjanohen ndërtimet nga neni 73 të këtij ligji.

(9) Nëse pronari i objektit nuk vepron në pajtim me lejen për mënjanim, mënjanimin do ta kryejë organi kompetent nga neni 58 të këtij ligji, me shpenzimet e pronarit të objektit.

(10) Kërkesë për dhënien e lejes për mënjanimin e objektit ose një pjese të tij, mund të parashtrojnë edhe persona të tjerë të interesuar. Organi kompetent është i obliguar që të konstatojë, nëse kërkesa është e bazuar dhe nëse e njëjta ka bazë, e njofton me shkrim pronarin e objektit për fillimin e procedurës për mënjanim në afat prej më së shumti 30 ditë. Nëse pronari i objektit nuk parashton kërkesë për marrjen e lejes për mënjanim, organi kompetent do të miratojë leje për mënjanimin dhe mënjanimin do ta kryejë me shpenzimet e pronarit të objektit.

(11) Kundër lejes për mënjanimin respektivisht aktvendimit për refuzimin e kërkesës mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditëve te organi kompetent për vendimmarrje për ankesë nga neni 65 i këtij ligji.

(12) Mënyrën dhe procedurën për shënimin e objektit, vendosjen e rrethojës mbrojtëse, llojin e shenjave dhe mënjanimin e objektit, i



përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

### **Neni 99-a**

(1) Objektin e ndërtuar, i cili nuk është i dëmtuar apo nuk ekziston rrezik nga për rrënim të tij, pronari mund ta mënjanojë pas marrjes së lejes së plotfuqishme për mënjanim të objektit, të lëshuar nga organi kompetent për lëshimin e lejes për ndërtim nga neni 58 i këtij ligji.

(2) Me kërkesën për leje për mënjanim të objektit dorëzohet:

- dëshmi për pronësi të objektit dhe
- projekt për mënjanimin e objektit ose pjesës së tij.

(3) Procedura për lëshimin e lejes për mënjanim zbatohet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

(4) Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji është i obliguar në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës, të lëshojë leje për mënjanim ose të miratojë aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa.

(5) Kundër lejes për mënjanimin respektivisht aktvendimin për refuzimin e kërkesës mund të deklarohet ankesë në afat prej 15 ditë te organi kompetent për vendimmarrje për ankesë nga neni 65 të këtij ligji.

(6) Gjatë mënjanimit të objektit, pronari, detyrohet të vendosë rrethojë mbrojtëse dhe shenja për mënjanim të objektit në pajtim me rregullën nga neni 99 paragrafi (12) i këtij ligji.

### **Neni 100**

(1) Projekti për mënjanimin e objektit ose të një pjese të tij, përmban zgjidhje teknike dhe përshkrim për mënyrën e mënjanimit të objektit ose të një pjese të tij, me çka nuk do të ndikojë në stabilitetin e tokës ose plotësimin e kërkesave themelore të objekteve përreth, si dhe transportin dhe përkujdesjen e mbeturinave ndërtimore, që mënjanohen dhe rregullimin e parcelës ndërtuese, pas mënjanimit të objektit ose pjesës së tij.

(2) Projektit për mënjanim nga paragrafi (1) i këtij neni, i kryhet revizion në pajtim me nenin 21 të këtij ligji.

(3) Shpenzimet për mënjanimin e objektit ose të një pjese të tij dhe shpenzimet për pastrimin e terrenit, i bart pronari i objektit.

### **Neni 100-a**

(1) Me mënjanim të objektit apo të një pjese të tij në pajtim me nenin 99 dhe nenin 99-a të këtij ligji, pushojnë e drejta e pronësisë, nënformat e të drejtës së pronësisë (bashkëpronësisë dhe pronësisë së përbashkët), të drejtat tjera reale, si dhe të drejtat dhe faktet tjera regjistrimi i të cilave përcaktohet me ligj.

(2) Me kërkesë të organit kompetent nga neni 58 i këtij ligji, me të cilën bashkëngjitet leja e plotfuqishme për mënjanim të objektit apo të pjesës së tij dhe elaborati gjeodezik për regjistrim të ndryshimeve në librin publik për regjistrim të të drejtave të patundshmërive, organi kompetent për udhëheqje të librit publik për regjistrim të të drejtave të patundshmërive, do t'i shlyejë të drejtat e regjistruara nga paragrafi (1) i këtij neni nga kadastra e patundshmërive.

## Neni 101

Për rikonstruktim, rikonstruktim me mënjanimin dhe adaptim me ridedikim, si dhe për mënjanimin e ndërtimeve të cilat ndodhen në hapësirë të rrethuar për nevojat e mbrojtjes, nuk nevojitet leja.

### Neni 101-a

(1) Organet kompetente nga neni 58 i këtij ligji janë të obliguara që procedurat për miratimin e projektit ideor, për ndryshime gjatë ndërtimit, për ndryshimin e investuesit, për lëshimin e lejes për punët përgatitore, për lëshimin e aktvendimit për ndërtesat nga neni 73 i këtij ligji, për rikonstruktim, ridedikim, adaptim dhe për lëshimin e lejes për përdorimin për ndërtim nga kategoria e parë nga neni 57 i këtij ligji, t'i realizojnë në mënyrë elektronike.

(2) Mënyrën e zbatimit të procedurave nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni organet kompetente nga neni 58 paragrafi (3) i këtij ligji, procedurat për miratimin e projektit-ideor, për ndryshime gjatë ndërtimit, për ndërrim të investitorit, për lëshimin e licencës për punë përgatitore, për lëshimin e aktvendimit për objektet nga neni 73 të këtij ligji, për rikonstruktim, ridedikim, adaptim dhe për lëshim të lejes për shfrytëzim për objektet në zonat zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe nga personat juridikë, të cilat i ndërtojnë qiramarrësit dhe pronarët e tokës në zonat zhvillimore teknologjike industriale, (përveç për objektet infrastrukturore në suazat e zonës, të cilat i ndërtojnë subjektet-dhënës të shërbimeve publike të cilat janë kompetentë për ndërtimin e infrastrukturës elektroenergjetike, të ujësjellësit, kanalizimit, gazpërçuesit dhe telekomunikimit), për ndërtimet në zonat e lira shëndetësore, si dhe për objektet në zonat industriale dhe të gjelbra të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë të cilat i ndërtojnë pronarët e tokës në zonat industriale dhe të gjelbra, i zbatojnë në formë të shkruar.

## IX. ODA E ARKITEKTËVE TË AUTORIZUAR DHE INXHINIERËVE TË AUTORIZUAR

### Neni 102

(1) Oda e Arkitektëve të autorizuar dhe Inxhinierëve të Autorizuar (në tekstin e mëtejshëm: Oda) i përfaqëson, harmonizon dhe mbron interesat e arkitektëve dhe inxhinierëve të autorizuar, dhe i mbron interesat e personave të tretë, gjatë kryerjes së punëve nga ana e arkitektëve dhe inxhinierëve të autorizuar.

(2) Të drejtën e shfrytëzimit të emrit profesional arkitekt dhe inxhinier i autorizuar, e fiton me marrjen e autorizimit në pajtim me këtë ligj dhe me regjistrimin në Listën emërore të Odës.

### Neni 103

(1) Oda është e pavarur, profesionale, joprofitabile dhe organizatë e pavarur, me cilësi të personit juridik.

(2) Selia e Odës, ndodhet në Shkup.

(3) Oda e ka vulën e vet, shenjën, stemën dhe vulën e thatë.

(4) Oda regjistrohet në regjistrin tregtar.

(5) Puna e Odës është publike, me ç'rast transparenca e punës së Odës sigurohet nëpërmjet informimit të përhershëm të anëtarëve për punën e Odës, në mënyrë të përcaktuar me Statutin e Odës.

## **Neni 104**

(1) Oda kryen autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj dhe për të njëjtat mban evidencë.

(2) Autorizimet publike nga paragrafi (1) i këtij neni, përbëhen në nxjerrjen e akteve të cilat janë dokumente publike, si vijon:

1) autorizim për projektim, revizion të dokumentacionit projektues, mbikëqyrje të ndërtimit për ndërtime dhe për udhëheqjen me ndërtimin, për ndërtimet nga neni 57 të këtij ligji;

2) vërtetimi për autorizimin e arkitektit ose të inxhinierit të huaj të autorizuar për punët e projektimit, revizionit të projekteve, mbikëqyrjes mbi ndërtimin për ndërtimet nga neni 57 të këtij ligji dhe për udhëheqje me ndërtimin e ndërtimit dhe

3) nostrifikimi i projekteve të përpiluara jashtë vendit.

## **Neni 105**

(1) Mbikëqyrjen e kryerjes së autorizimeve publike nga neni 104 të këtij ligji, e kryen organi i administratës shtetërore, kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës nëpërmjet:

- paraqitjes së materialeve të caktuara dhe të metave procedurale në punën e Odës,
- dhënies së rekomandimeve për zbatimin konsekuent të dispozitave ligjore, në pjesën e realizimit të autorizimeve publike dhe
- dhënies së mendimit dhe ndihmës profesionale.

(2) Nëse Oda nuk i mënjanon të metat nga paragrafi (1) alineja 1 e këtij neni, ose në përgjithësi nuk i kryen kompetencat e veta në pajtim me këtë ligj më tepër se gjashtë muaj, ato u hiqen ose u kufizohen nga ana e organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës. Kompetencat e hequra dhe/ose të kufizuara, kryen organi kompetent për kryerjen punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, në emër dhe për llogari të Odës, më së shumti një vit nga dita e marrjes përkatësisht kufizimit të tyre.

(3) Për kryerjen e autorizimeve publike, Oda i parashtron raport vjetor organit për administratë shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullit të hapësirës.

## **Neni 106**

Anëtarët e Odës, i realizojnë interesat e tyre në Odë, drejtpërdrejt në seksione profesionale dhe indirekt nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvendin e Odës, si dhe nëpërmjet formave të tjera të organizimit, në pajtim me Statutin e Odës (në tekstin e mëtutjeshëm: Statuti).

## **1. Organet e Odës**

### **Neni 107**

(1) Organet e Odës janë Kuvendi, Këshilli drejtues, Këshilli mbikëqyrës dhe kryetari dhe nënkryetari i Odës.

(2) Kryetari i Odës, nënkryetari i Odës, anëtarët e Këshillit drejtues dhe anëtarët e Këshillit mbikëqyrës, janë me mandat prej katër vjetësh me të drejtë të rizgjedhjes.

### **Neni 108**

(1) Kuvendi i Odës, është organi më i lartë i Odës.

(2) Kuvendin e Odës e përbëjnë përfaqësues të seksioneve profesionale të Odës, të cilët janë zgjedhur nga anëtarët e Odës.

(3) Kryesuesi i Kuvendit dhe zëvendësi i tij, zgjidhen nga radhët e përfaqësuesve nga paragrafi (2) i këtij neni, me mandat prej dy vjetësh. Funkzioni kryesues i Kuvendit, nuk përputhet me çfarëdo qoftë funksioni tjetër në Odë.

(4) Në Kuvend duhet të sigurohet përfaqësim adekuat i seksioneve profesionale, sipas numrit të anëtarëve të seksioneve.

(5) Kuvendi i Odës mban mbledhje, së paku një herë në vit, ndërsa kryesuesi i Kuvendit është i obliguar që ta caktojë mbledhjen e Kuvendit, për zgjidhjen urgjente të çështjeve të caktuara me kërkesë me shkrim, nga:

- Kryetari i Odës,
- nënkryetari i Odës,
- Këshilli drejtues,
- një seksion i Odës dhe
- së paku një e katërta e anëtarëve të përgjithshëm të Odës.

(6) Kryesuesi është i obliguar që mbledhjen ta caktojë në afat prej 20 ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni.

(7) Kuvendi i Odës mund të punojë, nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të përfaqësuesve nga paragrafi (2) i këtij neni, me ç'rast vendimet miratohen me shumicë votash nga përfaqësuesit e pranishëm.

### **Neni 109**

Kuvendi i Odës, i kryen punët si vijon:

- 1) miraton Statut dhe akte tjera të përgjithshme të verifikuara me këtë ligj dhe Statutin;
- 2) miraton raport vjetor për punën për vitin e kaluar dhe miraton program për punë në vitin e ardhshëm;
- 3) miraton llogari vjetore dhe plan për zbatimin e llogarisë;
- 4) e verifikon shumën e anëtarësisë;
- 5) e zgjedh kryetarin e Odës, nënkryetarin e Odës, anëtarët e Këshillit drejtues dhe anëtarët e Këshillit mbikëqyrës, duke pasur parasysh me këtë rast përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive;
- 6) miraton rregullore për punën e Kuvendit të Odës;
- 7) miraton listë çmimesh për shërbimet publike dhe tarifën për shërbimet e kryera;
- 8) miraton Kodeks të etikës profesionale të arkitektëve dhe inxhinierëve të autorizuar dhe
- 9) kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër dhe me Statutin.

## Neni 110

Lista e çmimeve për shërbimet publike, miratohet pas pëlqimit paraprak të dhënë nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës dhe i njëjti shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

## Neni 111

(1) Këshillin drejtues e përbëjnë kryetari dhe nënkryetari i Odës dhe udhëheqësit e seksioneve profesionale.

(2) Kryetari i Këshillit drejtues është edhe kryetar i Odës.

(3) Nënkryetari i Këshillit drejtues është edhe nënkryetari Odës.

(4) Kryetari i Këshillit drejtues, në çdo kohë mund të caktojë mbledhje të Këshillit drejtues. Kryetari i Odës është i obliguar që të caktojë mbledhje të Këshillit drejtues, për zgjidhje urgjente të çështjeve të caktuara, nëpërmjet kërkesës me shkrim nga Këshilli drejtues i Odës, kryetari i ndonjë seksioni profesional ose më pak së një e katërta e anëtarëve të Këshillit drejtues të Odës, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

## Neni 112

(1) Këshilli drejtues i Odës i kryen punët, si vijon:

1) miraton rregullore për punën e Këshillit drejtues;

2) miraton vendime nga fushëveprimi i tij;

3) i zbaton propozimet dhe konkluzionet e Kuvendit;

4) i miraton propozimet e Statutit dhe aktet tjera të cilat i miraton Kuvendi;

5) miraton rregullore për organizimin dhe sistematizimin e shërbimit profesional të Odës;

6) propozon vendime, konkluzione, qëndrime dhe jep mendime për çështjet për të cilat debaton Kuvendi dhe

7) kryen punët tjera të përcaktuara me Statut.

## Neni 113

(1) Këshillin mbikëqyrës e përbëjnë kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të cilët i zgjedh Kuvendi i Odës.

(2) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të jenë kryetari i Odës dhe anëtarët e Këshillit drejtues.

## Neni 114

Këshilli mbikëqyrës i kryen punët si vijon:

1) mbikëqyrjen ndaj zbatimit të Statutit dhe akteve tjera të përgjithshme të Odës dhe realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të Odës;

2) mbikëqyrjen e punës materiale - financiare të Odës dhe disponimin me mjetet e Odës dhe

3) mbikëqyrjen e punës së shërbimit profesional të Odës, në pajtim me Statutin dhe aktet tjera të përgjithshme.

## Neni 115

(1) Kryetarin e Odës e zgjedhin anëtarët e Kuvendit të Odës, nga radhët e seksioneve profesionale.

(2) Çdo seksion profesional mund të propozojë më së shumti një kandidat për kryetar, ndërsa për të zgjedhur konsiderohet ai kandidat që ka marrë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të Odës.

(3) Funkzioni i kryetarit të Odës është profesional.

(4) Kryetari i Odës e përfaqëson Odën, cakton mbledhje të Këshillit drejtues dhe kryeson me to, i zbaton vendimet dhe konkluzionet e Kuvendit të Odës, është përgjegjës për punën ligjore të Odës dhe ka të drejtë që të marrë pjesë në punën e mbledhjeve të seksioneve profesionale, pa të drejtë të vendosjes.

### **Neni 116**

Odën e përbëjnë seksionet profesionale, si formë themelore të lidhshmërisë profesionale dhe organizimit të anëtarëve të Odës, për avancimin e veprimtarive të caktuara.

### **Neni 117**

(1) Në Odë themelohen seksionet, si vijojnë:

- 1) Seksioni i arkitektëve;
- 2) Seksioni i inxhinierëve të ndërtimtarisë;
- 3) Seksioni i inxhinierëve të makinerisë;
- 4) Seksioni i elektroinxhinierëve;
- 5) Seksioni i inxhinierëve të gjeologjisë dhe
- 6) Seksioni i inxhinierëve të komunikacionit.

(2) Sipas nevojës, krahas seksioneve nga paragrafi (1) i këtij neni, në Odë mund të formohen edhe seksione tjera, me vendimin e Këshillit drejtues.

### **Neni 118**

(1) Me seksionin udhëheq udhëheqësi i seksionit, ndërsa në rast të mungesës së tij ose pengimit, zëvendësi i tij.

(2) Në seksionin nga paragrafi (1) i këtij neni, formohet së paku një këshill dhe sipas nevojës mund të formohen edhe më shumë këshilla.

### **Neni 119**

(1) Seksionet në mbledhjen e parë zgjedhin udhëheqës dhe zëvendës - udhëheqës nga radhët e anëtarëve të tyre.

(2) Udhëheqësi dhe zëvendësi i përgatitin, caktojnë dhe udhëheqin me mbledhjet e seksionit dhe i përfaqësojnë interesat e seksionit para Odës.

(3) Udhëheqësi i seksionit, me autorizim me shkrim nga kryetari i Odës, mund ta përfaqësojë Odën për çështje nga fushëveprimi i saj.

### **Neni 120**

Punët profesionale, administrative dhe ndihmëse dhe të tjera në Odë, i kryen shërbimi profesional i Odës me të cilin udhëheq sekretari i përgjithshëm i Odës.

## **2. Aktet e Odës**

### **Neni 121**

Me Statutin më për së afërmi, rregullohen:

- 1) organizimi i Odës;
- 2) të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Odës;
- 3) prezantimi dhe përfaqësimi i Odës;
- 4) transparenca në punë;
- 5) procedura për miratimin e akteve të përgjithshme dhe të veçanta;
- 6) procedura për regjistrimin e librave të emrave të Odës;
- 7) pezullimi dhe ndërprerja e anëtarësimit në Odë;
- 8) mënyra e mbajtjes së listave emërore;
- 9) të drejtat dhe obligimet e arkitektëve dhe inxhinierëve të autorizuar;
- 10) procedura disiplinore për përcaktimin e shkeljes së detyrës dhe autoritetit, nga ana e arkitektëve dhe inxhinierëve të autorizuar;
- 11) masat disiplinore;
- 12) trupat për ngritjen dhe mbajtjen e procedurës disiplinore;
- 13) organizimi i shërbimit profesional të Odës dhe
- 14) çështje të tjera me rëndësi për Odën.

## **Neni 122**

Me Kodeksin e etikës profesionale rregullohen parimet, rregullat dhe obligimet, të cilave anëtarët janë të obliguar t'u përmbahen.

## **Neni 123**

(1) Oda mban listë emërore të:

- 1) arkitektëve të autorizuar;
- 2) inxhinierëve të autorizuar;
- 3) byrosë (personale ose të përbashkët) dhe
- 4) shoqërive projektuese.

(2) Lista emërore nga paragrafi (1) i këtij neni, është libër publik. Ekstrakti i dhënë në bazë të të dhënave nga lista emërore është dokument publik.

(3) Lista emërore nga paragrafi (1) i këtij neni, shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

## **3. Procedura e regjistrimit në listën emërore**

### **Neni 124**

(1) Arkitektët e autorizuar dhe inxhinierët e autorizuar të drejtën për anëtarë të Odës e fitojnë me regjistrimin në Listën emërore të arkitektëve të autorizuar dhe Listën emërore të inxhinierëve të autorizuar.

(2) Të drejtën e regjistrimit në Listën emërore të arkitektëve të autorizuar dhe Listën emërore të inxhinierëve të autorizuar, e ka personi që i plotëson kushtet si vijojnë:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe
- 2) të ketë autorizim në pajtim me këtë ligj.

(3) Kërkesa për regjistrim në Listat emërore nga paragrafi (1) i këtij neni, i dorëzohet Këshillit drejtues të Odës.

(4) Regjistrimi në Listën emërore nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet në bazë të aktvendimit të cilin e miraton Këshilli drejtues i Odës.

(5) Kërkesa për regjistrim në listën adekuate emërore refuzohet me aktvendim, nëse personi i cili ka parashtruar kërkesë nuk i plotëson kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni.

(6) Ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, mund t'i parashtrohet Komisionit për zgjidhjen e ankesave në shkallë të dytë pranë Odës, anëtarët e të cilit i emëron Kuvendi i Odës.

(7) Kërkesa e re për regjistrim mund të parashtrohet së paku tre muaj nga dita e miratimit të aktvendimit, me të cilin është refuzuar kërkesa për regjistrim në listën emërore adekuate.

#### **4. Sigurimi nga përgjegjësia dhe financimi**

##### **Neni 125**

(1) Oda e kryen sigurimin e obliguar të përgjegjësisë, si sigurim kolektiv.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, arkitekti i autorizuar, përkatësisht inxhinieri i autorizuar individualisht mund të sigurohet nga përgjegjësia, për dëmin të cilin mund t'ua shkaktojë personave të tretë, nëse Oda jep pëlqim.

##### **Neni 126**

Mjetet për zbatimin e punëve në kompetencë të Odës, sigurohen nga:

- kompensimi për autorizim,
- kompensimi nga anëtarësia,
- kompensimi nga nostrifikimi,
- donacionet dhe
- burime tjera, të përcaktuara me ligj.

### **X. MBIKËQYRJA**

##### **Neni 127**

Mbikëqyrjen ndaj zbatimit të këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji, e kryen organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullit të hapësirës.

#### **1. Mbikëqyrja inspektuese**

##### **Neni 128**

(1) Punët e mbikëqyrjes inspektuese ndaj zbatimit të këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji, i kryejnë inspektorët e ndërtimtarisë të Inspektoratit shtetëror për ndërtimtari dhe urbanizëm (në tekstin e mëtejshëm: inspektorët e ndërtimtarisë dhe inspektorët ndërtimorë të komunave dhe të komunave në Qytetin e Shkupit (në tekstin e mëtejshëm - inspektorët e autorizuar të ndërtimtarisë).

(2) Inspektori i ndërtimtarisë kryen e mbikëqyrjen inspektuese të ndërtimeve të kategorisë së parë, ndërsa inspektori i autorizuar për ndërtimtari kryen mbikëqyrje inspektuese ndaj ndërtimeve të kategorisë së dytë nga neni 57 të këtij ligji.

(3) Inspektorët nga paragrafi (1) i këtij neni kryejnë mbikëqyrje inspektuese edhe në pajtim me dispozitat nga Ligji për ndalim dhe pengim të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar.

##### **Neni 128-a**



Inspektorati shtetëror për ndërtimtari dhe urbanizëm ka cilësi të personit juridik me llogari personale buxhetore si shfrytëzues buxhetor i linjës së parë, në mënyrë të mëvetësishme zbaton procedura për punësim në pajtim me ligjin dhe vendos për të drejtat dhe obligimet për marrëdhënie pune.

### **Neni 128-b**

(1) Me Inspektoratin Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm udhëheq drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Për emërim të drejtorit publikohet shpallje publike në tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(3) Drejtor mund të emërohet personi i cili i plotëson këto kushte:

1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;

2) në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion i kundërvajtjes ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;

3) ka marrë së paku 300 kredi sipas SETK ose ka të mbaruar shkallën VII/1;

4) ka së paku pesë vjet përvojë pune;

5) posedon njërën nga certifikatat ose dëshmitë vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,

- IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,

- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),

- FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,

- BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë,

6) ka të dhëne testin psikologjik dhe testin për integritet.

### **Neni 129**

(1) Inspektori ndërtimor dhe inspektori i autorizuar ndërtimor kanë legjitimacion zyrtar.

(2) Legjitimacionin zyrtar nga paragrafi (1) të këtij neni për inspektorin ndërtimor e lëshon drejtori i inspektoratit, kurse për inspektorin ndërtimor të autorizuar e lëshon kryetari i komunës respektivisht komunës në qytetin e Shkupit.

(3) Legjitimacioni zyrtar ka vlefshmëri prej gjashtë viteve.

(4) Pas kalimit të vlefshmërisë inspektori ndërtimor është i obliguar t'ia kthejë legjitimacionin drejtorit të inspektoratit kurse inspektori i autorizuar ndërtimor kryetarit të komunës respektivisht komunave në qytetin e Shkupit, të cilat janë të obliguar të lëshojnë të ri.

(5) Formën dhe përmbajtjen e formularëve të legjitimacionit nga paragrafi (1) të këtij neni, mënyrën e lëshimit të tij, heqjen dhe pamjen e shenjës, për inspektorin ndërtimor, me propozim të drejtorit të Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, kurse për inspektorin e autorizuar

ndërtimor i përcakton kryetari i komunës respektivisht komunës së qytetit të Shkupit.

## Neni 130

Inspektor i ndërtimit mund të jetë personi, i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- është i moshës madhore,
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- nuk i është shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka fituar së paku 300 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/1 nga sfera e arkitekturës apo ndërtimtarisë që dëshmohet me certifikatë,
- ka pesë vjet përvojë pune në sferën e arkitekturës ose ndërtimtarisë,
- i plotëson kushtet tjera të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës,
- posedon certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë, edhe atë një prej këtyre në vijim:
  - 1) Certiport: IC3 GS4 Key Applications – të dhënë;
  - 2) Microsoft: MOS Word ose MOS Excell – të dhënë ose
  - 3) ECDL: Core – të dhënë,
- ka marrë mendim pozitiv për përshtatshmëri për vendin e punës përmes dhënies së tekstit psikologjik dhe testit për integritet, në pajtim me rregullat të cilat kanë të bëjnë me nëpunësit shtetërorë dhe
- ka licencë për inspektor nga sfera e kompetencës së shërbimit inspektues.

(2) Inspektor i autorizuar i ndërtimtarisë emërohet personi me arsim të lartë të kryer arkitekt - inxhinier ose inxhinier i ndërtimtarisë, së paku me dy vite përvojë pune në profesion.

## Neni 130-a

(1) Drejtori i Inspektoratit shtetëror për ndërtimtarin dhe urbanizëm përpilon propozim-program vjetor për punë të inspektoratit dhe atë e dorëzon te Këshilli Inspektues më së voni deri më 31 tetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(2) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtarin dhe Urbanizëm, e miraton programin vjetor për punë të inspektoratit në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të pëlqimit nga paragrafi (3) i këtij neni, respektivisht, më së voni deri më 10 dhjetor të vitit rrjedhës nëse Këshilli inspektues nuk e shqyrton dhe nuk dorëzon pëlqim, respektivisht vërejtje në afatin e paraparë në paragrafin (3) të këtij neni.

(3) Në bazë të programit të miratuar vjetor, drejtori i Inspektoratit shtetëror për ndërtimtarin dhe urbanizëm përpilon plane tremujore për punën e çdo inspektori, të cilat bashkërisht i dorëzon për shqyrtim te Këshilli Inspektues më së voni dy javë para fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik edhe atë deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë nga viti i ardhshëm, deri më 15 mars për tremujorin e dytë, deri më 15 qershor për tremujorin e tretë, respektivisht deri më 15 shtator për tremujorin e katërt të vitit rrjedhës.

(4) Në planet tremujore për punë për çdo inspektor, drejtori detyrimisht e fut numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara për tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e ndërlikueshmërisë së secilës prej mbikëqyrjeve.

(5) Në bazë të planeve tremujore për punën e çdo inspektori, drejtori i Inspektoratit shtetëror për ndërtimtarin dhe urbanizëm përpilon plan mujor

për punë, plan i cili përmban edhe orar të mbikëqyrjeve sipas datës dhe sipas subjekteve të mbikëqyrjes.

(6) Drejtori i Inspektoratit shtetëror për ndërtimtari dhe urbanizëm, më së voni dy javë pas fillimit të tremujorit kalendarik rrjedhës për atë paraprak, te Këshilli inspektues dorëzon raporte përmbledhëse tremujore për punën e çdo inspektori, edhe atë deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit paraprak, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për tremujorin e dytë, respektivisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

(7) Drejtori i Inspektoratit shtetëror për ndërtimtari dhe urbanizëm, më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës, te Këshilli inspektues dorëzon raport vjetor për punën e inspektoratit për vitin paraprak.

## **Neni 130-b**

Kryetari i komunës e miraton programin vjetor për punën e shërbimit inspektues më së voni deri më 15 dhjetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

## **2. Të drejtat dhe obligimet e inspektorit të ndërtimtarisë**

### **Neni 131**

(1) Inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër, ka të drejtë të kryejë mbikëqyrje inspektuese gjatë ndërtimit, si dhe mbikëqyrje inspektuese të objektit kur në të kryhet ridedikimi i elementeve konstruktive në aspekt të rezistencës së tyre mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike, si dhe gjatë ridedikimit nga lokal banesor në lokal afarist dhe anasjelltas.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të kërkojë pjesëmarrjen e personit të autorizuar zyrtar nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, për shkak të mbrojtjes së tij.

(3) Pjesëmarrësit në ndërtim janë të obliguar që inspektorit të ndërtimtarisë, përkatësisht inspektorit të autorizuar të ndërtimtarisë, t'i mundësojnë zbatimin e papenguar të mbikëqyrjes inspektues dhe t'ia japin për shikim dokumentacionin, që ka të bëjë me ndërtimin që është lëndë e mbikëqyrjes.

(4) Inspektori i ndërtimtarisë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, kontrollon nëse inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë i kryen punët në pajtim me këtë ligj. Organet kompetente të komunave janë të obliguara që me kërkesën e inspektorit të ndërtimtarisë, t'i mundësojnë ta bëjë shqyrtimin e dokumentacionit.

(5) Nëse inspektori kompetent i ndërtimit, konstaton se janë krijuar disa nga kushtet për heqjen e licencës të parapara në nenin 38 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji dhe për heqjen e autorizimit të parapara në nenin 39 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji, detyrohet të paraqesë propozim për heqjen e licencës, përkatësisht autorizimit me procesverbal për parregullsinë e konstatuar, në organin kompetent për heqjen e licencës, përkatësisht autorizimit.

## Neni 131-a

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i ndërtimit, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimit konstaton se realizuesi nuk ka siguruar dëshmi për prejardhjen e gurit ndërtimor teknik, rërës ndërtimore dhe zhavorrit, detyrohet që për këtë ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror për Inspeksion Teknik dhe të veprojë në pajtim me nenin 164 të këtij ligji.

## Neni 131-b

(1) Inspektori i ndërtimtarisë përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë është i detyruar që të kryejë mbikëqyrje inspektuese dhe të konstatojë nëse pronarët e objekteve me dedikim publik kanë të siguruar hapësirë parkingu për biçikleta.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i ndërtimtarisë përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë konstaton se pronarët e objekteve me dedikim publik nuk kanë siguruar hapësirë parkingu për biçikleta, i njëjti është i detyruar të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

## Neni 132

(1) Për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i ndërtimtarisë përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë, mban ditar.

(2) Mënyrën dhe përmbajtjen e mbajtjes së ditarit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(3) Në zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i ndërtimtarisë përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë, ka të drejtë dhe obligim që të kontrollojë se pjesëmarrësit në ndërtim a kanë autorizime dhe licenca, si dhe të urdhërojnë mënjanimin e parregullsive, mënjanimin e dëmtimeve, ndërprerjen e ndërtimit, mënjanimin e ndërtimit, mbylljen e kantierit të ndërtimit, shënimin e ndërtimit për të rrezikshëm si dhe të ndërmarrin punë tjera, me qëllim që të ndërpritet ndërtimi, nëse ndërtimi kryhet në kundërshtim me këtë ligj.

(4) Inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht personi i autorizuar i ndërtimtarisë, procedurën e mbikëqyrjes inspektuese e ngrit dhe udhëheq me detyrë zyrtare, si dhe me iniciativë të cilitdo qoftë person, në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën të përgjithshme administrative.

(5) Në procedurën për zbatimin e akteve ekzekutive administrative të veçanta, inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht personi i autorizuar i ndërtimtarisë ka të drejtë që të kërkojë asistencë nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, për mbrojtjen e tij personale.

(6) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë, konstaton parregullsi e cila në pajtim me këtë ligj paraqet kundërvajtje, përkatësisht me ligj të veçantë është përcaktuar si vepër penale, ngrit procedurë për kundërvajtje ose procedurë penale.

## Procedura për edukim

## Neni 132-a

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit, inspektori ndërtimor përkatësisht inspektori i autorizuar ndërtimor, vërteton se është kryer parregullsi nga nenet 150 paragrafi (1) pika 4, 151 paragrafi (1) pika 3, 156-a paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe 156-b paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, është i obliguar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta konstatojë parregullsinë e kryer me vërejtje për mënjanim të parregullsisë së konstatuar në afatin e përcaktuar dhe me dorëzimin e njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit apo subjektit ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit.

(2) Inspektori kompetent i ndërtimit detyrohet që të zbatojë procedurë për edukim edhe nëse konstaton parregullsi nga neni 162 i këtij ligji, e afati për mënjanimin e parregullsisë në këtë rast është gjashtë muaj.

(3) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit e përcakton ministri kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(4) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, përkatësisht komuna në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e realizimit të mbikëqyrjes së inspektimit.

(5) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta apo të ngjashme për një apo më shumë subjekte.

(6) Nëse në terminin e caktuar personi apo subjekti mbi të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(7) Nëse personi apo subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe i njëjti e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e konstatuar.

(8) Nëse inspektori ndërtimor përkatësisht inspektori i autorizuar ndërtimor gjatë realizimit të kontrollit mbikëqyrës vërteton se janë larguar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndalon procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(9) Nëse inspektori ndërtimor përkatësisht inspektori i autorizuar ndërtimor gjatë realizimit të kontrollit mbikëqyrës, vërteton se nuk janë larguar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

(10) Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, përkatësisht komuna mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri kompetent për kryerjen e punëve për rregullimin e hapësirës.

## Neni 132-b

Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm përkatësisht komuna, për kontrollet e kryera përgatit raporte tremujore dhe i publikon në ueb faqen e saj.

## 3. Ndërprerja e ndërtimit

### Neni 133

(1) Inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë me aktvendim do t'i urdhërojë investuesit që ta ndërpresë ndërtimin e mëtejshëm, nëse konfirmon se:

- ndërtimi ka filluar me lejen për ndërtim, e cila në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, është ndërprerë për realizim,
- investuesi nuk vepron në pajtim me nenin 67, paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji,
- ndërtimin e kryen personi juridik, pa licencë përkatësisht personi fizik pa autorizim, të paraparë me këtë ligj;
- ndërtimi ose një pjesë e tij, ndërtohet në kundërshtim me lejen për ndërtim ose në të kundërshtim me projektin themelor të verifikuar,
- ka parregullsi gjatë ndërtimit, të cilat mund ta rrezikojnë realizimin e kërkesave themelore për ndërtimin dhe
- me ndërtimin rrezikohet siguria e ndërtimeve përreth ose stabiliteti i tokës përreth.

(2) Me aktvendimin nga paragrafi (1) të këtij neni, inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë, do të caktojë afat për harmonizimin de ndërtimit, përkatësisht gjendjes së ndërtimit, me dispozitat e këtij ligji.

(3) Në rast të ndërprerjes së ndërtimit, për ndërtesën e cila është regjistruar në Regjistrin nacional për trashëgimi kulturore, inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë, do ta njoftojë organin e administratës shtetërore, kompetent për realizimin e punëve nga sfera e kulturës.

## **4. Mënjanimi i ndërtimit**

### **Neni 134**

(1) Inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë me aktvendim do t'i urdhërojë investuesit për mënjanimin e ndërtimit, përkatësisht të një pjese të tij, nëse:

- ndërtohet ose është ndërtuar pa lejen për ndërtim, nga neni 59 të këtij ligji,
- nëse ndërtimi nuk harmonizohet me dispozitat e këtij ligji, pas skadimit të afatit të harmonizimit të dhënë në aktvendimin për ndërprerjen e ndërtimit, nga neni 133 të këtij ligj,
- ndërtohet edhe përkundër asaj që është miratuar aktvendimi për ndërprerjen e ndërtimit, nga neni 133 të këtij ligji,
- ndërtohet ose është ndërtuar në kundërshtim me lejen ose projektin themelor të vërtetuar,
- gjatë ndërtimit verifikohen parregullsi për shkak të së cilave janë çrregulluar kërkesat themelore të ndërtimit, lidhur me rezistencën mekanike, stabilitetin, mbrojtjen sizmike dhe kualitetin e materialeve të montuara dhe
- ndërtimi kryhet me leje për ndërtim, e cila nuk është e përfundimtare në procedurën administrative.

(2) Inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë me aktvendim do t'i urdhërojë kryerësit mënjanimin e ndërtimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse nuk vepron në pajtim me nenin 72 paragrafi (6) të këtij ligji.

(3) Në rast të mënjanimit të ndërtimit i cili është regjistruar në Regjistrin nacional të trashëgimisë kulturore, inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë, do të kërkojë pëlqim organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i kulturës.

(4) Nëse inspektori i autorizuar i ndërtimit konstaton se pronari i pjesës së posaçme të objektit, banesës ose pjesës së banesës, ka kryer ridedikim pa leje për ridedikim nga neni 97 paragrafi (3) i këtij ligji, do të miratojë aktvendim me të cilin do ta ngarkojë pronarin që ta kthejë pjesën e posaçme të ndërtimit, banesën apo pjesën e banesës në gjendjen fillestare.

## **Neni 135**

Inspektori i ndërtimitarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimitarisë me aktvendim do t'i urdhërojë investuesit, mënjanimin e:

- ndërtimit të përkohshëm nëse nuk është mënjanuar në afatin e paraparë,
- ndërtimin e ndërtuar në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë, nëse nuk është mënjanuar në afatin e paraparë, në pajtim me këtë ligj,
- ndërtimeve dhe pajisjeve nga neni 73 të këtij ligji të cilat janë kryer, përkatësisht vendosur pa aktvendim për kryerje përkatësisht vendosje,
- objekt të përkohshëm të vendosur në tokën ndërtimore me akt të organit kompetent, për realizimin e programit vjetor nga neni 79 të këtij ligji dhe për vendosjen e pajisjes urbane nga neni 80 të këtij ligji,
- objekt të përkohshëm të vendosur në tokën ndërtimore me akt të organit kompetent, nëse ka skaduar afati për vendosjen e tij të përcaktuar në akt,
- objektit të përkohshëm të vendosur në truall ndërtimor, me akt të organit kompetent, për shkak të realizimit të planit urbanistik dhe
- objektit të përkohshëm dhe pajisjes urbanistike të vendosur me leje për vendosje, në pajtim me nenin 81 të këtij ligji, pas skadimit të afatit për mënjanimin e përcaktuar në lejen për vendosje.

## **Neni 135-a**

(1) Nëse inspektori i autorizuar ndërtimor vërteton se pajisja urbane - tarraca me apo pa strehë dhe banaqe të mbuluara apo të pambuluara, është vendosur pa leje për vendosjen e pajisjes urbane, miraton aktvendim për largimin e së njëjtës dhe në afat prej tri ditësh do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(2) Nëse inspektori i autorizuar vërteton se pajisja urbane - tarraca me apo pa strehë dhe banaqe të mbuluara apo të pambuluara, është vendosur në kundërshtim me lejen për vendosjen e pajisjes urbane, miraton aktvendim me të cilin do ta obligojë personin të cilit i është dhënë leja, që në afat prej tri ditësh nga pranimi i aktvendimit, pajisja e vendosur urbane të harmonizohet me lejen e lëshuar dhe do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(3) Ankesa e parashtuar kundër aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk e shtyn zbatimin e aktvendimit.

(4) Nëse personi i cili ka vendosur pajisje urbane pa leje apo në kundërshtim me lejen, nuk vepron sipas aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, përkatësisht nuk e largon pajisjen urbane në afatin e përcaktuar, largimin e pajisjes do ta kryejë nga inspektori i autorizuar në llogari të personit i cili e ka vendosur pajisjen urbane. Për largimin e pajisjes inspektori i autorizuar do ta informojë organin kompetent i cili e ka lëshuar lejen, me ç'rast organi kompetent është i obliguar që të njëjtën ta anulojë.

(5) Organi kompetent nuk ka do të lëshojë leje për vendosjen e pajisjes urbane në rastet nga paragrafi (4) të këtij neni, për periudhën prej së paku gjashtë muajsh nga dita e anulimit të lejes, përkatësisht nga dita e largimit të pajisjes së vendosur pa leje.

## Neni 135-b

(1) Nëse inspektori i autorizuar i ndërtimit, përkatësisht inspektori i ndërtimit konstaton se pajisja urbane - panotë reklamuese dhe informative, si dhe panotë reklamuese informative që vendosen në objekte në pajtim me nenin 74 të këtij ligji, janë vendosur pa leje për vendosjen e pajisjes urbane, përkatësisht pa aktvendim për vendosje, miraton aktvendim për mënjanimin e tyre dhe në afat prej tri ditësh do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(2) Ankesa e paraqitur kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

## 5. Mbyllja e kantierit të ndërtimit

### Neni 136

(1) Në rastet e neneve 134 dhe 135 të këtij ligji, inspektori i ndërtimitarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimitarisë para marrjes së aktvendimit, në vendngjarje do të urdhërojë mbylljen e kantierit të ndërtimit, përkatësisht të një pjese të tij dhe do të vendosë shenjë zyrtare të veçantë.

(2) Mënyrën e mbylljes dhe shënimit të kantiereve të mbyllura të ndërtimit, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit të hapësirës.

(3) Inspektori i ndërtimitarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimitarisë nga kantieri i ndërtimit, do ta mënjanojë shenjën zyrtare nga paragrafi (1) i këtij neni, kur investuesi do të veprojë sipas aktvendimit, përkatësisht kur do ta harmonizojë ndërtimin në pajtim me këtë ligj.

(4) Nëse ndërtuesi vazhdon me ndërtimin pas mbylljes së kantierit të ndërtimit dhe shënimit me shenjë të veçantë zyrtare për pengimin e ndërtimit të mëtejshëm, aktvendimin do ta zbatojë inspektori i ndërtimitarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimitarisë me ndihmën e organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme.

## 6. Aktvendimi i inspektorit

### Neni 137

(1) Varësisht nga gjendja e konstatuar inspektori i ndërtimitarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar i ndërtimitarisë, do të përpilojë procesverbal, në bazë të të cilit miraton aktvendim.

(2) Kundër aktvendimit të inspektorit të ndërtimit, si dhe kundër konkluzionit me të cilin lejohet zbatim, konkluzionit për ndërprerjen e procedurës, si dhe konkluzionit për shpenzimet e kryerjes së procedurës mund të paraqitet ankesë në "Komisioni Shtetëror për Vendosje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse.

(3) Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të ndërtimit dhe aktvendimit të inspektorit komunal të Qytetit të Shkupit si dhe kundër konkluzionit me të cilin lejohet zbatimi, konkluzionit për ndërprerjen e procedurës si dhe konkluzionit për shpenzimet e zbatimit të procedurës



mund të paraqitet ankesë në "Komisioni Shtetëror për Vendosje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse.

(4) Ankesa e parashtruar kundër aktvendimit të inspektorit të ndërtimtarisë, përkatësisht inspektorit të autorizuar të ndërtimtarisë, nuk e shtyn zbatimin e aktvendimit.

(5) Kryetari i Komisionit nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, vendimin për ankesë duhet ta miratojë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

### **Neni 138**

*I shfuqizuar* 15

### **Neni 139**

(1) Në aktvendimin e nenit 137 të këtij ligji, inspektori i ndërtimtarisë, përkatësisht inspektori i autorizuar për ndërtim, mund të shqiptojë edhe ndalimin e ndërtimit dhe shfrytëzimin e objektit me mbylljen e kantierit të ndërtimit.

(2) Ndalimi për ndërtim dhe shfrytëzim, shpallet në tabelën e shpalljeve të organit i cili e mban procedurën dhe shpallet së paku në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e pjesëtarëve të bashkësive etnike.

(3) Me shqiptimin e ndalimit, kryerësi përkatësisht investuesi është i detyruar që ta mbyllë kantierin e ndërtimit dhe qasjen në objekt, në mënyrë të përcaktuar nga inspektori, në të kundërtën aktvendimi është bazë për zbatimin e veprimit të cilin mund ta kryejë vetëm debitori në procedurë para përmbauesit në pajtim me Ligjin për përmbaues, si dhe përmbaues për zbrazen e patundshmërisë, sendeve dhe personave të cilët do të hasen në procedurën për përmbauesin me detyrim sipas aktvendimit të inspektorit të ndërtimtarisë, përkatësisht inspektorit të autorizuar të ndërtimtarisë, ose përmbauesin për plotësimin e veprimit të cilin mund ta plotësojë personi i tretë në vend të debitorit. Për qasje në përmbauesin me detyrim, inspektori miraton konkluzion për qasje në përmbaues, kundër të cilit lejohet ankesë e veçantë. Ankesa nuk e shtyn përmbauesin e konkluzionit. Aktvendimi i inspektorit është dokument përmbaues.

### **Neni 140**

*I shfuqizuar* 16

### **Neni 141**

Aktvendimi i inspektorit të ndërtimtarisë, posaçërisht duhet të përmbajë:

- numrin dhe datën e miratimit,
- shenjën nga ditari i inspektorit të ndërtimtarisë,
- të dhëna për ndërtuesin, investuesin, realizuesin dhe poseduesin e ndërtimit,
- përshkrimin dhe kategorinë e ndërtimit, përkatësisht pjesën e ndërtimit e cila nuk ndërtohet në pajtim me lejen e ndërtimit, projektin dhe aktvendimin për kushtet e lokacionit,
- numrin, datën dhe organin i cili e ka dhënë lejen për ndërtim, nëse e atillë është dhënë;
- të dhënat përshkuese dhe hapësinore për truallin në të cilin ndërtohet (numri i kadastrës së parcelës, komuna e kadastrës, sipërfaqja dhe statusi juridik), me paraqitjen e bazës juridike me të cilën rregullohen

marrëdhëniet ndërmjet pronarit të truallit, kryerësit dhe investuesit,

- afatin dhe udhëzimin për eliminimin e parregullsive,
- pasqyrën e të drejtave të shënuara në Librin publik, deri në momentin e miratimit të aktvendimit,
- urdhëresën për regjistrimin e të drejtës së pengut në Librin publik,
- urdhëresën në lidhje me shpalljen e aktvendimit në tabelën e shpalljeve dhe gazetatat ditore,
- shqiptimin e ndalesës nga neni 138 dhe/ose nga neni 139 të këtij ligji,
- përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve për mënjanimin e ndërtimit, përkatësisht në pjesët që ndërtohen pa leje për ndërtim dhe përcaktimin e lartësisë së penaleve, për secilën ditë vonese,
- arsyetimin dhe
- këshillën juridike dhe të dhëna të tjera, në pajtim me ligjin.

## Neni 142

(1) Procedura për zbatimin e aktvendimit, fillon me parashtrimin e konkluzionit palës, me të cilën lejohet zbatimi i tij.

(2) Nëse përmbaruesi nuk vepron sipas aktvendimit nga neni 137 të këtij ligji, për ndërtime nga kategoria e parë nga neni 57 të këtij ligji, aktvendimin do ta zbatojë dhe do ta realizojë ekzekutimin administrativ inspektori i ndërtimtarisë, kurse për ndërtimet e kategorisë së dytë si dhe për ndërtime dhe pajisje nga neni 73 i këtij ligji, objekte të përkohshme dhe pajisje urbane, inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë, në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër.

## Neni 143

(1) Shpenzimet për zbatimin e aktvendimit të inspektorit të ndërtimtarisë për ndërtime të kategorisë së parë, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, ndërsa e aktvendimit të inspektorit të autorizuar të ndërtimtarisë për ndërtime të kategorisë së dytë si dhe për ndërtime dhe pajisje nga neni 73 i këtij ligji, objekte të përkohshme dhe pajisje urbane nga buxhetet e komunave, përkatësisht të komunave në Qytetin e Shkupit.

(2) Shpenzimet e bëra për zbatimin e aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, kompensohen nga përmbaruesi, në pajtim me ligjin dhe nuk mund të jenë më të larta se shpenzimet reale.

## Neni 144

(1) Inspektori i ndërtimtarisë kur do të konstatojë se komuna nuk ka autorizuar inspektor të ndërtimtarisë për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, përpilon procesverbal të cilin ia parashtron ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, me propozim për marrjen e autorizimit për kryerjen e punëve me kompetencë të inspektorit të autorizuar të ndërtimtarisë. Procesverbali së bashku me propozimin i parashtrohet edhe kryetarit të komunës, përkatësisht kryetarit të komunës në Qytetin e Shkupit. Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, në bazë të propozimit mund të lëshojë autorizim për kryerjen e punëve në kompetencë të inspektorit të autorizuar të ndërtimtarisë.

(2) Nëse në komunë nuk ka inspektor të autorizuar të ndërtimtarisë për kryerjen e punëve të mbikëqyrjes inspektuese, kryetari i komunës mund t'i parashtrorë propozim Inspektoratit shtetëror për ndërtimtarin dhe urbanizëm, për kryerjen e punëve të mbikëqyrjes inspektuese në komunë.

Pas marrjes së propozimit, inspektori i ndërtimtarisë vepron në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Kryerjen e punëve të mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i ndërtimtarisë i realizon deri në autorizimin e inspektorit komunal të ndërtimtarisë, por jo më shumë se një vit.

(4) Punët nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, inspektori i ndërtimtarisë i kryen për llogari të komunës dhe janë në llogari të Buxhetit të komunës, ndërsa për shpenzimet për punët e kryera organi i administratës shtetërore kompetent për punët e rregullimit të hapësirës, i parashtron njoftim organit të administratës shtetërore, kompetent për çështje financiare.

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e financave pas njoftimit të marrë nga paragrafi (4) i këtij neni, të ardhurat e komunës, përkatësisht të komunave në rajonin e Qytetit të Shkupit në bazë të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, në lartësi të shpenzimeve të bëra, i ridedikon në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

## **7. Ndërmarrja e punëve nga ana e inspektorit të ndërtimtarisë**

### **Neni 145**

(1) Nëse inspektori i ndërtimtarisë vërteton se inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë nuk i kryen punët e përcaktuara me këtë ligj, është i obliguar që menjëherë t'i japë sqarim me shkrim kryetarit të komunës për moskryerjen e punëve.

(2) Nëse inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë nuk i kryen punët për të cilët është i autorizuar në pajtim me këtë ligj, në afat prej shtatë ditësh nga dita e parashtrimit të sqarimit nga paragrafi (1) të këtij neni, inspektori i ndërtimtarisë përpilon procesverbal i cili nga ana e inspektorit shtetëror të ndërtimtarisë dhe urbanizmit, i parashtrohet ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, me propozim për ndërmarrjen e punëve nga kompetenca e inspektorit të autorizuar të ndërtimtarisë për lëndën konkrete për të cilën është konstatuar moskryerja e punëve. Procesverbali së bashku me propozimin i parashtrohen edhe kryetarit të komunës, përkatësisht kryetarit të komunave në Qytetin e Shkupit.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, në bazë të propozimit miraton aktvendim për ndërmarrjen e punëve për lëndën konkrete për të cilën është konstatuar moskryerja e punëve i cili i parashtrohet kryetarit të komunës, përkatësisht kryetarit të komunës së Qytetit të Shkupit.

(4) Kryerjen e punëve të ndërmarra nga inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë, inspektori i ndërtimtarisë i kryen deri në përfundimin e tyre.

(5) Punët nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori i ndërtimtarisë i kryen në llogari të komunës dhe janë në llogari të Buxhetit të komunës, ndërsa për harxhimet për punët e kryera organi i administratës shtetërore kompetent për punët e rregullimit hapësinor, i parashtron njoftim organit të administratës shtetërore, kompetent për punët financiare.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e financave pas njoftimit të marrë nga paragrafi (5) i këtij neni, të ardhurat e komunës, përkatësisht të komunave në rajonin e Qytetit të Shkupit në bazë të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, në lartësi të shpenzimeve të bëra, i ridedikon në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

## **Neni 146**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët nga neni 128 të këtij ligji janë të obliguar të kontrollojnë nëse aktet administrative të dhëna në bazë të këtij ligji, janë në pajtim me të njëjtin dhe nëse vërtetojnë se aktet administrative janë dhënë në kundërshtim me këtë ligj, janë të detyruar që t'i parashirojnë propozim me shkrim për shlyerjen e atyre akteve administrative me procesverbal për gjendjen e konstatuar, organit që i ka miratuar.

(2) Organi kompetent i cili e ka miratuar aktin administrativ, është i obliguar që të veprojë sipas propozimit dhe në afat prej tetë ditësh të miratojë aktvendim, me të cilin do ta shlyejë aktin e dhënë administrativ ose aktvendim me të cilin do ta refuzojë propozimin për shlyerje.

## **8. Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, përkatësisht organeve të komunave në Qytetin e Shkupit**

### **Neni 147**

Mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, përkatësisht organeve të komunave në Qytetin e Shkupit, e kryen organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, për çështje nga kompetenca e tyre të cilat i përkasin kryerjes së ndërtimit të kategorisë së dytë nga neni 57 të këtij ligji.

### **Neni 148**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, përkatësisht organeve të komunave në Qytetin e Shkupit, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, i kryen punët vijuese:

1) e ndjek ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, përkatësisht organeve të komunave në Qytetin e Shkupit dhe ndërmerr masa, aktivitete dhe jep iniciativë për realizimin e kompetencave të komunës që i përkasin ndërtimit;

2) u sqaron organeve komunale, përkatësisht organeve të komunave në Qytetin e Shkupit në tejkalimin e kompetencave të tyre, të përcaktuara me këtë ligj dhe propozon masa adekuate për tejkalimin e gjendjes së atillë;

3) paralajmëron për mangësi materiale dhe procedurale të caktuara në punën e organeve të komunës, përkatësisht organeve të komunave në Qytetin e Shkupit, të cilat do të mund ta pamundësojnë kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, të cilat janë në interes publik me rëndësi lokale;

4) jep sugjerime për zbatim konsekuent të kompetencave të komunës për punët që duhet t'i kryejë në pajtim me këtë ligj, kurse me kërkesën e organeve të komunës, përkatësisht organeve të komunave në Qytetin e Shkupit;

5) e ndjek miratimin në kohë të akteve të komunës, të përcaktuara me këtë ligj;

- 6) u parashtrohet iniciativa dhe propozime organeve të komunës, përkatësisht organeve të komunave në Qytetin e Shkupit, nëse konstatohet moszbatimi i këtij ligji si rezultat (pasojë) e ndeshjes së kompetencave ndërmjet tyre;
- 7) e ndjek ligjshmërinë e aktvendimeve që organet e komunës, përkatësisht organet e komunave në Qytetin e Shkupit, i miratojnë në zgjidhjen e çështjeve administrative për të drejta, obligime dhe interesa të personave juridikë dhe fizikë, të miratuara në bazë të këtij ligji dhe ndërmerr masa në pajtim me ligjin;
- 8) jep mendim dhe ndihmë profesionale me kërkesën e organeve të komunës, përkatësisht të organeve të komunave në Qytetin e Shkupit, për propozim - aktet që dalin nga ky ligj;
- 9) e ndjek zbatimin e transparencës në punën e organeve të komunës, përkatësisht të organeve të komunave në Qytetin e Shkupit në aspektin e njoftimit të rregullt, në kohë, të vërtetë dhe të plotë të qytetarëve, për çështjet e përcaktuara me këtë ligj dhe
- 10) në kohë i njofton organet e komunës, përkatësisht organet e komunave në Qytetin e Shkupit për gjendjet e konstatuara në punën e tyre, përkatësisht për punët që i përkasin ndërtimtarisë dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(2) Për masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, i informon organet e komunës, përkatësisht organet e komunave në Qytetin e Shkupit.

(3) Nëse edhe përpos sqarimeve dhe masave dhe aktiviteteve të ndërmarra, organet e komunës, përkatësisht organet e komunave në Qytetin e Shkupit, nuk e sigurojnë kryerjen e punëve nga paragrafi (1) të këtij neni, ndërmerret kryerja e punëve adekuate.

(4) Kryerjen e punëve të ndërmarra e ndërmerr organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, më së shumti deri në një vit nga dita e ndërmarrjes së tyre.

(5) Organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, punët e ndërmarra nga kompetencat e komunës, i kryen në emër dhe në llogari të komunës dhe për atë do t'i njoftojë organet komunale, përkatësisht organet e komunave në Qytetin e Shkupit, organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e vetadministrimit lokal.

(6) Për shpenzimet për punët e kryera nga paragrafi (4) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit hapësinor dorëzon njoftim në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e financave.

(7) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e financave pas njoftimit të marrë nga paragrafi (6) i këtij neni, të ardhurat e komunës, përkatësisht të komunave në rajonin e Qytetit të Shkupit në bazë të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, në lartësi të shpenzimeve të bëra, i ridedikon në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

## Neni 149

Kur organi kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, përkatësisht inspektori i ndërtimtarisë, do të vërtetojnë se komuna, përkatësisht inspektorët e autorizuar të ndërtimtarisë nuk i miratojnë aktet në afatet e parapara të përcaktuar me këtë ligj, do t'i

parashetrojnë propozim për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, Inspektoratit administrativ shtetëror i cili është i obliguar që të kryejë mbikëqyrje inspektuese, në pajtim me Ligjin për inspektim administrativ.

## XI. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

### 1. Kundërvajtjet e investuesit

#### Neni 150

(1) Gjobë në shumë prej 7.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - investues, nëse:

- 1) projektimin, revizionin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen mbi ndërtimin e ndërtimeve nga kategoria e parë nga neni 57 të këtij ligji ia beson personit i cili nuk i plotëson kushtet në pajtim me këtë ligj, për kryerjen e asaj veprimtarie (neni 13 paragrafi (2));
- 2) për udhëheqës të ndërtimit e cakton personin pa licencë (neni 14 paragrafi (2))
- 3) nuk e kryen ndërtimin, nga kategoria e parë nga neni 57 të këtij ligji në afatin e përcaktuar me këtë ligj (neni 68),
- 4) me shkrim nuk e paraqet fillimin e ndërtimit të ndërtimeve nga kategoria e parë nga neni 57 të këtij ligji (neni 67 paragrafi (1)) dhe
- 5) për ndërtimet nga kategoria e parë nga neni 57 të këtij ligji, nuk ndërmerr masa për sigurim (nenet 82 dhe 83).

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit fizik investues.

#### Neni 151

(1) Gjobë me shumë prej 4.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - investitorit, nëse:

- 1) projektimin, revizionin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të ndërtimeve nga kategoria e dytë nga neni 57 të këtij ligji, ia ngarkon personit i cili nuk i plotëson kushtet në pajtim me këtë ligj për kryerjen e kësaj veprimtarie (neni 13 paragrafi (2));
- 2) nuk e përfundon ndërtimin e kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji në afatin e përcaktuar me këtë ligj (neni 68 paragrafi (2) pika 3);
- 3) me shkrim nuk e paraqet fillimin e ndërtimit të ndërtesave nga kategoria e dytë nga neni 57 të këtij ligji (neni 67 paragrafi (1)) dhe
- 4) për ndërtimet nga kategoria e dytë nga neni 57 të këtij ligji, nuk ndërmerr masa për sigurim (nenet 82 dhe 83).

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit fizik - investitorit.

#### Neni 151-a

(1) Gjobë në shumë prej 9.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik investues, nëse nuk siguron shënim të ndërtimit të projektuar në terren në pajtim me nenin 82 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 2.500 deri 4.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit fizik - investues.

### **Neni 151-b**

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik - investues nëse pas rikonstruktimit të konsiderueshëm të kryer të objektit për të cilin zbatohet Rregullorja për karakteristika energjetike të ndërtesave, nuk siguron certifikatë për karakteristika energjetike të ndërtesës të lëshuar nga tregtari individ apo personi juridik që posedon licencë për kryerje të kontrollit energjetik në pajtim me nenin 97-a të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit fizik - investues.

## **2. Kundërvajtjet e personit juridik për projektimin e ndërtimeve dhe të projektuesit**

### **Neni 152**

(1) Gjobë në shumë prej 7.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për projektimin e ndërtimeve, nëse:

- 1) kryen punë të projektimit pa licencë për projektim (neni 16 paragrafi (1));
- 2) punëson si projektues person fizik të huaj, pa autorizim të vërtetuar nga Oda (neni 42 paragrafi (4)) dhe
- 3) përpilon përkatësisht vërteton dokumentacion të projektit në kundërshtim me dispozitat ligjore.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 152-a**

(1) Gjobë në shumë prej 21.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për projektim të ndërtimeve nëse ndërtimi nuk është projektuar në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 153**

Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje projektuesit, nëse:

- 1) ka përpiluar projekt pa autorizim për projektim (neni 17 paragrafi (1)) dhe
- 2) ka përpiluar projekt në kundërshtim me rregullat ligjore.

### **Neni 153-a**

Gjobë në shumë prej 6.500 deri 10.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje projektuesit nëse ndërtimi nuk është projektuar në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji.

## **3. Kundërvajtjet e personit juridik për kryerjen e revizionit dhe të reviduesit**

### **Neni 154**

(1) Gjobë në shumë prej 7.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për kryerjen e revizionit në dokumentacionin e projektit, nëse:

- 1) e kryen revizionin e projekteve pa pasur licencë për kryerjen e revizionit të dokumentacionit projektues (neni 23 paragrafi (1));
- 2) punëson si revident person fizik të huaj, pa autorizim të vërtetuar nga Oda (neni 42 paragrafi (4)) dhe
- 3) përpilon përkatësisht vërteton raport të revizionit të dokumentacionit të projektit në kundërshtim me dispozitat ligjore.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 154-a**

(1) Gjobë në shumë prej 21.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për kryerjen e revizionit të dokumentacionit të projektit nëse revidenti gjatë kryerjes së revizionit ka verifikuar projekt, i cili nuk është përpiluar në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 155**

Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje reviduesit, nëse:

- 1) ka bërë revizion pa pasur autorizim për revizion të dokumentacionit projektues (neni 24 paragrafi (1));
- 2) ka bërë revizion në dokumentacionin projektues, të përpiluar nga personi juridik në të cilin është i punësuar (neni 20 paragrafi (3)) dhe
- 3) ka bërë revizion në kundërshtim me rregullat ligjore.

### **Neni 155-a**

Gjobë në shumë prej 6.500 deri 10.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje revidentit, nëse gjatë kryerjes së revizionit



ka verifikuar projekt, i cili nuk është përpiluar në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji.

#### **4. Kundërvajtjet e personit juridik - realizues dhe të inxhinierit për realizim**

##### **Neni 156**

(1) Gjobë në shumë prej 9.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik realizues, nëse:

- 1) realizon ndërtime pa licencë përkatëse për realizues (neni 26 paragrafi (1));
- 2) nuk ndërton në pajtim me lejen e ndërtimit, projektin e reviduar themelor dhe realizues (neni 29 paragrafi (1) alineja 2);
- 4) nuk siguron dëshmi për kualitet të përcaktuar për prodhimet ndërtimore të ndërtuara (neni 29 paragrafi (1) alineja 4);
- 5) në kantier të ndërtimit nuk zbaton masa për mbrojtje dhe siguri, në pajtim me ligjin (neni 29 paragrafi (1) alineja 5);
- 7) nuk cakton inxhinier për realizimin e kantierit të ndërtimit (neni 30);
- 8) nuk siguron shënim të ndërtimit të projektuar në terren (neni 82);
- 7) nuk e rrethon, përkatësisht nuk e mbron kantierin e ndërtimit (neni 83 paragrafët (1) dhe (2)).
- 8) punëson si inxhinier të realizimit person fizik të huaj, pa autorizim të vërtetuar nga Oda (neni 42 paragrafi (4)).

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 2.500 deri 4.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet inxhinierit të realizimit për kundërvajtje nga paragrafi (1) pikat 2, 3, 4, 6 dhe 7 të këtij neni.

##### **Neni 156-a**

(1) Gjobë në shumë prej 7.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik realizues, nëse gjatë realizimit të ndërtimeve nga kategoria e parë nga neni 57 të këtij ligji:

- 1) nuk mban ditar për ndërtimet dhe libër për ndërtimet, për punët e realizuara ndërtimore (neni 29 paragrafi (1) alineja 3);
- 2) nuk e shënon me tabelë informative kantierin e ndërtimit (neni 83 paragrafi (3));
- 3) përkohësisht uzurpon për nevojat e kantierit ndërtimor sipërfaqe publike të komunikacionit, pa leje (neni 84);
- 4) nuk i largon nga kantieri i ndërtimit materialet e paharxhuara ndërtimore dhe të tjera, hedhurinat dhe ngjashëm (neni 85 paragrafi (2)) dhe
- 5) në kantierin e ndërtimit nuk e ka dokumentacionin nga neni 86 të këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet inxhinierit për realizim për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

##### **Neni 156-b**

(1) Gjobë në shumë prej 4.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik realizues, nëse gjatë realizimit të ndërtimeve nga kategoria e dytë nga neni 57 të këtij ligji:

1) nuk mban ditar për ndërtimet dhe libër për ndërtimet për realizimin e punëve ndërtimore (neni 29 paragrafi (1) alineja 3);

2) nuk e shënon me tabelë informative kantierin ndërtimor (neni 83 paragrafi (3));

3) përkohësisht uzurpon për nevojat e kantierit ndërtimor sipërfaqe publike të komunikacionit, pa leje (neni 84);

4) nuk i largon nga kantieri i ndërtimit materialet ndërtimore të paharxhuara dhe të tjera, hedhurinat dhe ngjashëm (neni 85 paragrafi (2)) dhe

5) në kantierin e ndërtimit nuk e ka dokumentacionin nga neni 86 të këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet inxhinierit për realizim për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

### **Neni 156-v**

(1) Gjobë në shumë prej 17.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik realizues, nëse gjatë realizimit të ndërtimeve nuk siguron dëshmi për prejardhjen e gurit ndërtimor teknik, rërës ndërtimore dhe zhavorrit (neni 29 paragrafi (1) alineja 6).

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 156-g**

Gjobë në shumë prej 5.000 deri 8.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje inxhinierit të realizimit, nëse gjatë realizimit të ndërtimeve nuk siguron dëshmi për prejardhjen e gurit ndërtimor teknik, rërës ndërtimore dhe zhavorrit (neni 29 paragrafi (1) alineja 6).

### **Neni 156-gj 17**

(1) Gjobë në shumë prej 17.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik realizues, nëse ndërtimin e realizon në kundërshtim me projektin e reviduar themelor, të përpiluar në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 5.000 deri 8.500 euro në kundërvlere me denarë do t'i shqiptohet inxhinierit për realizim për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

### **Neni 156-e**

(1) Gjobë në shumë prej 17.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik realizues, nëse gjatë realizimit

të ndërtesave nuk siguron mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës gjatë ndërtimit dhe mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës pas ndërtimit të tërë sistemit konstruktiv të ndërtesës (neni 29 paragrafi (1) alineja 7).

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 156-zh**

Gjobë në shumë prej 5.000 deri 8.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje inxhinierit për realizim, nëse gjatë realizimit të ndërtesave nuk siguron mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës gjatë ndërtimit dhe mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës pas ndërtimit të tërë sistemit konstruktiv të ndërtesës (neni 29 paragrafi (1) alineja 7).

### **Neni 157**

Gjobë në shumë prej 2.500 deri 4.500 në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet inxhinierit për kundërvajtje nëse udhëheq me ndërtimin e ndërtimit pa pasur autorizim për inxhinier për realizim në pajtim me nenin 31 paragrafi (1) të këtij ligji.

## **5. Kundërvajtja e personit juridik për kryerjen e mbikëqyrjes dhe e inxhinierit të mbikëqyrjes**

### **Neni 158**

(1) Gjobë në shumë prej 9.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për kryerjen e mbikëqyrjes, nëse:

- 1) kryen mbikëqyrje pa licencë për kryerje të mbikëqyrjes (neni 34 paragrafi (1)),
- 2) përgatit raport për kontrollin e kryer teknik, në kundërshtim me dispozitat nga neni 90 paragrafi (3) dhe paragrafi (4) dhe nenet 90-b dhe 90-v të këtij ligji;
- 3) vepron në kundërshtim me nenin 36-a të këtij ligji;
- 4) punëson si inxhinier mbikëqyrës person të huaj fizik, pa autorizim të vërtetuar nga Oda (neni 42 paragrafi (4)) dhe
- 5) inxhinieri mbikëqyrës nuk ka vepruar në pajtim me nenin 36 dhe neni 90 - a të këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 159**

Gjobë në shumë prej 2.500 deri 4.500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje inxhinierit mbikëqyrës, nëse:

- 1) kryen mbikëqyrje pa autorizim për inxhinier mbikëqyrës (neni 35 paragrafi (1));
- 2) vepron në kundërshtim me nenin 36 - a të këtij ligji;
- 3) përgatit raport për kontrollin e kryer teknik, në kundërshtim me dispozitat nga neni 90 paragrafi (3) dhe paragrafi (4) dhe nenet 90-b dhe

90-v të këtij ligji dhe

4) nuk ka vepruar në pajtim me nenin 36 dhe neni 90 - a të këtij ligji.

## **5.1 Kundërvajtje e subjektit i cili kryen veprimtari shkencore-hulumtuese-institut shkencor i specializuar në sferën e mbrojtjes së ndërtesave nga ndikime sizmike**

### **Neni 159-a**

(1) Gjobë në shumë prej 17.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje subjektit i cili kryen veprimtari shkencore-hulumtuese institut shkencor i specializuar në sferën e mbrojtjes së ndërtesave nga ndikimet sizmike, nëse përpilon mendim për shkallën e projektuar dhe mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes së ndërtesës në kundërshtim me rregullat për rezistencë mekanike, stabilitet dhe mbrojtje sizmike të ndërtesës.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në subjektin i cili kryen veprimtari shkencore hulumtueseinstituti shkencor i specializuar në sferën e mbrojtjes së ndërtimeve nga ndikimet sizmike.

(3) Gjobë në shumë prej 5.000 deri 8.500 në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të punësuar në subjektin i cili kryen veprimtari shkencore-hulumtuese – institut shkencor i specializuar në sferën e mbrojtjes së ndërtesave nga ndikimet sizmike, nëse përpilon mendim për shkallën e projektuar dhe mendim për shkallën e realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes së ndërtesës në kundërshtim me rregullat për rezistencë mekanike, stabilitet dhe mbrojtje sizmike të ndërtesës.

## **5.2 Kundërvajtje e pjesëmarrësit në ndërtim për shkak të moskthimit të licencës dhe autorizimit**

### **Neni 159-b**

(1) Gjobë në shumë nga 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse nuk e kthen licencën e hequr në afatin e përcaktuar në nenin 38 paragrafi (8) të këtij ligji.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 159-v**

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik nëse nuk e kthen autorizimin e hequr në afatin e përcaktuar në nenin 39 paragrafi (8) të këtij ligji.

## **6. Kundërvajtjet për moszbatimin e aktvendimit të inspektorit ndërtimor**

### **Nen 160**

(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - investues dhe realizuesit, nëse vazhdojnë me ndërtimin e ndërtimeve nga kategoria e parë nga neni 57 të këtij ligji dhe realizimin e punëve të ndara, në rastet kur është miratuar aktvendimi për ndërprerjen e ndërtimit (neni 133 paragrafi (1)) edhe pas mbylljes së kantierit të ndërtimit (neni 136 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet personit fizik investues, për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik në ndërtimin e ndërtimeve nga kategoria e parë nga neni 57 i këtij ligji, nëse e pengon mbikëqyrjen inspektuese ose nuk mundëson këqyrje në dokumentacion (neni 131 paragrafi (3)).

(4) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni edhe për personin përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 160-a**

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - investitorit dhe realizuesit nëse vazhdojnë me ndërtimin e ndërtimeve nga kategoria e dytë të nenit 57 të këtij ligji dhe realizimi i punëve të ndara në rastet kur është miratuar vendimi për ndërprerjen e ndërtimit (neni 133 paragrafi (1)) edhe pas mbylljes së kantierit të ndërtimit (neni 136 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 600 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personi fizik - investitorit, për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik në këtij ligji, nëse e pengon mbikëqyrjen inspektuese ose nuk mundëson këqyrje në dokumentacion (neni 131 paragrafi (3)).

(4) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.7. Kundërvajtjet e pronarit të objektit

### **Neni 161**

(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik pronar i objektit, nëse:

- 1) e përdor objektin ose pjesën e tij pa leje për përdorim (neni 93 paragrafi (1));
- 2) e fshirë **18**
- 3) për udhëheqës të mirëmbajtjes cakton person pa licencë (neni 98 paragrafi (3)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet personit fizik pronar i objektit, për kundërvajtje nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni.

(3) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe

personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 161-a**

(1) Gjobë në shumë prej 7.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik edhe tregtarit individ, nëse vendos pajisje urbane - tarraca me ose pa strehë dhe banakë të mbuluar ose pa mbuluar, pa leje për vendosjen e pajisjes urbane ose në kundërshtim me lejen për vendosjen e pajisjes urbane.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përcaktuar për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik dhe personi përgjegjës në tregtar individ.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik, për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

### **Neni 161-b**

(1) Gjobë në shumë prej 7.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse vendos pajisje urbane - pano reklamuese dhe informative, si dhe pano reklamuese dhe informative që vendosen në objekte në pajtim me nenin 74 të këtij ligji, pa leje për vendosje të pajisjes urbane, përkatësisht pa aktvendim për vendosje.

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përllogaritur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 6.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet bashkësisë së pronarëve të banesave për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

### **Neni 161-v**

(1) Gjobë në shumë prej 12.000 euro në kundërvlerë me denarin do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik pronar i objektit nëse bën ridedikimin e pjesës së veçantë të objektit, banesës ose pjesë së banesës, pa leje të lëshuar për ridedikim (neni 97 paragrafët (2) dhe (3)). **19**

(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përllogaritur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 3.500 deri 6.000 euro në kundërvlerë me denarin do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

### **Neni 162**

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik pronar i objektit, nëse nuk vepron në pajtim me nenin 171 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri më 500 euro me vlerë kundër në denarë, do t'i shqiptohet personit fizik pronar i objektit, për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përlogaritur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 162-a**

(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik pronar i objektit, nëse mënjanon objekt të ndërtuar pa leje për mënjanim (neni 99-a i këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik pronar i objektit për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përlogaritur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 162-b**

(1) Gjobë në shumë prej 15.000 euro në kundërvlerë me denarin do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - pronar i objektit me dedikim publik nëse nuk vepron në pajtim me nenin 170 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarin do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - pronar i objektit me dedikim publik nëse nuk vepron në pajtim me nenin 11-b të këtij ligji.

(3) Gjobë në lartësi prej 30% nga dënimi i përlogaritur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

## **8. Kundërvajtjet e personave përgjegjës dhe zyrtarë**

### **Neni 163**

(1) Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar në organin kompetent të nenit 58 të këtij ligji, nëse në afatin e përcaktuar me ligj nuk lëshon leje për ndërtim, nuk miraton aktvendim për ndryshime gjatë ndërtimit, nuk miraton aktvendim për ndryshimin e investuesit, nuk lëshon leje për punë përgatitore, nuk miraton aktvendim për realizimin e ndërtimit gjegjësisht vendosjen e pajisjes nga neni 73 të këtij ligji, nuk lëshon leje për përdorim për ndërtimet e kategorisë së parë nga neni 57 të këtij ligji, nuk miraton aktvendim për ridedikim ose rikonstruktiv ose përshtatje dhe nuk lëshon leje për mënjanimin e objektit.

(2) Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës dhe personit zyrtar në organin kompetent për dhënien e lejes për ndërtim, nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin 146 paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje inspektuesin kompetent ndërtimor, nëse nuk i kryen punët e mbikëqyrjes inspektuese, të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës dhe inspektorit kompetent ndërtimor, nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin 142 të këtij ligji.

(5) Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës dhe personit zyrtar në njësinë e vetadministrimit lokal, si dhe në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, nëse në procedurën për lëshimin e lejes për ndërtim veprojnë në kundërshtim me nenin 59 paragrafi (16) të këtij ligji dhe nëse lëshojnë leje për ndërtim me formë dhe përmbajtje që nuk është në pajtim me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në pajtim me nenin 62 paragrafi (5) të këtij ligji.

(6) Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës dhe personit zyrtar në njësinë e vetadministrimit lokal, nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin 92 - a paragrafi (3) të këtij ligji.

(7) Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës dhe personit zyrtar në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin 96 paragrafi (2) të këtij ligji, përkatësisht personit përgjegjës dhe personit zyrtar në njësinë e vetadministrimit lokal, nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin 96 paragrafi (3) të këtij ligji.

(8) Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 6.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës dhe personit zyrtar në organin kompetent për lëshimin e lejes për ndërtim, nëse lëshon leje për ndërtim në bazë të projektit të përpiluar themelor në kundërshtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji.

(9) Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës dhe personit zyrtar në organin kompetent nga neni 58 i këtij ligji, nëse vepron në kundërshtim me nenin 59-e paragrafi (1) të këtij ligji.

(10) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës dhe personit zyrtar në organin kompetent për lëshimin e lejes për ndërtim, nëse kërkesat përkatësisht fletëparaqitjet për parashënimin dhe shënimin e ndërtesës, për ndryshimet gjatë ndërtimit si dhe për regjistrim të objektit në librin publik për patundshmëri nuk i dorëzon te Agjencia për kadastër të patundshmërive në formë elektronike.

(11) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar dhe kryetarit të komunës në qytetin e Shkupit si dhe personit zyrtar dhe kryetarit të qytetit të Shkupit, nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin neni 59-zh paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji.

(12) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtarë në organin kompetent për dhënien e lejes për ndërtim, nëse në procedurën për dhënien e lejes për ndërtim, verifikon projekt themelore ndërsa nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 59-z të këtij ligji.

(13) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtarë në subjektin kompetent



për infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit, nëse në procedurën e përcaktuar në nenin 59-v të këtij ligji kërkon investitori të dorëzojë kushte hidroteknike për kyçje të objektit të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, në kundërshtim me nenin 59-v paragrafi (3) të këtij ligji.

### **Neni 163-a**

Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në komunë nëse gjatë ndërtimit të sipërfaqeve publike-vendkalimeve të këmbësorëve të reja dhe gjatë rikonstruktimit të sipërfaqeve publike vendkalimeve ekzistuese në qendër të qytetit dhe në parqe, nuk vepron në pajtim me nenin 11 paragrafi (3) të këtij ligji.

### **Neni 163-b**

(1) Organ kompetent për zbatimin e procedurës për kundërvajtje për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj është gjykata kompetente, përveç për kundërvajtjet e caktuara në nenin 151-b paragrafi (3) i këtij ligji, neni 160-a paragrafi (2) i këtij ligji dhe neni 162 paragrafi (2) i këtij ligji, për të cilat organ kompetent është komisioni për kundërvajtje i formuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(2) Kundër aktvendimit të komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në Komisionin shtetëror për vendosje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës për kundërvajtje, në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

### **Neni 164**

Kur inspektori mbikëqyrës nga paragrafi 128 i këtij ligji, përkatësisht organi kompetent për kryerje të punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, do të vërtetojnë se është bërë kundërvajtje e paraparë me këtë ligj, do të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente përkatësisht organ për kundërvajtje.

(2) Kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente mund të paraqesë edhe personi me invaliditet, nëse konstaton se objekti i ndërtuar me dedikim publik nuk i përmbush kushtet për qasje të papenguar të personave me invaliditet, të përcaktuara me këtë ligj përkatësisht organ për kundërvajtje. 20

### **Neni 165**

(1) Para parashtrimin të kërkesës për ngritje të procedurës, para gjykatës kompetente do të zbatohet procedurë për barazim. Nëse kryerësi e pranon kundërvajtjen, inspektori kompetent nga neni 128 i këtij ligji, do t'i japë kryerësit urdhër pagesë për kundërvajtje për pagesën e gjobës së paraparë për kundërvajtjen. Me nënshkrimin e urdhër pagesës për kundërvajtje, konsiderohet se kryerësi i kundërvajtjes pajtohet që ta paguajë gjobën e paraparë.

(2) Kryerësi i kundërvajtjeve nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar ta paguajë gjobën në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të urdhër pagesës për kundërvajtje. në llogari të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, të shënuar në urdhër pagesë për kundërvajtje., 21 përkatësisht në llogari të komunës kompetente. Kryerësi do të paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar, nëse pagesën e bën në afat prej tetë ditësh.

(3) Nëse kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar në paragrafin (2) të këtij neni, inspektori mbikëqyrës do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, para gjykatës kompetente.

(4) Inspektorët kompetentë nga neni 128 mbajnë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara për kundërvajtje dhe për rezultatin e procedurave të filluara.

(5) Në evidencën e paragrafit (4) të këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimin, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i mandat-urdhër pagesës që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(6) Të dhënat personale nga paragrafi (5) i këtij neni ruhen pesë vite nga dita e futjes në evidencën.

(7) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e rregullimit të hapësirës.

### **Neni 165-a**

Përlllogaritja e lartësisë së gjobës për personin juridik dhe tregtarin individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

## **XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 166**

Procedurat e filluara për dhënien e lejes për ndërtim dhe të lejes për përdorim, do të vazhdojnë sipas dispozitave që kanë vlejtur deri në ditën e zbatimit të këtij ligji.

### **Neni 167**

(1) Dispozitat më të afërta të përcaktuara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në miratimin e dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, do të zbatohen dispozitat ekzistuese nënligjore.

### **Neni 168**

Licencat dhe autorizimet e lëshuara në pajtim me Ligjin për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 51/2005, 82/2008 dhe 106/2008), vazhdojnë të vlejné për periudhën për të cilin janë lëshuar.

### **Neni 169**

Projektet kryesore për ndërtime dhe komplekse të infrastrukturës nga neni 57 të këtij ligji që janë përpiluar dhe reviduar, si dhe projektet kryesore për ndërtime dhe komplekse të infrastrukturës nga neni 57 i këtij ligji, ndërtimi i të cilave ka filluar deri më 30 qershor 2005, konsiderohen si projekte themelore në pajtim me këtë ligj.

## Neni 170

Pronarët e objekteve të ndërtuara me dedikim publik dhe afarist, detyrohen që t'i përmbushin kushtet për qasje të papenguar të personave me invaliditet të përcaktuara me këtë ligj, më së voni deri më 1 shtator 2015, ndërsa shkallët në hapësirën e jashtme të dedikuara për përdorim publik, në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 171

Pronarët e objekteve të ndërtuara të cilat janë pa fasadë, janë të obliguar që në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të ndërtojnë fasadë.

## Neni 172

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 51/2005, 82/2008 dhe 106/2008).

## Neni 173

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë, nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### **DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERË**

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 130/2009 dhe 124/2010):

#### **Neni 37**

Procedurat për dhënien e lejes për përdorim për objektet nga kategoria e tretë, katërt dhe pestë, të filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse nuk është kryer kontrolli teknik i ndërtimit, do të vazhdojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

#### **Neni 38**

Aktet nënligjore të këtij ligji, do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 130/2009; 18/2011 dhe 25/2013):

#### **Neni 76**

Licenca A për projektim, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar, dhe me të mund të bëhet projektimi i ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, ndërsa Licenca B për projektim e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar, dhe me të mund të bëhet projektimi i ndërtimeve të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji.

Licenca A për revizion të dokumentacionit të projektit, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar dhe me të mund të kryhet revizioni i dokumentacionit të projektit për ndërtime të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, ndërsa Licenca B për revizion të dokumentacionit të

projektit, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar dhe me të mund të kryhet revizioni i dokumentacionit të projektit për ndërtime të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji.

Licenca A për realizues dhe Licenca B për realizues, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar dhe me të mund të bëhet realizimi i ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, ndërsa Licenca C për realizues dhe Licenca D për realizues, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar dhe me të mund të bëhet realizimi i ndërtimeve të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji.

Licenca A për mbikëqyrje dhe Licenca B për mbikëqyrje, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar dhe me të mund të kryhet mbikëqyrje mbi ndërtimin e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, ndërsa Licenca C për mbikëqyrje dhe Licenca D për mbikëqyrje, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar dhe me të mund të kryhet mbikëqyrje mbi ndërtimin e ndërtimeve të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji.

#### **Neni 77**

Licenca E për realizues, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar.

Bartësi i licencës E për realizues, në periudhën e vlefshmërisë së Licencës E, mund të parashtojë kërkesë për marrjen e Licencës A për realizues ose Licencës B për realizues, në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, pa pagesën e kompensimit.

Licenca A për realizues ose Licenca B për realizues nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk lëshohet nëse kërkuesi paraprakisht nuk e kthen Licencën E për realizues.

#### **Neni 78**

Autorizimi A për projektim, Autorizimi A për revizion të dokumentacionit të projektit, Autorizimi A për inxhinier për realizim dhe Autorizimi A për inxhinier mbikëqyrës, i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar dhe me të mund të kryhet projektimi, revizioni i dokumentacionit të projektit, administrimi me ndërtime dhe mbikëqyrja mbi ndërtimin e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, ndërsa Autorizimi B për projektim, Autorizimi B për revizion të dokumentacionit të projektit, Autorizimi B për inxhinier për realizim dhe Autorizimi B për inxhinier mbikëqyrës, i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të vlejë deri në skadimin e afatit për të cilin është lëshuar dhe me të mund të kryhet projektimi, revizioni i dokumentacionit të projektit, administrimi me ndërtime dhe mbikëqyrja mbi ndërtimin e ndërtimeve të kategorisë së dytë nga neni 57 i këtij ligji.

#### **Neni 79**

Personat juridikë për projektim, revizion, realizim dhe mbikëqyrje të ndërtimit, detyrohen që të garantojnë sigurim për përgjegjësi për dëm në kompani të sigurimit

në Republikën e Maqedonisë, më së voni në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

#### **Neni 80**

Procedurat për marrjen e licencave të filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Procedurat për lëshimin e lejes për ndërtim të filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e ligjit sipas të cilit ato kanë filluar.

#### **Neni 81**

Nëse për ndërtime infrastrukturore në linjë ka projekt të përpiluar kryesor, përkatësisht projekt themelor, i cili është reviduar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, në procedurën për marrjen e lejes për ndërtim nuk dorëzohet projekti për infrastrukturë.

#### **Neni 82**

Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, komunat, komunat në Qytetin e Shkupit, detyrohen që nga 1 qershor 2013 procedurën për marrjen e lejes për ndërtim ta realizojnë në mënyrë elektronike.

#### **Neni 83**

Rregulla nga neni 59-e i këtij ligji, do të miratohet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 36/2011):

#### **Neni 3**

Dokumentacioni i planit urbanistik lokal dhe shtetëror me të cilët rregullohet shfrytëzimi i hapësirës në përfshirjen e planit, e që janë miratuar deri më 7 shkurt 2011, përdoren në procedurën e dhënies së lejes për ndërtim dhe në pajtim me të njëjtët, mund të lëshohet leje për ndërtim.

Lejet e lëshuara në pajtim me dokumentacionin e planit urbanistik lokal dhe shtetëror me të cilët rregullohet shfrytëzimi i hapësirës në përfshirjen e planit, kanë fuqi juridike dhe mund të zbatohen nëse dokumentacioni i planit urbanistik lokal dhe shtetëror janë miratuar deri më 7 shkurt 2011.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/2011):

#### **Neni 8**

Aktet nënligjore të këtij ligji do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/2011):

#### **Neni 9**

Me ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, organ kompetent për veprim për

ankesat e parashtruara kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës, përkatësisht autorizimit është Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë.

Dispozita nga neni 5 paragrafi 1 i këtij ligji, me të cilën ndryshohet neni 65 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, do të fillojë të zbatohet nga dita e fillimit të zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2012):

**Neni 15**

Dispozita e nenit 5 të këtij ligji me të cilën ndryshohet neni 87 paragrafi (5), dispozita e nenit 8 të këtij ligji me të cilën ndryshohet neni 97 paragrafi (8) dhe dispozita e nenit 10 të këtij ligji me të cilën ndryshohet neni 99 paragrafi (11), do të fillojnë të zbatohen nga dita e fillimit të zbatimit të Ligjit për themelimin të Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurës të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2012):

**Neni 16**

Projektet themelore përkatësisht kryesore për rrugë shtetërore dhe lokale që janë përpiluar dhe reviduar përfundimisht me datë 22 shkurt 2011 konsiderohen edhe si projekte infrastrukurore, nëse të njëjtat janë miratuar nga organi kompetent në pajtim me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 144/2012 dhe 25/2013):

**Neni 52**

Rregulla e përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji me të cilën shtohet neni i ri 48-b, do të miratohet në afat prej tetë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pas shpalljes së aktit nënligjor nga paragrafi (1) i këtij neni në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" i njëjti menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh shpallet në ueb faqen e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

**Neni 53**

Procedurat për marrjen e lejes për ndërtim dhe për marrjen e autorizimit të filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë sipas dispozitave të ligjit sipas të cilit kanë filluar.

**Neni 55**

Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji detyrohet që kërkesat, përkatësisht fletëparaqitjet për parashënim dhe shënim të ndërtimit, për ndryshimet gjatë ndërtimit, si dhe për regjistrim të objektit në librin publik të

patundshmërive që i dorëzon në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive, nga 1 dhjetori 2012, t'i dorëzojë në formë elektronike.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 144/2012):

**Neni 54**

Dispozita nga neni 19 i këtij ligji me të cilën në nenin 58 shtohet paragraf i ri (3), do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2013.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 25/2013):

**Neni 6**

Dispozita e nenit 55 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 144/11) nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk do të zbatohet deri më 1 qershor 2013.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2013):

**Neni 12**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, do të përpilojë listë të objekteve të ndërtuara me dedikim publik, të cilat duhet në afatin nga neni 170 i këtij Ligji, t'i përmbushin kushtet për qasje të papenguar të personave me invaliditet të përcaktuara me këtë ligj.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 137/2013):

**Neni 22**

Dispozita nga neni 20 i këtij ligji me të cilën shtohet nen i ri 101-a do të fillojë të zbatohet nga 1 nëntori 2013.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 137/2013):

**Neni 23**

Aktet nën ligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

**Neni 28**

Për lejet për ndërtim për ndërtimet e kategorisë së dytë që janë dhënë para hyrjes në fuqi të këtij ligji, investuesi mund të parashtrojë kërkesë te organi kompetent që e ka lëshuar lejen për ndërtim, për vazhdim të afatit për

ndërtim të përcaktuar në nenin 12 të këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 68 më së voni në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

**Neni 29**

Gjatë veprimit për ankesa dhe padi të paraqitura kundër akteve administrative të miratuara në procedura për ndryshime gjatë ndërtimit, për ndërrim të investuesit, për lëshim të lejes për punë përgatitore, për lëshim të aktvendimit për ndërtimet nga neni 73 të këtij ligji, për rikonstruktim, ridedikim, adaptim dhe për lëshim të lejes për përdorim për ndërtesa të kategorisë së parë nga neni 57 të këtij ligji, të cilat janë realizuar në mënyrë elektronike, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e nenit 65 paragrafët (18) dhe (19) të Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2009, 124/10, 18/11, 36/ 11, 54/11,13/12, 144/13, 25/13, 79/13 dhe 137/13).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

**Neni 31**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa nenet 18,19, 20 dhe 21 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 maji 2014.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 28/2014):

**Neni 8**

Dispozitat e neneve 59 paragrafi (17), 59-a paragrafi (1) alineja 7 dhe 88 paragrafi (3) të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me rrugët shtetërore, hekurudhat, gazsjellësit dhe largpërçuesit, zbatohen edhe për hidrocentrale, përçues të nxehjes, rrugë magjistrale dhe grumbulluese në rajonin e Qytetit të Shkupit dhe penda me akumulacione.

**Neni 9**

Për ndërtimet për të cilat është parashtruar kërkesë për leje për ndërtim apo është lëshuar leje për ndërtim deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 16/13) nuk sigurohet mendim për shkallën e projektuar dhe të realizuar të rezistencës mekanike, stabilitetit dhe mbrojtjes sizmike të ndërtesës, nga ana e subjektit që kryen veprimtari shkencore hulumtuese-instituti shkencor i specializuar në sferën e mbrojtjes së ndërtesave nga ndikimet sizmike.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 28/2014):

**Neni 11**

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për ndërtim.



Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014):

**Neni 5**

Procedurat për heqjen e licencave dhe autorizimeve të cilat kanë filluar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e ligjit sipas të cilit kanë filluar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014):

**Neni 8**

Drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 7 të këtij ligji, vazhdon ta kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

**Neni 10**

Akti nënligjor i paraparë me nenin 5 të këtij ligji, do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014):

**Neni 9**

Dispozitat nga neni 7 i këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që kanë të bëjnë me kushtin për njohjen e gjuhës se huaj që do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.115/2015):

**Neni 13**

Pronarët e objekteve të ndërtuara me dedikim publik janë të detyruar që të sigurojnë hapësirë parkingu për biçikleta në funksion të objektit me dedikim publik, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 14**

(1) Personi juridik dhe personi fizik licenca përkatësisht autorizimi i të cilit është hequr para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar që t'i kthejnë të njëjtat në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Personat juridikë të cilët e kanë humbur të drejtën për marrje të licencës për shkak të parregullsive të përcaktuara në nenin 38 paragrafi (4) të Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2009, 124/10, 18/11, 36/ 11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14 dhe 42/14) deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të parashetrojnë kërkesë për marrje të licencës në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, nëse i plotësojnë kushtet e këtij ligji, pas kalimit të një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të lejes,

kurse personat juridikë që e kanë humbur të drejtën për marrjen e lejes për shkak të parregullsive të përcaktuara në nenin 38 paragrafi (5) të Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2009, 124/10, 18/11, 36/ 11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14 dhe 42/14), mund të parashtrorjnë kërkesë për marrje të licencës në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, nëse i plotësojnë kushtet e këtij ligj, pas kalimit të pesë viteve nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të licencës.

#### **Neni 15**

Procedurat për dhënie të lejes për ndërtim për rrugë lokale dhe rrugica, sisteme ujësjellësi dhe kanalizimi që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 149/2014):

#### **Neni 12**

Procedurat për lëshimin e lejes për ndërtim të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 187/2014):

#### **Neni 18**

Dispozitat e nenit 5 të këtij ligji dhe nenit 8 paragrafi (1) të këtij ligji, që kanë të bëjnë me ndërtimet që paraqesin trashëgimi të patundshme të mbrojtur kulturore në pajtim me ligjin, zbatohen në procedurat për lëshim të lejes për ndërtim që kanë filluar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 19**

Dispozitat e neneve 1, 2, 8, 9, 10, 12, 13, 14 dhe 15 të këtij ligji, që kanë të bëjnë me plotësimin e kërkesave për efikasitet energjetik do të zbatohen për ndërtesat për të cilat është parashtruar kërkesë për leje për ndërtim dhe kërkesë për leje për rikonstrukcion, nga 1 janari 2015.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/2015):

#### **Neni 5**

(1) Neni 3 nga ky ligj do të fillojë të zbatohet në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për ndalim dhe pengim të kryerjes së veprimtarisë së peregjistruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 199/14) .

(2) Neni 4 nga ky ligj do të fillojë të zbatohet me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit shtetëror për vendosje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 130/14).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/2015):

**Neni 6**

Dokumentacioni i projektit i cili deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji është përpiluar nga personi i huaj juridik i zgjedhur në procedurë për furnizim publik i financuar nga organizata ndërkombëtare ose nga Bashkimi Evropian, e që nuk posedon vërtetim sipas nenit 42 paragrafi (1) të Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2009, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14 dhe 187/14), as autorizim për projektim për personat fizikë që e kanë përpiluar dokumentacionin, mund të zbatohet në procedurë për lëshimin e lejes për ndërtim përkatësisht aktvendimit për realizimin e ndërtimit sipas nenit 74 të këtij ligji, nëse për të njëjtën ka të përpiluar raport pozitiv për revizion nga personi juridik që posedon licencë për revizion për dokumentacionin e projektit.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/2015):

**Neni 39**

Akti nënligjor nga neni 36 i këtij ligji do të miratohet më së voni në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/2015):

**Neni 41**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/2015):

**Neni 13**

(1) Procedurat për lëshim të lejes për ndërtim për ndërtime në zonat zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe nga personat juridikë, të cilat i ndërtojnë qiramarrësit dhe pronarët e tokës në zonat zhvillimore teknologjike industriale, (përveç për objektet infrastrukturore në suazat e zonës, të cilat i ndërtojnë subjektet-dhënës të shërbimeve publike të cilët janë kompetentë për ndërtimin e infrastrukturës elektroenergjetike, të ujësjellësit, kanalizimit, gazpërçuesit dhe telekomunikimit), si dhe për objektet në zonat industriale dhe të gjelbra të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, të cilat kanë filluar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2009, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14,

115/14, 149/14, 187/14 dhe 44/15).

(2) Procedurat për lëshim të aktvendimit për realizim të ndërtimeve përkatësisht vendosjes së pajisjes nga neni 73 paragrafi (1) i këtij ligji në zonat zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe nga persona juridikë si dhe në zonat industriale dhe të gjelbra të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, të cilat kanë filluar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2009, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14 dhe 44/15).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 129/2015):

**Neni 14**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 shtatori 2015.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 217/2015):

**Neni 11**

Dispozitat nga neni 5 i këtij ligji zbatohen edhe gjatë zbatimit të procedurave për ndryshime gjatë ndërtimit të ndërtesave për të cilat është lëshuar leje për ndërtim në pajtim me Ligjin për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2009, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14 dhe 44/15).

Ligj për plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 226/2015):

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/2016):

**Neni 23**

Procedurat që kanë filluar deri në ditën e fillimit me zbatim të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin në bazë të të cilit kanë filluar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/2016):

**Neni 25**

Dispozitat e neneve 1, 2, 3, 4, 6, 8, 10, 11, 12, 13, 14,

16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 22 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 124/15).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/2016):

**Neni 17**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë."

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/2016):

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë."

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 132/2016):

**Neni 11**

Procedura për lëshimin e lejes për përdorim për objektet infrastrukturore në linjë të cilat janë rrugë shtetërore, rrugë dhe rrugica lokale, sisteme të furnizimit me ujë dhe sisteme të kanalizimit, vija hekurudhore, gazsjellës, largpërçues, përçues të produkteve, përçues të nxehtësisë, naftësjellës, teleferikë, sisteme për ujitje dhe kullim, rrugë magjistrale dhe mbledhëse në zonën e qytetit të Shkupit si dhe hidrocentrale dhe diga me akumulime, të cilat kanë filluar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

**Neni 12**

Procedurat për lëshimin e lejes për mbindërtimin e objekteve për banim individual në pajtim me nenin 59-s të këtij ligji, të cilat kanë filluar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

**Neni 13**

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 132/2016):

**Neni 14**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

